



**Operatori i
Sistemit të Transmetimit
dhe Tregut të Kosovës
(KOSTT)**


RREGULLAT E TREGUT

PËRMBAJTJA

PJESA I.....	5
1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME OBJEKTIVAT DHE FUSHËVEPRIMI.....	5
1.1 <i>Objektivat</i>	5
1.2 <i>Fushëveprimi</i>	5
1.3 <i>Struktura e Përgjithshme e Rregullave të Tregut</i>	6
1.4 <i>Konventat</i>	7
1.5 <i>Definicionet</i>	8
1.6 <i>Simbolet</i>	27
1.7 <i>Ndryshoret në Ekuacione</i>	27
1.8 <i>Çmimet e Rregulluara</i>	32
2 PALËT DHE LLOGARITË.....	34
2.1 <i>Palët në Rregullat e Tregut</i>	34
2.2 <i>Llogaritë</i>	39
3 ADERIMI NË RREGULLAT E TREGUT, THEMELIMI I PPB DHE TËRHEQJA.....	41
3.1 <i>Dispozitat e Përgjithshme</i>	41
3.2 <i>Aderimi në Rregullat e Tregut</i>	41
3.3 <i>Palët Përgjegjëse për Balanc (PPB)</i>	43
3.4 <i>Pala në Tërheqje</i>	44
3.5 <i>Dështimi</i>	45
3.6 <i>Pasojat e Dështimit</i>	47
4 KOMUNIKIMET OPERATIVE.....	49
4.1 <i>Dispozitat e Përgjithshme</i>	49
4.2 <i>Komunikimi në raste të jashtëzakonshme</i>	49
4.3 <i>Pajisjet Komunikuese</i>	49
5 KËRKESAT PËR MATJET.....	50
5.1 <i>Agjenti për Administrimin e Matjeve</i>	50
5.2 <i>Baza e Matjeve</i>	50
5.3 <i>Regjistrimi i Njehsorëve</i>	51
5.4 <i>Pajisjet Matëse</i>	51
5.5 <i>Të Dhënat Matëse të Prodhuesit</i>	52
5.6 <i>Të Dhënat Matëse të Interkonektorit</i>	52
5.7 <i>Të Dhënat Matëse të Shpërndarjes</i>	53
5.8 <i>Të Dhënat Matëse të Konsumatorit fundor</i>	53
5.9 <i>Të dhënat Matëse të Sistemit të Ruajtjes</i>	53
6 NDËRRIMI I FURNIZUESIT.....	55
6.1 <i>Procesi i Transferimit të Konsumatorëve</i>	55
6.2 <i>Ndërrimi Grupor i Furnizuesit</i>	56
6.3 <i>Konsumatori pa Furnizues</i>	56
6.4 <i>Rasti me më shumë Furnizues në një Njehsor</i>	56
6.5 <i>Tërheqja e Furnizuesit nga Marrëveshja për Alokimin e Matjeve ekzistuese</i>	57
7 ALOKIMI DHE TREGTIMI I KAPACITETEVE NDËRKUFITARE.....	58
7.1 <i>Dispozitat e Përgjithshme</i>	58
7.2 <i>Regjistrimi i Kapaciteteve Ndërkufitare</i>	58
7.3 <i>Ankandet e Kapaciteteve Ndërkufitare</i>	58
7.4 <i>Tregtimi i Të Drejtave të Tranmetimit Fizik</i>	58
7.5 <i>Veprimet e Pjesëmarrësit në Ankand</i>	58
8 GARANCONI FINANCIAR.....	60
8.1 <i>Procedura për Garancionin Financiar</i>	60
8.2 <i>Kalkulimi i nivelit të Garancionit Financiar</i>	60
8.3 <i>Deponimi i Garancionit Financiar</i>	61
8.4 <i>Monitorimi i Garancionit Financiar</i>	61

8.5	<i>Pasojat e Garancionit Financiar joadekuat</i>	61
PJESA II: OPERIMI I SISTEMIT		62
9	PARASHIKIMI NJË DITË PARA (D-1)	62
9.1	<i>Parashikimi i Konsumit Nacional</i>	62
9.2	<i>Publikimi</i>	62
10	NOMINIMET NDËRKUFITARE	63
10.1	<i>Kapaciteti Transmetues në Disponim</i>	63
10.2	<i>Nominimet Ndërkufitare</i>	63
10.3	<i>Dispozita Shfrytëzo ose Shit të Drejtën për Transmetimin Fizik</i>	64
10.4	<i>Bashkimi i Tregut</i>	64
11	NOMINIMET FIZIKE, NOMINIMET KONTRAKTUALE, OFERTAT PËR SHITJE DHE OFERTAT PËR BLERJE	66
11.1	<i>Dorëzimi i Nominimeve Fizike</i>	66
11.2	<i>Dorëzimi i Nominimeve Kontraktuale</i>	67
11.3	<i>Nominimet e Harmonizuara</i>	68
11.4	<i>Nominimet brenda ditore (D)</i>	69
11.5	<i>Tregu Një Ditë Para (D-1)</i>	69
11.6	<i>Dorëzimi i Ofertave për Blerje dhe Ofertave për Shitje</i>	69
11.7	<i>Parashikimi mujor i Furnizuesit</i>	70
11.8	<i>Prodhimi nga BRE</i>	71
12	TREGU BALANCUES	73
12.1	<i>Parametrat Dinamik të Dispeçimit</i>	73
12.2	<i>Urdhëresat në Tregun Balancues</i>	73
12.3	<i>Rezultatet e Aktivizimit të Ofertave për Blerje dhe Ofertave për Shitje</i>	74
12.4	<i>Aktivizimi i Shënjuar</i>	74
12.5	<i>Aktivizimet e Imponueshme</i>	75
12.6	<i>Orari i Tregtimit</i>	75
13	PROKURIMET E OST-SË DHE SHFRYTËZIMI PËR SHËRBIMET NDIHMËSE DHE HUMBJET; SHKËMBIMET E PAQËLLIMSHME	76
13.1	<i>Vlerësimi i shërbimeve ndihmëse të Kërkesave për Rezerva</i>	76
13.2	<i>Prokurimi i Kontratave të Shërbimeve Ndhmëse</i>	76
13.3	<i>Kontratat për Humbjet</i>	77
13.4	<i>Operimi i Kontratave të Shërbimeve Ndhmëse</i>	78
13.5	<i>Përfshirja e Rezervës në Çmimin e Jobalancit</i>	79
13.6	<i>Operimi i Kontratave të Humbjeve</i>	80
13.7	<i>Shkëmbimet e Paqëllimshme</i>	80
PJESA III: BARAZIMI PËRFUNDIMTAR		76
14	BARAZIMI PËRFUNDIMTAR I AKTIVIZIMIT TË OFERTAVE PËR BLERJE DHE AKTIVIZIMIT TË OFERTAVE PËR SHITJE	82
14.1	<i>Pagesa për Aktivizimin e Ofertave për Blerje dhe për Aktivizimin e Ofertave për Shitje</i>	82
15	KALKULIMI I ÇMIMIT TË JOBALANCIT	85
15.1	<i>Jobalanci i Sistemit</i>	85
15.2	<i>Përfshirja e Aktivizimeve të Shënjuara</i>	85
15.3	<i>Kalkulimi i Çmimit të Jobalancit</i>	87
15.4	<i>Çmimi Mesatar i Jobalancit</i>	88
15.5	<i>Publikimi i Çmimit të Jobalancit</i>	88
16	KALKULIMET E BARAZIMIT PËRFUNDIMTAR	89
16.1	<i>Të Dhënat e Barazimit Përfundimtar</i>	89
16.2	<i>Çmimet e Rregulluara dhe të dhënat e Barazimit Përfundimtar</i>	89
16.3	<i>Të Dhënat që përdoren në Barazimin Përfundimtar</i>	89
16.4	<i>Energjia e Matur e Konsumatorit</i>	90
16.5	<i>Kalkulimi i Jobalancit</i>	91
16.6	<i>Pagesat e Prodhuesve BRE dhe Jobalancit</i>	93
16.7	<i>Kalkulimi i Humbjeve në Transmetim</i>	96

16.8	<i>Kalkulimi i Humbjeve në Shpërndarje.....</i>	<i>96</i>
16.9	<i>Pagesat Mujore pas Korrigjimit të Matjeve</i>	<i>97</i>
16.10	<i>Rregullat e Jo-liferimit</i>	<i>99</i>
16.11	<i>Jobalancat e Bursës së Energjisë Elektrike (PX).....</i>	<i>100</i>
17	DETYRIMET.....	101
17.1	<i>Aplikimi i Tarifave.....</i>	<i>101</i>
17.2	<i>Piku i Konsumit.....</i>	<i>101</i>
17.3	<i>Detyrimet për Rrjetin e Transmetimit</i>	<i>101</i>
17.4	<i>Detyrimi për Operim të Sistemit.....</i>	<i>103</i>
17.5	<i>Detyrimet për Operim të Tregut.....</i>	<i>104</i>
17.6	<i>Rialokimi i Pagesave për Balancim.....</i>	<i>105</i>
18	FATURIMI DHE PAGESAT.....	108
18.1	<i>Dispozitat e Përgjithshme.....</i>	<i>108</i>
18.2	<i>Procesi i Para-faturimit</i>	<i>108</i>
18.3	<i>Cikli i Faturimit dhe Orari i Barazimit Përfundimtar.....</i>	<i>108</i>
18.4	<i>Faturat.....</i>	<i>109</i>
18.5	<i>Kontestimi i Faturës.....</i>	<i>110</i>
	PJESA IV: ADMINISTRIMI.....	111
19	PROCEDURAT E RREGULLAVE TË TREGUT	111
19.1	<i>Miratimi i Procedurave të Rregullave të Tregut</i>	<i>111</i>
20	MODIFIKIMI I RREGULLAVE TË TREGUT	112
20.1	<i>Modifikimi i Rregullave të Tregut.....</i>	<i>112</i>
20.2	<i>Paneli Shqyrtues.....</i>	<i>112</i>
20.3	<i>Procesi i Modifikimit.....</i>	<i>112</i>
21	DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	114
21.1	<i>Qasja në Rregullat e Tregut.....</i>	<i>114</i>
21.2	<i>Njoftimet</i>	<i>114</i>
21.3	<i>Data e hyrjes në fuqi.....</i>	<i>114</i>
21.4	<i>Forca Madhore.....</i>	<i>114</i>
21.5	<i>Kushtet Emergjente.....</i>	<i>115</i>
21.6	<i>Transferimi (Cedimi).....</i>	<i>115</i>
21.7	<i>Auditimi.....</i>	<i>115</i>
21.8	<i>Dispozitat e Konfidencialitetit</i>	<i>116</i>
21.9	<i>Përgjegjësia Ligjore</i>	<i>116</i>
21.10	<i>Valuta.....</i>	<i>116</i>
21.11	<i>Juridiksioni.....</i>	<i>117</i>
21.12	<i>Zgjidhja e Kontesteve</i>	<i>117</i>
	SHTOJCA 1	118
	<i>Marrëveshja për Aderim në Rregullat e Tregut.....</i>	<i>118</i>
	SHTOJCA 2.....	120
	<i>Marrëveshja për Palën Përgjegjëse për Balanc.....</i>	<i>120</i>

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 5 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Këto **Rregulla të Tregut** (duke përfshirë edhe ndryshimet pasuese) janë **Rregullat e Tregut** me shumicë, të përgatitura në përputhje me Nenin 23, paragrafin 7 të **Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr.05 /L-085)**.

RREGULLAT E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

PJESA I

1 Dispozitat e Përgjithshme Objektivat dhe Fushëveprimi

1.1 Objektivat

1.1.1 Objektivat e **Rregullave të Tregut** janë të specifikuar në **Licencën e Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike (OT)** dhe çfarëdo konflikti ndërmjet Objektivave të **Rregullave të Tregut** dhe **Licencës së OT** do të interpretohet në favor të **Licencës**.

1.1.2 Objektivat e **Rregullave të Tregut** janë:

- (a) përmbushja efikase e detyrave me të cilat **OT** obligohet nga **Licenca** e tij;
- (b) mbështetja e operimit eficient të Rrjetit të Transmetimit nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;
- (c) promovimi i konkurrencës efektive në prodhim, tregtim dhe furnizim me energji elektrike;
- (d) implementimi efektiv dhe menaxhimi i Balancimit dhe Barazimit Përfundimtar në harmoni me Rregullat e Tregut;
- (e) promovimi i shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë elektrike.

1.2 Fushëveprimi


1.2.1 Në mënyrë që një **Treg** të funksionojë, **Palët Tregtare** duhet të jenë në gjendje të tregtojnë energji elektrike në një ambient ku energjia elektrike fizikisht mund të menaxhohet në mënyrë të sigurt nga **Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)**. Në **Rregullat e Tregut** përshkruhet mënyra se si **Palët** mund të tregtojnë me njëra tjetrën dhe mënyra se si këto **Palë** duhet të ndërveprojnë me **OST**, me qëllim të menaxhimit të balancit fizik të sistemit.

1.2.2 Kushtet kryesore sipas të cilave **OST** do të operojë sistemin janë dhënë në **Kodin e Rrjetit. Rregullat e Tregut** duhet të jenë në pajtueshmëri me **Kodin e Rrjetit** dhe **Kodin e Matjes**.

1.2.3 Sipas Nenit 23.7 të Ligjit për Energjinë Elektrike, **Rregullat e Tregut** janë cilësuar si përgjegjësi e **OT**.

1.2.4 **Rregullat e Tregut** përshkruajnë përgjegjësitë e **Palëve** për proceset vijuese:

- (a) mirëmbajtjen e shënimeve për të gjitha transaksionet kontraktuale të dakorduara në **Treg**;
- (b) **Barazimin Përfundimtar** si dhe njoftimin e pjesëmarrësve në treg për këtë proces;

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 6 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (c) pranimin e informatave nga **OST** në lidhje me ndryshimet e nevojshme në **Barazimin Përfundimtar** duke u bazuar në kapacitetet teknike si dhe në situatat e jashtëzakonshme në **Rrjetin Transmetues** ose në **Rrjetin e Shpërndarjes**;
- (d) themelimin e platformave për operim të Tregut dhe **Barazim Përfundimtar**;
- (e) publikimin e të dhënave dhe informatave të **Tregut**;
- (f) menaxhimin e proceseve për **Ndërrimin e Furnizuesit** dhe lehtësimin e aderimit në treg të **Furnizuesve** të ri;
- (g) organizimin e ankandeve, alokimin dhe tregtimin e **Të Drejtave për Transmetim Fizik**, për **Palët** që dëshirojnë të bëjnë tregti ndërkufitare në kufijtë e Kosovës;
- (h) operimin e **Tregut Balancues** për t'i mundësuar **OST** balancimin e sistemit para dhe në kohë reale;
- (i) llogaritjen e jobalanceve, çmimeve të jobalanceve dhe lëshimin e faturave përkatëse
- (j) nominimin e parametrave fizik të gjenerimit, konsumit, **Ofertave për Blerje** dhe **Ofertave për Shitje** të energjisë, për t'i mundësuar **OST** menaxhimin e sistemit në kohë reale; dhe
- (k) prokurimin, kontraktimin dhe pagesat sipas Kontratave të Shërbimeve Ndhmëse.

1.3 Struktura e Përgjithshme e Rregullave të Tregut

1.3.1 **Rregullat e Tregut** ndahen në katër pjesë kryesore. Secila pjesë është e ndarë në nene dhe paragrafë. Paragrafët mund të kenë nën-paragrafë. Titulli i çdo pjese ose seksioni është dhënë për informacion dhe nuk do të ndikojë në kuptimin e tij. Referencat për një pjesë, seksion ose paragraf do të jenë për të gjitha seksionet ose paragrafët.


1.3.2 Termat në **Rregullat e Tregut** do të kenë të njëjtin kuptim sikurse termat e përdorura në legjislacionin në fuqi ose licencë, sipas rastit.

1.3.3 Në lidhje me paragrafin 1.3.2, çdo modifikim ose amendamentim i legjislacionit në fuqi do të zbatohet në **Rregullat e Tregut** që janë në fuqi.

1.3.4 Përveç në qoftë se konteksti e kërkon ndryshe, në **Rregullat e Tregut** do të vlejë:

- (a) fjalët në njëjës mund të përfshijnë shumësin;
- (b) fjala “përfshirë” mund të interpretohet pa kufizim;
- (c) çdo term i nxjerrë nga cilido term i definuar ose interpretuar, duhet të interpretohet në përputhje me definicionin ose interpretimin gjegjës.
- (d) termi energji ka kuptimin e energjisë elektrike;
- (e) trajta e pashquar e definicioneve ka kuptimin e njëjtë me trajtën e shquar;
- (f) Termi **Tarifë** ka kuptim të njëjtë me termin **Ngarkesë** i përdorur në disa dokumente të sektorit.

1.3.5 Konventat e përdorura në Rregullat e Tregut mbulojnë çështjet si kohëzgjatja dhe Drejtimi i Rrjedhave. Këto janë dhënë në nenin 1.4.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 7 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

1.3.6 Të gjitha definicionet, shkurtesat dhe simbolet e përdorura në **Rregullat e Tregut** janë përshtatur në nenet 1.5, 1.6 dhe 1.7. Çdo term i definuar do të shkruhet në bold, do të fillojë me shkronjë të madhe dhe do të ketë kuptimin e dhënë në nenin 1.5.

1.4 Konventat

1.4.1 Njësitë matëse të prodhimit dhe importit në **Interkonektor** kanë parashenjë pozitive, njësitë matëse të konsumit dhe eksportit në **Interkonektor** kanë parashenjë negative. Nëse specifikohet në mënyrë eksplicite, parashenja nuk aplikohet.

1.4.2 Vlerat e **Nominimeve Kontraktuale** dhe madhësitë në **Barazimin Përfundimtar** janë në MWh.

1.4.3 Vlerat e prodhimit dhe konsumit, **Nominimeve Fizike, Ofertave për Blerje dhe Ofertave për Shitje** janë në MW (të shprehura si totali i MWh për orë).

1.4.4 Konventa kohore tregon kohën e përfundimit (përveç nëse nuk është saktësuar ndryshe) – p.sh 12:00 është **Perioda e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit** që fillon në 11:00:01 dhe përfundon në 12:00:00.


1.4.5 Minuta = fillimi i minutës së plotë.

1.4.6 Dita është periudha prej 24 orëve (me përjashtim të ditëve kur ora ndërron për sezonin verë/dimër ku dita ka 23 respektivisht 25 orë) duke filluar në mesnatë (00:00). Një **Ditë Pune** është çdo ditë nga e Hëna deri të Premten përveç festave zyrtare.

1.4.7 Një javë është periudha që fillon të Hënë në 00:00 dhe përfundon të Dielën në 24:00.

1.4.8 Muaji është muaji kalendarik.

1.4.9 Koha referohet si Koha e Evropës Qendrore (CET) e përshtatur për sezonin verë/dimër.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 8 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

1.5 Definicionet

1.5.1 Termet e përdorura në Rregullat e Tregut do të kenë kuptimet vijuese:

Termi i Definuar	Interpretimi
Aderimi	është proces i përshkruar në nenin 3.2 me të cilin një Palë e re nënshkruan (pranon) se do t'i zbatojë Rregullat e Tregut ;
Agjenti për Administrimin e Matjeve	(AAM) është agjent që themelohet nga OT me përgjegjësitë e parashtruara në paragrafin 5.1.2;
Aktivizimi	është Aktivizimi i Ofertës për Blerje ose Ofertës për Shitje nga ana e OST dhe është urdhëresë që i jepet njësisë balancuese të operojë mbi ose nën pozitën e Nominimit Fizik (i matur në MWh/orë).
Aktivizimi i Imponueshëm	është Aktivizim Oferte për kompensimin e Furnizuesit (në emër të Konsumatorëve të tij) me Çmimin e Kompensimit për Shkyçje të Ngarkesës (në €/MWh), kur OST ose OSSH ka shkyçur konsumatorët;
Ankandi i Kapaciteteve Ndërkufitare	është një ankand i Të Drejtave të Transmetimit Fizik (DTF) , që bëhet nga Zyra e Ankandëve të Koordinuara të Evropës Juglindore (SEE CAO) në emër të OST sipas procedurave të përcaktuara në seksionin 7.3 ose nga OT-ja nëse kufiri nuk shërbehet nga SEE CAO;
Balancimi	nënkupton të gjitha veprimet dhe proceset, në të gjitha afatet kohore, përmes të cilave OST-të sigurojnë, në mënyrë të vazhdueshme, mirëmbajtjen e frekuencës së sistemit brenda një diapazoni të paracaktuar të stabilitetit dhe përshtatshmërinë me sasinë e rezervave të nevojshme për cilësinë e kërkuar.
Barazimi Përfundimtar	është emërtim i përbashkët për proceset e përdorura për përcaktimin e shfrytëzimit të sistemit nga çdo Palë dhe detyrimet financiare të palëve si dhe pagesat që rrjedhin nga këto detyrime;
Baza e Matjeve	është bazë e të dhënave e mirëmbajtur nga AAM me informatat e nevojshme për secilin Njehsor të kyçur në Rrjetin e Shpërndarjes apo Rrjetin e Transmetimit përfshirë të dhënat për Furnizuesit apo Prodhuesit me të cilët Njehsori është regjistruar dhe të gjitha informatat e nevojshme për të përcaktuar rrjedhat në të dy kahet në atë Njehsor ;
Bashkimi (çiftimi) i tregut	është mekanizmi implicit i ankandit, i cili – nëpërmjet operimit të koordinuar të tregjeve të energjisë të dy ose më shumë Zonave Ofertuese – alokon njëkohësisht kapacitetin e interkoneksionit ndërkufitar dhe përcakton çmimet në tregjet përkatëse të energjisë;
Bashkimi Evropian	(BE) është bashkimi politik dhe ekonomik i shteteve anëtare të vendosura kryesisht në Evropë, me të cilët Kosova ka nënshkruar një traktat (Traktatin e Komunitetit të Energjisë) sipas të cilit disa direktiva dhe rregullore të BE-së janë të zbatueshme për Kosovën tërësisht ose pjesërisht;

Termi i Definuar	Interpretimi
Bursa e Energjisë Elektrike	(PX) është një person juridik i caktuar për të kryer aktivitetet e operimit të tregut të organizuar në tregjet fizike nga afatet e tregut "një dite para" deri te Koha e mbylljes së Tregut siç specifikohet në Rregulloren e alokimit të kapaciteteve dhe menaxhimit të kongestionit (referuar si kodi i rrjetit CACM), të cilat përfshijnë (por pa u kufizuar në) veprimin si Operator i Emërtuar i Tregut të Energjisë Elektrike si dhe gjithashtu për aktivitetet e specifikuar për operimin e një TOEE siç përcaktohet me Ligjin për Energjinë Elektrike; OT dhe OST (KOSTT) janë TOEE i vetëm i caktuar, por ia kanë transferuar të drejtat dhe detyrimet e tyre ALPEX-it;
Çmimi Balancues i OST	është çmimi (në €/MWh) që aplikohet në pagesat në/nga Llogaria Balancuese e OST me qëllim që ajo të bëhet zero në fund të muajit;
Çmimi i Jobalancit	është çmimi (në €/MWh) i kalkuluar, sipas nenit 15 të Rregullave të Tregut , që përdoret për t'u paguar Energjia e Jobalancit ;
Çmimi i Jo-Liferimit	është çmimi (në €/MWh) të cilin Pala Tregtare do të paguajë për energjinë elektrike të Jo-liferuar;
Çmimi i Kompensimit për Shkyçje të Ngarkesës	është çmim (në €/MWh) i aprovuar nga ZRrE , që duhet të aplikohet për konsumin e shkyçur në rastin kur shkyçjet janë urdhëruar nga OST ;
Çmimi BRE	është çmimi i dakorduar, në përputhje me Marrëveshje për Blerjen e Energjisë që duhet të paguhet nga Fondi Mbështetës për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë për prodhimin e energjisë nga Njësitë Gjeneruese BRE të përfshira në Skemën Mbështetëse të BRE;
Çmimi Referent	Është çmimi ekuivalent me çmimin mesatar të tregut që caktohet në baza vjetore nga ZRrE ;
Çmimi i Rezervës Negative për Shërbimet Ndhmëse	është çmimi (në €/MW/orë) i definuar në Kontratën e Shërbimeve Ndhmëse për Rezervën që duhet të paguhet për Margjinën Negative të Kapacitetit Rezervë ;
Çmimi i Rezervës për Shërbimet Ndhmëse	është çmimi (në €/MW/orë) i definuar në Kontratën e Shërbimeve Ndhmëse për Rezervën , që duhet të paguhet për Margjinën e Kapacitetit Rezervë ;
Çmimi i Rregulluar	është çmim (në €/MWh) që mund të përcaktohet nga ZRrE , të cilin OT do ta aplikojë në vend të cilitdo çmim të aplikuar në Barazimin Përfundimtar , kur ZRrE përcakton se ky çmim do të aplikohet në mungesë të konkurrencës në treg;
Çmimi i Shfrytëzimit të Shërbimeve Ndhmëse	është çmimi (në €/MWh) i definuar në një Kontratë të Shërbimeve Ndhmëse që duhet të paguhet për çdo MWh të aktivizuar sipas kontratës;

Termi i Definuar	Interpretimi
Çmimi i Shfrytëzimit të Kontratës së Humbjeve të Transmetimit	është Çmimi (në €/MWh) i specifikuar në Kontratën e Humbjeve të Transmetimit i pagueshëm për çdo MWh të udhëzuar për dhënie (ose marrje) sipas kontratës;
Çmimi i bursës së energjisë elektrike	është çmimi i njoftuar OT-së nga PX (ose mesatarja e tij e llogaritur nga OT nëse ka më shumë se një PX në operim në Kosovë) për një Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalancit ;
Çmimi i Shkëmbimit të Paqëllimshëm	është çmimi i njoftuar te OST-ja me të cilin do të paguhet Shkëmbimet e Paqëllimshme
Çmimi Mesatar i Jobalancit	është Çmimi i Jobalancit (në €/MWh) që do të përdoret në Barazimin Përfundimtar kur nuk mund të kalkulohet Çmimi i Jobalancit ;
Dalje nga Rrjeti Transmetues	është energjia totale (në MWh) e dhënë në Rrjetin e Shpërndarjes dhe tek Konsumatorët e kyçur në Rrjetin e Transmetimit ;
Data e Tërheqjes	është data efektive nga e cila një Palë pushon të jetë e obliguar me Rregullat e Tregut ;
Data e Transferimit	është data të cilën Furnizuesi Propozues bëhet përgjegjës për furnizimin e Konsumatorit në procesin e ndërrimit të Furnizuesit ;
Data Efektive e Aderimit	është data e Aderimit në Rregullat e Tregut nga Pala Aplikuese ;
De-energizimi	është veprim që një stabilimenti t'i pamundësohet marrja e energjisë elektrike ashtu siç specifikohet në Kodin e Rrjetit;
Detyrimi i Furnizuesit për Operim të Sistemit	është pagesë mujore (në €) e kalkuluar për çdo Furnizues , duke e shumëzuar Tarifën e Furnizuesit për Operim të Sistemit me shumën nga Llogaria Dalëse për Energjinë e Matur për çdo Periodë të Barazimit Përfundimtar në muajin përkatës;
Detyrimi i Furnizuesit për Operim të Tregut	është pagesë mujore (në €) e kalkuluar për çdo Furnizues , duke e shumëzuar Tarifën e Furnizuesit për Operim të Tregut me shumën nga Llogaria Dalëse për Energjinë e Matur për çdo Periodë të Barazimit Përfundimtar në muajin përkatës;
Detyrimi i Prodhuesit në Shpërndarje për Operim të Sistemit	është pagesë mujore (në €) e llogaritur për çdo Prodhues të kyçur në rrjetin e shpërndarjes, duke shumëzuar Tarifën e Prodhuesit për Operim të Sistemit me shumën e Energjisë së Matur nga Llogaria e Injektivit për çdo Periodë të Barazimit Përfundimtar në muajin përkatës;

Termi i Definuar	Interpretimi
Detyrimi i Prodhuesit në Shpërndarje për Operim të Tregut	është pagesë mujore (në €) e llogaritur për çdo Prodhues të kyçur në rrjetin e shpërndarjes, duke shumëzuar Tarifën e Prodhuesit për Operim të Tregut me shumën e Energjisë së Matur nga Llogaria e Injektimit për çdo Periodë të Barazimit Përfundimtar në muajin përkatës;
Detyrimi i Prodhuesit për Operim të Sistemit	është pagesë mujore (në €) e kalkuluar për çdo Prodhues , duke e shumëzuar Tarifën e Prodhuesit për Operim të Sistemit me shumën e Energjisë së Matur nga Llogaria e Injektimit për çdo Periodë të Barazimit Përfundimtar në muajin përkatës;
Detyrimi i Prodhuesit për Operim të Tregut	është pagesë mujore (në €) e kalkuluar për çdo Prodhues të kyçur në transmetim, duke e shumëzuar Tarifën e Prodhuesit për Operim të Tregut me shumën e Energjisë së Matur nga Llogaria e Injektimit për çdo Periodë të Barazimit Përfundimtar në muajin përkatës;
Detyrimi për Operim të Sistemit të Transmetimit	është detyrim (në €) i mbledhur për Operim të Sistemit të Transmetimit për qëllime të menaxhimit të sistemit;
Detyrimi për Operim të Tregut	është detyrim (në €) i mbledhur për OT në mënyrë që të kryejë aktivitetet e licencuara;
Detyrimi për Shfrytëzim të Rrjetit të Transmetimit	është detyrim (në €) i mbledhur për qëllim të operimit të Rrjetit të Transmetimit ;
Shkëmbimet e Paqëllimshme	janë ndryshimet ndërmjet shkëmbimit ndërkufitar të programuar dhe shkëmbimit ndërkufitar neto të matur, të shprehur nga ana e OST në MWh, për Periodën e Barazimit Përfundimtar ;
Dështimi	është shkelje materiale e dispozitave të Rregullave të Tregut e cila nuk është eliminuar, përfshirë edhe mos-pagesën e borxhit;
Ditë Pune	në përputhje me paragrafin 1.4.6, është çdo ditë ndërmjet të Hënës dhe të Premtes duke përfshirë edhe të Hënën dhe të Premten, përveç festave publike zyrtare;
Drejtimi i Rrjedhave	është tregues për kahun e rrjedhave në Njehsor . Njehsori importues do të regjistrojë rrjedhat si rritje progresive të leximeve dhe eksportin si zvogëlim të leximeve, dhe e kundërta në rastin kur Njehsori akordohet si Njehsor eksportues;
E Drejta për Transmetimin Fizik	i jep të drejtën zotëruesve të të drejtave të bëjnë nominimin e transmetimit të energjisë në një Interkonektor ;
Ekzekutimi i Barazimit Përfundimtar	është ekzekutim i pjesshëm, provizor ose final i Barazimit Përfundimtar si është definuar në nenin 18.1;
Energjia e Jo-liferuar	është energjia elektrike (në MWh) e jo-liferuar nga Aktivizimi i Ofertave për Shitje apo Aktivizimi i Ofertave për Blerje ;

Termi i Definuar	Interpretimi
Energjia e Matur	është energjia elektrike (në MWh) që konsiderohet se është prodhuar apo konsumuar në kufirin me Rrjetin e Transmetimit nga Njësia Balancuese e nevojshme për procesin e Barazimit Përfundimtar ;
Energjia e Matur e Llogarisë Dalëse	është konsumi total (në MWh) i Furnizuesit , gjatë një Periode të Barazimit Përfundimtar i matur në Kufirin Komercial në mes Furnizuesit dhe Operatorëve të Rrjetit , në rrjetin e të cilëve është (janë) kyçur Konsumatori(ët) i(e) Furnizuesit ;
Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese	është energjia elektrike (në MWh) e matur apo e llogaritur që është marrë në një Sistem Matës të Furnizuesit ose (sipas rastit) e Njesisë Balancuese të caktuar në një Periodë të Barazimit Përfundimtar ;
Energjia e Shënjuar Neto	është sasia e energjisë (në MWh) e të gjitha Ofertave për Shitje të Aktivizuara dhe Ofertave për Blerje të Aktivizuara të cilat janë të shënjuara;
Energjia në Llogarinë Balancuese të OST	është sasia e energjisë në MWh e përdorur për të llogaritur Çmimin Balancues të OST ;
ENTSO-E	është Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike, që është organizatë zyrtare evropiane, rregullat e së cilës Kosova duhet t'i zbatojë;
Faktori i Indeksit të Shfrytëzimit të Rezervës	është një faktor pozitiv i indeksit të përdorimit të rezervës ose një faktor negativ i indeksit të përdorimit të rezervës;
Fatura	është përmbledhje e Rreshtave të Faturës që kanë të bëjnë me një faturim specifik për një muaj, që OT i dorëzon një Pale ose një PPB për pagesë;
Pagesat e Rezervës të Kontratës të Humbjeve të Transmetimit	është totali i pagueshëm (në €) i Barazimit Përfundimtar ndaj një Pale Tregtare sipas një Kontrate të Humbjeve të Transmetimit për të qenit në dispozicion për të ofruar shërbimin sipas kontratës;
Pagesat e Shfrytëzimit të Kontratës së Humbjeve të Transmetimit	është pagesa (në €) për një Periudhë të Barazimi Përfundimtar së Jobalancit që rrjedh nga shfrytëzimi i Kontratës së Humbjeve të Transmetimit, i llogaritur duke shumëzuar energjinë e shfrytëzuar sipas kontratës me çmimin e Shfrytëzimit të Kontratës së Humbjeve të Transmetimit;
Pagesa e Shkëmbimit të Paqëllimshëm	Është shuma që OST-ja do të debitojë ose kreditojë në Llogarinë Balancuese të OST-së për pagesën e Shkëmbimeve të Paqëllimshme ;

Termi i Definuar	Interpretimi
Fondi Mbështetës për Burimet e Ripërtëritshme të Energjise	nënkupton tërësinë e Obligimeve të Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme të inkasuara nga konsumatorët përfundimtarë, buxheti qendror, taksa e posaçme mjedisore sapo të hyn në fuqi, donatorët, etj., dhe të dorëzuara nga furnizuesit e tyre përkatës te Operatori i Energjisë së Ripërtëritshme për të mbuluar kostot e Skemës Mbështetëse, jobalancet e Prodhuesve të Energjisë së Ripërtëritshme dhe Operatorit të Energjisë së Ripërtëritshme;
Forcë Madhore	në raport me cilëndo Palë , është çdo akt ose ngjarje natyrore ose sociale jashtë kontrollit të arsyeshëm të asaj Pale , të cilën Pala nuk ka mundur ta evitoj edhe përkundër vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit dhe që rezulton me pamundësinë e asaj Pale për të realizuar çfarëdo obligimi sipas Rregullave të Tregut , duke përfshirë, por pa u kufizuar në një ose më shumë nga aktet në vijim: tërmetet, vetëtimat, ciklonet, vërshimet, zjarret shpërthime të trazirave, luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste ose ushtarake. Aktet ose kufizimet e qeverive ose autoriteteve publike; lufta, mocionet, kryengritjet ose trazirat civile; grevat, sëmundjet epidemike, stuhia, tërmeti, rrëshqitja e tokës, bllokadat ose embargot; dëmtimet në stabilimente ose në stabilimentet deponuese të shkaktuara nga eksplozimet, kontaminimi jonizues, kontaminimi radioaktiv, katastrofat natyrore, dhe shkatërrimi ose prishjet e pajisjeve të Palës dhe të tjera kur gjatë gjithë kohës efektet e tilla negative nuk kanë mundur të parandalohen, anashkalohen , sanohen plotësisht apo pjesërisht nga Pala e prekur.
Funksioni Pjesëmarrës	është funksioni që e mbanë Pala e që përcakton të drejtat dhe obligimet sipas Rregullave të Tregut që aplikohen për atë Palë për funksion të caktuar por nuk kufizon Palën në kryerjen e aktiviteteve sipas ndonjë Funksioni Pjesëmarrës tjetër për të cilin është emëruar (ose Licencuar) ;
Furnizuesi	është person i Licencuar për furnizim me energji elektrike sipas Nenit 33 të Ligjit për Energjinë Elektrike;
Furnizuesi Aktual	është Furnizues që aktualisht operon dhe është i regjistruar për furnizimin e Konsumatorëve në Sistemin Matës të caktuar;
Furnizuesi i Mundësisë së Fundit	është Furnizues i caktuar nga Rregullatori për furnizimin në një periudë të caktuar kohore të Konsumatorëve , Furnizuesi i të cilëve ka ndërprerë furnizimin ose për ndonjë shkak tjetër Konsumatori nuk është në gjendje të gjejë një Furnizues alternativ;
Furnizuesi Propozues	është Furnizuesi që dorëzon njoftim se dëshiron të furnizojë një Konsumator nga një Sistem Matës i caktuar;

Termi i Definuar	Interpretimi
Furnizuesi Publik	është Furnizues i Licencuar nga ana e ZRrE që ka obligimin për furnizim publik me energji elektrike të Konsumatorëve që i plotësojnë kushtet për Shërbime Universale si definohet në Ligjin për Energjinë Elektrike;
Garancioni Financiar	është instrument financiar apo grup i instrumenteve financiare të formës së specifikuar në nenin 8.2 të cilat OT mund t'i tërheqë në rast se PPB ose Pala Tregtare dështon t'i kryejë pagesat sipas Barazimit Përfundimtar ;
Gjendja e Llogarisë Balancuese të OST	është gjendja financiare (në €) në fund të çdo muaji në Llogarinë Balancuese të OST ;
Grupi Balancues	është një grup i formuar nga një ose më shumë Palë Tregtare që realizojnë aktivitetet të injektimit ose marrjes, i cili formohet për nevoja të agregimit të jobalanceve të tyre në një Llogari të Injektimit ose një Llogari Dalëse të vetme që operohet nga PPB e nominuar nga ana e tyre;
Humbjet në Shpërndarje	është energjia që hyn në Rrjetin e Shpërndarjes , por që nuk është marrë nga konsumatorët në Rrjetin e Shpërndarjes , e cila duhet të blihet nga ana e OSSH për çdo Periodë të Barazimit Përfundimtar
Humbjet në Transmetim	është diferenca e energjisë në MWh, e matur ndërmjet rrjedhave që hyjnë në Sistemin e Transmetimit dhe rrjedhave që dalin nga Sistemi i Transmetimit , në një Periodë të Barazimit Përfundimtar ;
I Regjistruari	është Palë Tregtare e regjistruar në Sistemin Matës në Bazën e Njehsorëve ;
Informatat e Palës	janë të dhënat në lidhje me një Palë ose një Palë Aplikuese që i dorëzohen OT nga një Palë Origjinale ose një Palë Aplikuese pas azhurnimit kohë pas kohe;
Informatat Konfidenciale	janë të dhënat (si definohet në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Rregulla për informatat konfidenciale), dokumentet ose informatat tjera komerciale ose teknike, në lidhje me dizajnimin, rehabilitimin, sigurimin, operimin, mirëmbajtjen, dhe financimin e operimeve dhe aktiviteteve në lidhje me energjinë elektrike të cilat nuk janë në domenin publik dhe të cilat nëse zbulohen mund të rrezikojnë interesat komerciale të aplikuesve dhe të të Licencuarve ;
Interkonektori	është pajisje që përdoret për lidhjen e sistemeve elektrike me sisteme përtej kufijve nacional, si definohet në Ligjin për Energjinë Elektrike;
Jobalanci i Energjisë	është diferenca (në MWh) ndërmjet Energjisë së Matur dhe energjisë së kontraktuar për një Llogari ;

Termi i Definuar	Interpretimi
Jobalanci i Sistemit	është një vlerë pozitive (në MWh) kur sistemi ka mungesa të energjisë (p.sh. Palët Tregtare nuk kanë liferuar energji elektrike të mjaftueshme në sistem) dhe një vlerë negative (në MWh) kur sistemi ka teprica, dhe në raste shumë të rralla mund të jetë zero;
Kapaciteti i Rrjetit për Prodhuesin	është kapaciteti transmetues i definuar në Marrëveshjen për Kycje për çdo lokacion të Prodhuesit ;
Kapaciteti Transmetues në Disponim	(KTD) është kapaciteti transmetues interkonektiv (në MW) në një kufi që caktohet nga ana e OST dhe që është i disponueshëm për alokim nga MO;
Kodi i Matjeve	është kod i përgatitur nga OST sipas Nenit 18 të Ligjit për Energjinë Elektrike;
Kodi i Punës i Njësive të Ruajtjes të OST-së	<p>është një dokument i zhvilluar dhe publikuar nga OST-ja dhe i miratuar nga ZRRE-ja që specifikon se si OST-ja mund të operojë një Njësi të Ruajtjes të OST-së duke iu përmbajtur parimeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> (a) Kërkesat e përcaktuara në nenin 54 të Direktivës (BE) 2019/944 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 5 qershor 2019 mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe ndryshimin e Direktivës 2012/27/BE (e ndryshuar); (b) Transparenca në prokurim dhe operim; (c) Mosdiskriminimi në prokurimin e Shërbimit Ndhmës në mënyrë që të ruhet konkurrenca efektive në furnizim dhe çmim të shërbimeve të tilla; (d) Mos shtrembërimi i çmimeve të tregut të energjisë elektrike; (e) Mos shtrembërimi i çmimeve të energjisë balancuese; (f) Rezervimi me koston më të ulët për shërbimin ndihmës; <p>dhe një dokument i tillë duhet të krijojë një metodologji të qëndrueshme për çmimin e Ofertave nga Njësia e Ruajtjes e OST-së;</p>
Kodi i Rrjetit	është kod teknik në lidhje me Sistemin e Transmetimit , që paraqet Kodin e Rrjetit të Transmetimit të specifikuar në Nenin 17 të Ligjit për Energjinë Elektrike;

Termi i Definuar	Interpretimi
Koeficienti i Shfrytëzimit të Rezervës Pozitive	definohet në nenin 13.1 si një koeficient i shfrytëzimit të Rezervës sipas Kontratës për Shërbime Ndhmëse që shfrytëzohet për Perioda të Barazimit Përfundimtar të caktuara ku klasa e Periodës së Barazimit Përfundimtar përcaktohet nga ana e OST në raport me nivelin e konsumit dhe gatishmërisë së pritshme prodhuese, importit ose eksportit;
Koeficienti i Shfrytëzimit të Rezervës Negative	definohet në nenin 13.1 si një koeficient i shfrytëzimit të Rezervës sipas Kontratës për Shërbime Ndhmëse që shfrytëzohet për Perioda të Barazimit Përfundimtar të caktuara ku klasa e Periodës së Barazimit Përfundimtar përcaktohet nga ana e OST në raport me nivelin e konsumit dhe gatishmërisë së pritshme prodhuese, importit ose eksportit
Koha e Mbylljes së Tregut në D-1	është afati i fundit në D-1 në të cilin Palët Tregtare duhet t'i dorëzojnë Nominimet Fizike Finale, Nominimet Kontraktuale Finale, Ofertat për Blerje dhe Ofertat për Shitje
Koha e Mbylljes së Tregut	është afati i fundit në të cilin Palët Tregtare mund t'i dorëzojnë Nominimet Fizike, Nominimet Kontraktuale , në raport me një Periodë të Barazimit Përfundimtar specifike dhe duhet të bëhet një orë para fillimit të asaj Periode të Barazimit Përfundimtar ;
Koha e Startimit të Pozitës së Urdhëruar	është minuta kur fillon urdhëresa për Aktivizim të Ofertës për Blerje ose urdhëresa për Aktivizim të Ofertës për Shitje ;
Kohëzgjatja e Pozitës së Urdhëruar	është kohëzgjatja në minuta e urdhëresës për Aktivizim të Ofertës për Blerje ose të urdhëresës për Aktivizim të Ofertës për Shitje ;
Konsumatori fundor	është një konsumator që blen energjinë elektrike për përdorim vetanak që ka njehsorë të energjisë ose që konsiderohet që ka njehsorë, i regjistruar nga një ose më shumë Furnizues ;
Konsumatori në Nevojë	është konsumator në nevojë si definohet në ligjin për Energjinë Elektrike
Konsumatori me Shumicë (Tregtari)	është person fizik ose juridik që blenë energji elektrike me qëllim të rishitjes brenda ose jashtë sistemit ku është themeluar.
Konsumi i Pikut	është maksimumi i kalkuluar ose i parashikuar si Dalje nga Rrjeti Transmetues (në MWh/orë), në një Periodë të Barazimit Përfundimtar për vitin tarifor;
Kontesti	është çdo mospajtim ose dallim që ngritët ndërmjet OT dhe ndonjë Pale apo mes Palëve sipas Rregullave të Tregut, Marrëveshjes Kornizë të Rregullave të Tregut ose në lidhje me to;
Kontestimi i Faturës	është Kontest i ngritur nga një Palë Tregtare ose një PPB në lidhje me vlefshmërinë e një ose më shumë Rreshtave në Faturë ;

Termi i Definuar	Interpretimi
Kontrata e Shërbimeve Ndhmëse	Për qëllim të Rregullave të Tregut, është një kontratë bilaterale në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit ndërmjet OST dhe një Palë Tregtare për sigurimin e shërbimeve ndhmëse si: <ul style="list-style-type: none"> (a) Rezerva e Restaurimit Automatik të Frekuencës (aFRR); (b) Rezerva e Restaurimit Manual të Frekuencës (mFRR); dhe (c) Rezervën Zëvendësuese
Kontrata e Humbjeve të Transmetimit	është një kontratë e bërë nga OST-ja me një Palë Tregtare që ajo Palë Tregtare të vërë në dispozicion kapacitetin për të përmbushur Humbjet e Transmetimit kur kërkohet;
Kontrata për Diferencë e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë	(RCfD) është një kontratë e bërë ndërmjet OER-së dhe një Njësie Gjeneruese të Skemës Mbështetëse të BRE-ve Vetë-Shitëse, ku gjeneruesi është përgjegjës për tregtimin e energjisë së tij, por prapëseprapë i garantohet një çmim dhe, për rrjedhojë, është i kualifikueshëm për pagesa në ose nga Fondi Mbështetës për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, i projektuar për të mbështetur përafërsisht çmimin e garantuar;
Korrigjimi Balancues i Energjisë së Ripërtërishme	kalkulohet nga OT me qëllim të llogaritjes së pjesës së kostos balancuese që i atribuohet një Njësie Gjeneruese në Skemën Mbështetëse të BRE;
Kufiri Komercial	është kufiri ndërmjet Palëve Tregtare dhe OST në përputhje me Kodin e Matjes ;
Kundërshtim Transferimi	është njoftim i dorëzuar nga Furnizuesi Aktual si kundërshtim për transferim të Sistemit Matës te Furnizuesi Propozues ;
Licenca	është ashtu siç definohet në Ligjin për Energjinë;
Llogaria	është një Llogari që mbahet në emër të një Palë ose një PPB dhe që përdoret për regjistrimin e të dhënave të Barazimit Përfundimtar të asaj Palë ose PPB duke përfshirë pagesat që duhet t'i paguhen një Palë ose një PPB ose pagesat që paguhen nga një Palë ose një PPB ;
Llogaria Balancuese e PX	është Llogaria për PX për të cilën PX nuk i nënshtrohet Barazimit Përfundimtar të jobalanceve
Llogaria Dalëse	është Llogari e regjistruar për një PPB ose një Furnizues dhe një Tregtar Ndërkufitar që përdoret për Barazimin Përfundimtar ;
Llogaria Balancuese e OST	është Llogari e OST për të cilën OST nuk është subjekt i Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve të Energjisë ;

Termi i Definuar	Interpretimi
Llogaria e Injektimit	është Llogari e regjistruar për një PPB ose një Prodhues apo Tregtar Ndërkufitar që përdoret në Barazimin Përfundimtar ;
Llogaria Tregtare e OSSH-së	është Llogaria për OSSH-në për të cilën OSSH-ja është subjekt i Barazimit Përfundimtar të jobalanceve
Llogaria e Tregtimit e OST	është Llogaria e OST për të cilën OST është përgjegjës për Jobalancet e Energjisë ;
Lloji i Pagesës në Faturë	është emërtim i detyrimit të caktuar i shënuar në një Rresht të Faturës ;
Margjina e Kapacitetit Rezervë	është kapaciteti (në MW) për prodhim (ose konsum) i specifikuar në një Kontratë të Shërbimeve Ndhmëse për Rezervë për një Njësi Balancuese e cila ka mundësi të sigurojë energji elektrike shtesë në qoftë se shfrytëzohet kapaciteti i kontraktuar;
Margjina Negative e Kapacitetit Rezervë	është kapaciteti (në MW) për prodhim (ose konsum) i specifikuar në një Kontratë të Shërbimeve Ndhmëse për Rezervë për një Njësi Balancuese e cila duhet aktivisht të jep energji elektrike në rrjet (në rastin e Njësisë Gjeneruese) dhe kështu është në dispozicion për zvogëlimin e energjisë së furnizuar në rrjet në qoftë se kapacitetit i kontraktuar shfrytëzohet, ose (në rastin e Njësisë Balancuese të Furnizuesit) nuk merr energji elektrike nga rrjeti, dhe me këtë është në dispozicion për të rritur konsumin në qoftë se kapaciteti i kontraktuar shfrytëzohet;
Marrëveshja Kornizë e Rregullave të Tregut	është dokument (i publikuar në Webfaqen e KOSTT nga ana e OT) i nënshkruar nga Palët Origjinale me të cilin Palët iu qasen Rregullave të Tregut ;
Marrëveshja për Aderim në Rregullat e Tregut	është dokument që nënshkruhet nga Palët e reja me të cilin një Palë zotohet se do t'i zbatojë Rregullat e Tregut ;
Marrëveshja për Alokimin e Matjeve	është Marrëveshje që nënshkruhet nga një Konsumator e cila jep informacione për OT në lidhje me rregullat për alokimin e Energjisë së Matur në një Sistem Matës kur Konsumatori dëshiron të furnizohet nga më shumë se një Furnizues ; OT do të jetë i autorizuar të implementoj një taksë për çdo Furnizues të regjistruar sipas Marrëveshjes për Alokimin e Matjeve e cila i mbulon kostot e arsyeshme të OT për operimin e Marrëveshjes për Alokimin e Matjeve ;
Modifikimi	është ndryshim i versionit të Rregullave të Tregut ;
Niveli i Urdhëruar	është pozita e punës në MW që një Njësi Balancuese duhet ta arrijë pas një urdhërese të OST nga një Aktivizim i Ofertës për Blerje ose pas një urdhërese nga një Aktivizim i Ofertës për Shitje ;
Nominimi Fizik	është nominimi mesatar i fuqisë (në MW ose MWh për orë) për Njësinë Balancuese ;

Termi i Definuar	Interpretimi
Nominimi Interkonektiv	është nominim për shfrytëzimin e së Drejtës për Transmetimin Fizik që bëhet në përputhje me nenin 10.2;
Nominimi Kontraktual	është nominimi i energjisë (në MWh) që duhet të kreditohet në një Llogari dhe të debitohet nga një Llogari tjetër për një Periodë të Barazimit Përfundimtar të jobalanceve ;
Njehsor me Lexim Jo-Interval	është çdo Njehsor që nuk është Njehsor me Lexim Interval ;
Njehsori	është pajisje matëse (duke përfshirë edhe çdo pajisje për ruajtjen ose transmetimin e informatave) për matjen e rrjedhave të energjisë ndërmjet dy intervaleve kohore, si përshkruhet më detalisht në Kodin e Matjes ;
Njehsori i Furnizimit	është Njehsor që mat marrjen e energjisë nga Sistemi Transmetues apo Sistemi i Shpërndarjes , shënimet e të cilit ruhen në Bazën e Matjeve ;
Njehsori me Lexim Interval	është Njehsor në të cilin pajisjet matëse janë në gjendje të regjistrojnë sasinë e energjisë që ka kaluar nëpër Njehsor në çdo interval kohor ashtu që të mund të përcaktohet Energjia e Matur që ka rrjedhur në Njehsor gjatë Periodës së Barazimit Përfundimtar . Kjo matje i jepet OT në afatin e përcaktuar me Rregullat e Tregut ;
Njësia Balancuese	është definuar në paragrafin 11.1.2
Njësia Gjeneruese	është njësi fizike për prodhimin e energjisë elektrike, e vendosur brenda Kosovës, që operohet nga një Prodhues ;
Njësia Gjeneruese BRE	është Njësi Gjeneruese BRE e Rregulluar ose Njësi Gjeneruese BRE në Skemën Mbështetëse (por, për evitimin e dyshimeve, përjashton Njësitë Gjeneruese që prodhojnë energji të ripërtëritshme që nuk është në këtë grup, do të konsiderohen si Njësi Gjeneruese jo-BRE , për nevoja të këtyre Rregullave të Tregut);
Njësia Gjeneruese BRE e Rregulluar	është Njësi Gjeneruese e pranuar nga ZRrE si Burim i Energjisë së Ripërtëritshme që nuk ka të drejtë për skemën mbështetëse që i është njoftuar OT si e tillë dhe që ka nënshkruar Marrëveshje për Blerjen e Energjisë me OT për këtë qëllim .
Njësia Gjeneruese BRE në Skemën Mbështetëse	është Njësi Gjeneruese e pranuar nga ZRrE si Prodhues nga Burimet e Energjisë së Ripërtëritshme që i plotëson kushtet e skemës mbështetëse që i është njoftuar OT si e tillë dhe që ka nënshkruar Marrëveshje për Blerjen e Energjisë me OT për këtë qëllim;

Termi i Definuar	Interpretimi
Njësia Gjeneruese e Skemës Mbështetese e BRE e Trashëguar	është një Njësi Gjeneruese e njohur nga ZRrE ose nga një organ tjetër ligjor me autoritetin e nevojshëm (përfshirë ministritë si Ministria e Ekonomisë dhe Financave) si Gjenerues i Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë që është i kualifikueshëm për një skemë mbështetëse që i është njoftuar OER-së dhe ka nënshkruar një Marrëveshje për Blerjen e Energjisë me OER-në për këtë qëllim, por kostot e balancimit të së cilës janë subjekt i aranzhimeve jostandarde të trashëguara (legacy) të jobalancit
Njësia Gjeneruese Vetë-Shitëse e Skemës Mbështetëse të BRE	është një Njësi Gjeneruese e njohur nga ZRRE-ja ose nga një organ tjetër ligjor me autoritetin e nevojshëm (përfshirë ministritë si Ministria e Ekonomisë dhe Financave) si Gjenerues i Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë që është i kualifikueshëm për një skemë mbështetëse që i është njoftuar OER-së dhe ka nënshkruar një marrëveshje RCfD me OER-në dhe tregon energjinë vetanake duke mos e pasur palë kontraktuale OER;
Njësia e Ruajtjes e OST-së	është një Sistem Ruajtjeje i operuar nga OST-ja dhe që mund të integrohet në operimin e Sistemit të Transmetimit (ose sipas rastin në Sistemin e Shpërndarjes);
Njoftimi për Përrjashtim	është njoftim i OT që i dorëzohet Palës me të cilin njofton Palën se do të pushojë të obligohet me Rregullat e Tregut nga një datë e caktuar;
Njoftimi për Tërheqje	është një njoftim me shkrim që një Palë e dorëzon në ZRrE dhe OT me të cilin i njofton për qëllimin e Palës për të pushuar nga obligimi për të zbatuar Rregullat e Tregut ;
Oferta për Blerje	është ofertë për të blerë energji elektrike nga OST në Tregun Balancues me çmim të dhënë (në €/ MWh) nga OSB për një Njësi Balancuese të caktuar;
Oferta për Shitje	është ofertë për t'i shitur energji elektrike OST në Tregun Balancues me çmim të dhënë (në €/MWh) nga një OSB për një Njësi Balancuese të caktuar;
Ofertë e Shënjuar për Blerje	është Ofertë për Blerje e Aktivizuar e përdorur për të lehtësuar sforcimet në sistem;
Ofertë e Shënjuar për Shitje	është Ofertë për Shitje e Aktivizuar e përdorur për të lehtësuar sforcimet në sistem;
Ofruesi i Shërbimit Balancues	(OShB) është një Palë Tregtare që posedon Njësitë Balancuese që ofron rezervë ose një grup që ofron rezervë që ka aftësi për ti ofruar OST shërbime balancuese dhe që është para-kualifikuar në përputhje me Procedurën e Rregullave të Tregut relevante;
Operatori i Ruajtjes	është një person juridik që operon një Sistem Ruajtjeje;

Termi i Definuar	Interpretimi
Operatori i Energjisë së Ripërtërithme	OER është subjekt i caktuar në kuadër të KOSTT sh.a. për të qenë palë homologe e prodhuesve të BRE _{ve} , dhe shërben si Palë Tregtare dhe PPB e autorizuar (ose OT i autorizuar të veprjohë në këto kapacitete) të kontraktojë me Njësitë Gjeneruese të BRE që përfitojnë nga Skema Mbështetëse dhe është përgjegjës për menaxhimin e Fondit Mbështetës për Energjinë e Ripërtërithme;
Operatori i Rrjetit	është OST ose OSSH sipas rastit;
Operatori i Sistemit të Shpërndarjes	(OSSH) si definohet në Nenin 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085), është një person fizik ose juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Sistemit të Shpërndarjes në një zonë të caktuar dhe ku aplikohet, interkoneksioneve të tij me sistemet tjera, si dhe sigurimin e aftësisë afatgjatë të sistemit për të plotësuar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike;
Operatori i Sistemit të Transmetimit	(OST) është person juridik përgjegjës sipas licencës për operimin, mirëmbajtjen dhe, në qoftë se është e nevojshme, zhvillimin e Rrjetit të Transmetimit në një zonë të caktuar dhe interkoneksioneve të tij me sistemet tjera, për sigurimin e aftësisë afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike;
Operatori i Tregut	që është person fizik ose juridik, i licencuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe është përgjegjës për të operuar dhe organizuar tregun e energjisë elektrike në Kosovë ;
Orari i Barazimit Përfundimtar	është orari i përpiluar nga OT sipas paragrafit 18.3.1 që definon afatin e transaksioneve të Barazimit Përfundimtar ;
Orari i Tregtimit	është orari i aktiviteteve të tregut i publikuar nga OT siç është definuar në nenin 12.6 ose amendamentimin e tij të mëvonshëm;
Pagesa e Jo-Liferimit	është shuma e paguar (në €) nga Pala Tregtare në Llogarinë Balancuese të OST si pasojë e jo-liferimit të energjisë prej Ofertave për Shitje të Aktivizuara dhe Ofertave për Blerje të Aktivizuara ;
Pagesa e Furnizuesit për BRE	është shuma e pagueshme mujore e Furnizuesit në emër të taksës për Energjinë e Ripërtërithme
Pagesa e Furnizuesit për Blerje të Energjisë nga BRE	është shuma e pagueshme mujore e Furnizuesit për energjinë e ripërtërithme të shitur furnizuesit sipas nominimeve
Pagesa e Ofertës për Blerje	është pagesa (në €) si rezultat i Aktivizimit të Ofertës për Blerje ;
Pagesa e Ofertës për Shitje	është pagesa (në €) si rezultat i Aktivizimit të Ofertave për Shitje ;


Termi i Definuar	Interpretimi
Pagesa nga Llogaria Balancuese e OST	është debitim apo kreditim i Llogarisë së PPB nga Llogaria Balancuese e OST ;
Pagesa pas Korrigjimit të Matjeve	është pagesë financiare (në €) e korrigjimit të Energjisë së Matur të përdorur paraprakisht në Barazimin Përfundimtar me Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara ;
Pagesa për Rezervën e Shërbimeve Ndhmëse	është pagesa totale (në €) që pas Barazimit Përfundimtar duhet t'i paguhet një Pale Tregtare sipas Kontratës së Shërbimeve Ndhmëse për sigurimin e disponueshmërisë së shërbimit sipas kontratës;
Pagesa për Shfrytëzimin e Shërbimit Ndhmës	është pagesa (në €) për një Periodë të Barazimit Përfundimtar që duhet ti paguhet një Pale Tregtare sipas Kontratës së Shërbimeve Ndhmëse për shfrytëzimin e shërbimit që llogaritet si prodhim i energjisë së shfrytëzuar sipas kontratës me Çmimin e Kontratës së Shërbimeve Ndhmëse ;
Pagesat e Palës së Tretë	janë pagesat (në €) ku OT nuk është Palë në faturë;
Pagesat Mujore pas Korrigjimit të Matjeve	është shuma e pagesës pas korrigjimit të matjeve e llogaritur në baza mujore;
Pajisjet Matëse	janë pajisjet në një Sistem Matës si specifikohet në Kodin e Matjes përkatës që janë të mjaftueshme për sigurimin e Të Dhënave Matëse që kërkohen me Rregullat e Tregut ;
Pala	është nënshkruar i Marrëveshjes Kornizë të Rregullave të Tregut ose Marrëveshjes për Aderim në Rregullat e Tregut ;
Pala Tregtare	është pjesëmarrës në treg (siç përcaktohet në Rregulloren për tregun e brendshëm për energjinë elektrike) dhe mund të jetë Gjenerues, Furnizues ose Konsumator me Shumicë , por mund të jetë gjithashtu një Tregtar Ndërkufitar , ose palë tjetër që ka aderuar në rregullat e tregut për të tregtuar energjinë elektrike;
Pala Aplikuese	është Palë potenciale që dëshiron të nënshkruajë Marrëveshjen për Aderim në Rregullat e Tregut ;
Pala Origjinale	është pala nënshkruese e Marrëveshjes Kornizë të Rregullave të Tregut
Pala Përgjegjëse për Balanc	(PPB) është një Palë Tregtare që vepron për një Grup Balancues dhe që mbanë një Llogari Injektuese ose një Llogari Dalëse për nevoja të agregimit të jobalanceve dhe pagesave për jobalance në emër të Grupit Balancues
Pala Dështuese	është një Palë në Dështim ;

Termi i Definuar	Interpretimi
Pala Jo-Performuese	është Pala që nuk është në gjendje të kryejë obligimet e veta sipas Rregullave të Tregut për shkak të Forcës Madhore ;
Pala në Tërheqje	është Pala që ndërpre në Aderimin e saj në Rregullat e Tregut ;
Palë e Posaçme	është Palë Tregtare për të cilën aplikohen disa rregulla specifike, statusi i së cilës si Palë e Posaçme i njoftohet OT nga ana e ZRrE ;
Paneli Shqyrtues	është paneli i palëve të interesit, që mblidhet nga OT , për shqyrtimin dhe rekomandimet në lidhje me Modifikimet e propozuara;
Parametrat Dinamik të Dispeçimit	janë parametra operativ të një Njësie Balancuese si definohet në Kodin e Rrjetit ;
Parashikimi i Pikut Ditor në Sistem	është piku i parashikuar vjetor i daljes nga sistemi i dakorduar me ZRrE
Parashikimi Mujor	është parashikim në MWh për marrjen e pritur nga Konsumatorët e një Furnizuesi për muajin kalendarik;
Perioda e Barazimit Përfundimtar të jobalancit	është periodë prej një ore që fillon në HH:00:01 ku HH është cilado orë gjatë së cilës përcaktohet energjia e matur si dhe përmbushja e kontratës;
Personi i Ndërvarur	është subjekt juridik në marrëdhënie direkte ose indirekte me të Licencuarin ose ndonjë vartësi të një shoqërie aksionare e të Licencuarit , që do të thotë çdo kompani aksionare e të Licencuarit ose ndonjë vartësi të të Licencuarit , në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë dhe duhet të përkufizohet në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike si entitet kontrollues ose si entitet i kontrolluar;
Përpjesa e Sistemit Matës të Furnizuesve	është energjia totale e parashikuar që merret nga Sistemi i Shpërndarjes që nuk është marrë përmes Sistemeve Matëse me Lexim Interval ;
Përpjesa e BRE për Furnizuesin	është përpjesa e furnizuesit në furnizimin total të konsumatorëve në Kosovë, e kalkuluar nga OT për çdo muaj;
Pozita e Urdhëruar	është vlera mesatare në MW për orë për Njësi Balancuese për një Periodë të Barazimit Përfundimtar si rezultat i Aktivizimit të Ofertave për Blerje dhe/ose Aktivizimit të Ofertave për Shitje ;
Procedura e Rregullave të Tregut	është procedurë sipas Rregullave të Tregut e aprovuar nga ZRrE , e publikuar, e cila shpjegon detalet teknike të proceseve të nevojshme në treg si dhe përgatitjen e të dhënave që përdoren në Barazim Përfundimtar ;
Prodhuesi	është (i) person i Licencuar për prodhimin e energjisë elektrike, ose (ii) person që vepron si një Prodhues por i cili në mënyrë specifike është përjashtuar nga nevoja për posedimin e Licencës si përcaktohet me Ligjin për Energjinë Elektrike;

Termi i Definuar	Interpretimi
Regjistri i Kapaciteteve Nërkuftare	është një regjistër i Tregtarëve Ndërkufitar që mirëmbahet nga OST-së ku Tregtarët Ndërkufitar duhet të regjistrojnë të drejtat e tyre të DTF-ve në kufijtë që nuk shërbehen nga SEE CAO;
Rezerva	është Shërbim Ndihmës për kapacitet që sigurohet nga OST për të mbuluar ndodhitë e paparashikuara në përputhje me Kodin e Rrjetit . Mund të përfshijë Rezervën për Restaurimin e Frekuencës dhe Rezervën Zëvendësuese , sipas nevojës;
Rezerva Stabilizuese e Frekuencës	(FCR) është një rezervë energjie aktive që kontrollohet automatikisht në bazë të devijimit të frekuencës; për qëllimet e këtyre Rregullave të Tregut.
Rezerva për Restaurimin e Frekuencës	(FRR) do të thotë rezervat e energjisë aktive të disponueshme për të rivendosur frekuencën e sistemit në frekuencën nominale dhe, për një zonë sinkrone që përbëhet nga më shumë se një Zonë Rregulluese , për të rivendosur balancin e energjisë në vlerën e planifikuar dhe që mund të jetë Rezervë automatike e Restaurimit të Frekuencës (aFRR) ose Rezervë manuale e Restaurimit të Frekuencës (mFRR);
Rezerva Zëvendësuese	(RR) a janë rezervat e energjisë aktive të disponueshme për të rivendosur ose mbështetur nivelin e kërkuar të FRR për t'u përgatitur për jobalancet shitesë të sistemit, duke përfshirë rezervat e gjenerimit;
Rregullat e Tregut	janë rregulla që administrojnë tregtimin e energjisë elektrike ndërmjet Palëve Tregtare dhe marrëdhëniet ndërmjet këtyre Palëve, OT dhe OST me qëllim të mirëmbajtjes së balancit fizik të tregut;
Rreshti i Faturës	është një rresht në Faturë për muajin përkatës dhe llojin e pagesës në Faturë ;
Sistemi i Shpërndarjes	si definohet në Nenin 3 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085), është kombinim i linjave elektrike dhe pajisjeve elektrike të tensionit të mesëm dhe të ulët që shërbejnë për shpërndarjen e energjisë elektrike;
Sistemi i Transmetimit	është tërësia e linjave energjetike dhe stabilimenteve elektrike të tensionit të lartë që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike;
Sasia Vjetore e Energjisë	(SVE) është konsumi (në MWh/vit) i parashikuar i një Sistemi Matës për një vit;
SEE CAO	është Zyra për Alokim të Koordinuar e Evropës Jug-Lindore e Të Drejtave për Transmetimin Fizik e cila do të merr përsipër aktivitetet e organizimit të ankandit dhe regjistrimit të Të Drejtave për Transmetimin Fizik sipas Rregullave të Ankandit për Alokim të Kapaciteteve;

Termi i Definuar	Interpretimi
Shërbimi Universal	është një e drejtë e disa konsumatorëve të furnizohen nga Furnizuesi Publik në përputhje me kushtet e specifikuar nga Rregullatori ;
Sistem Matës Jo-Interval	është një Sistem Matës në të cilin një ose më shumë Njehsorë janë Njehsorë me Lexim Jo-Interval ;
Sistemi Matës	është grup i regjistruar i Njehsorëve që trajtohet si një instalim që ofron lexim të vetëm ose grup i caktuar i leximeve për nevojat e Barazimit Përfundimtar ;
Sistemi i Ruajtjes	është një sistem për ruajtjen e energjisë elektrike nëpërmjet mbushjes dhe zbrazjes të sistemit dhe që zakonisht bazohet në teknologjinë e baterive;
Sistemi i Ruajtjes së Energjisë në Bateri	është një lloj sistemi ruajtjeje;
Sistemi Matës Interval	është Sistem Matës në të cilin të gjithë Njehsorët janë Njehsorë me Lexim Interval ;
Taksa për Energjinë e Ripërtëritshme	është taksë e përcaktuar nga ZRrE që i njoftohet OT në baza vjetore për të mbështetur prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Energjisë së Ripërtëritshme;
Tarifa e Furnizuesit për Operim të Sistemit	është çmim (në €/MWh) i përcaktuar nga ZRrE të cilin e paguajnë Furnizuesit për të mbuluar shpenzimet e operimit të Sistemit të Transmetimit ;
Tarifa e Furnizuesit për Operim të Tregut	është çmim (në €/MWh) i përcaktuar nga ZRrE të cilin e paguajnë Furnizuesit për të mbuluar shpenzimet e operimit të tregut;
Tarifa e Furnizuesit për Shfrytëzim të Rrjetit	është çmim (në €/MWh), i përcaktuar nga ZRrE të cilin e paguajnë Furnizuesit për të mbuluar shpenzimet për shfrytëzim të rrjetit;
Tarifa e Prodhuesit në Shpërndarje për Operim të Tregut	është çmim (në €/MWh) i përcaktuar nga ZRrE të cilin e paguajnë Prodhuesit e kyçur në Rrjetin e Shpërndarjes për të mbuluar shpenzimet e operimit të tregut;
Tarifa e Prodhuesit për Operim të Sistemit	është çmimi (në €/MWh) i përcaktuar nga ZRrE të cilin e paguajnë Prodhuesit për energjinë elektrike të prodhuar dhe të injektuar në Rrjetin e Transmetimit nga Prodhuesit ;
Tarifa e Prodhuesit për Operim të Tregut	është çmim (në €/MWh) i përcaktuar nga ZRrE të cilin e paguajnë Prodhuesit e kyçur në transmetim për të mbuluar shpenzimet e operimit të tregut;
Tarifa e Prodhuesit për Shfrytëzim të Rrjetit	është çmimi (në €/MW), i përcaktuar nga ZRrE , për Prodhuesit për Detyrim për Shfrytëzim të Rrjetit të Transmetimit ;

Termi i Definuar	Interpretimi
Tarifa e Prodhuesve në Shpërndarje për Operim të Sistemit	është çmim (në €/MWh) i përcaktuar nga ZRrE të cilin e paguajnë Prodhuesit e kyçur në rrjetin e shpërndarjes për të mbuluar shpenzimet për operim të sistemit;
Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara	janë të dhënat të cilat i dorëzohen OT , përfshirë ato të definuara në paragrafin 16.9.3, për llogaritjen e detyrimeve si rezultat i korrigjimit të vlerave matëse të përdorura në Barazimin Përfundimtar ;
Të Dhënat Matëse	janë të dhënat nga një Sistem Matës që i dërgohen OT ose AAM nga OST ose OSSH , të cilat mund të përdoren për përcaktimin e Energjisë së Matur ;
Tregu	do të thotë një treg për energjinë elektrike, duke përfshirë tregjet jashtë bursës, bursat e energjisë elektrike, kapaciteteve, balancimit dhe shërbimeve ndihmëse në të gjitha afatet kohore, duke përfshirë tregjet e ardhshme, të një dite para dhe ato brenda ditës, përveç nëse konteksti nënkupton ndryshe;
Tregu Balancues	është proces në të cilin Palët Tregtare i dorëzojnë Ofertat për Blerje dhe Ofertat për Shitje të energjisë elektrike, me qëllim të realizimit të Balancimit të Sistemit të Transmetimit në kohë reale;
Tregu Brenda Ditor (D)	është perioda ndërmjet Kohës së Mbylljes së Tregut në D-1 dhe Kohës së Mbylljes së Tregut për çdo Periodë të Barazimit Përfundimtar gjatë së cilës mund të dorëzohen Nominimet Kontraktuale dhe Nominimet Fizike tek OT dhe mund të përfshijë Tregun e Organizuar të Energjisë Elektrike
Tregu i Organizuar i Energjisë Elektrike (TOEE)	është treg i organizuar në mënyrë institucionale një ditë para livrimit fizik dhe/ose gjatë ditës së livrimit fizik. Pjesëmarrësit në treg paraqesin ofertat dhe kërkesat e tyre për produkte të paracaktuara dhe të standardizuara të energjisë elektrike për çdo interval kohor një ditë para, ose gjatë ditës së livrimit fizik;
Tregtar Ndërkufitar	është Konsumator me Shumicë atëherë kur sipas Rregullave të Tregut merr pjesë në aktivitetet që kanë të bëjnë me importin dhe eksportin e energjisë apo që kanë të bëjnë me zotërimin, sigurimin apo tregtimin e Të Drejtave të Transmetimit Fizik . Kjo është definuar më gjerësisht në nenin 2.1
Zona Rregulluese	(ZRR) është një pjesë koherente e Zonës Sinkrone të Evropës Kontinentale (zakonisht përputhet me territorin e një kompanie, një vendi ose një zone gjeografike, e përcaktuar fizikisht nga pozicioni i pikave matëse të shkëmbimit të fuqisë ose energjisë me rrjetin e mbetur), që operohet nga një OST e vetme, me ngarkesa fizike dhe njësi gjenerimi të kontrollueshme të kyçura brenda ZRR-së. ZRR-ja për Kosovën operohet nga KOSTT-i , i cili është gjithashtu pjesë koherente e Bllokut Rregullues Shqipëri-Kosovë që ka kontrollin e vet vartës në hierarkinë e rregullimit.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 27 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Termi i Definuar	Interpretimi
Zona e Ofertimit	është zona më e madhe gjeografike brenda së cilës pjesëmarrësit e tregut do të shkëmbejnë energji pa alokim kapacitetesh; aktualisht, zonat e ofertimit në Evropë janë kryesisht të përcaktuara nga kufijtë kombëtarë dhe zona gjeografike e Kosovës është një Zonë e Vetme e Ofertimit;
Zyra e Rregullatorit për Energji	(ZRRÉ) është një agjenci e pavarur, e themeluar sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji. Nr. 05/L-084), ose si amendamentohet me Ligjet pasuese;

1.6 Simbolet

1.6.1 Në formulat e përdorura në **Rregullat e Tregut** janë aplikuar këto indekse:

- (a) “A” është **Llogaria e Palës Tregtare**;
- (b) “B” është Llogaria e PPB
- (c) “b” është Njësia Balancuese;
- (d) “D” është Dita;
- (e) “j” është Perioda e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit që fillon në j:00:01 ose orë sipas kontekstit;
- (f) “m” është muaji kalendarik;
- (g) “o” është Sistem Matës i Rrjetit të Shpërndarjes;
- (h) “ShN” është Kontrata e Shërbimeve Ndihmëse;
- (i) “T” do të thotë status i shënjuar (T=1) ose jo-shënjuar (T=0) i Ofertës për Blerje të Aktivizuar dhe Ofertës për Shitje të Aktivizuar.
- (j) “Z” niveli i tensionit të kyçjes për të cilin aplikohet **Tarifa e Rrjetit për Prodhues** dhe **Tarifa e Rrjetit për Furnizues**.

1.6.2 Me qëllim që të tregtohet orari i aktiviteteve në relacion me Ditën “D” të **Barazimit Përfundimtar** emrohen:

- (a) Aktiviteti është kryer “n” ditë para **Ditës së Barazimit Përfundimtar**, dita do të emërohet “D-n”;
- (b) Aktiviteti është kryer “n” ditë pas **Ditës së Barazimit Përfundimtar**, dita do të emërohet “D+n”; dhe
- (c) Aktiviteti është kryer “n” ditë të muajit që pason **Ditën e Barazimit Përfundimtar**, dita do të emërohet “M+n”.

1.7 Ndryshoret në Ekuacione

1.7.1 Në vazhdim janë dhënë ndryshoret që përdoren në **Rregullat e Tregut**:

Ndryshoret	Interpretimi
BGjLB _m	është Balanci i Gjendjes së Llogarisë Balancuese të OST për muajin "m";
ÇBRE _b	është Çmimi i BRE për Njësinë Gjeneruese të Ripërtërithme "b"
ÇB'OST' _m	është Çmimi për Balancim i OST për muajin "m";
ÇJB _j	është Çmimi i Jobalancit për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit "j";
ÇJLAB _j	është Çmimi i Jo-Liferimit për Njësinë Balancuese "b" në Llogarinë "A" të Palës Tregtare për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit "j";
ÇOB _{bj}	është çmimi i Ofertës për Blerje për Njësinë Balancuese "b" për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit "j";
ÇOSH _{bj}	është çmimi i Ofertës për Shitje për Njësinë Balancuese "b" për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit "j";
ÇRN _{ShN}	është Çmimi i Rezervës Negative për Shërbimet Ndhmëse në €/MW/orë për kapacitetin e rezervuar sipas kontratës;
ÇR _{ShN}	është Çmimi i Rezervës për Shërbimet Ndhmëse në €/MW/orë për kapacitetin e rezervuar sipas kontratës;
ÇSh _{ShN}	është Çmimi i Shfrytëzimit të Shërbimit Ndhmës në €/MWh për energjinë e shfrytëzuar sipas kontratës;
ÇSHK _{NN}	është çmimi i Shfrytëzimit të Kontratës së Shërbimit Ndhmës (ÇSHK _{ShN}) ose çmimi i Shfrytëzimit të Kontratës së Humbjeve të Transmetimit (ÇSHK _{HT}), secila në €/MWh për energjinë e aktivizuar sipas kontratës;
ÇSHP _j	është Çmimi i Shkëmbimit të Paqëllimshëm në Periudhën e Barazimit Përfundimtar të jobalancit "j" në €/MWh që i njoftohet OST-së për shlyerjen e Shkëmbimeve të Paqëllimshëm
PXP _j	është Çmimi i Bursës të Energjisë Elektrike në €/MWh në Periudhën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit "j"
DFOS _A	është Detyrimi i Furnizuesit për Operim të Sistemit për Llogarinë Dalëse "A";
DFOT _A	është Detyrimi i Furnizuesit për Operim të Tregut për Llogarinë Dalëse "A";
DFRrT _A	është Detyrimi i Furnizuesit për Shfrytëzim të Rrjetit Transmetues "A";
DFSh _A	është Detyrimi i Furnizuesit për Shpërndarje "A"
DPOS _A	është Detyrimi i Prodhuesit për Operim të Sistemit për Llogarinë e Injektimit "A";

Ndryshoret	Interpretimi
DPOT _A	është Detyrimi i Prodhuesit për Operim të Tregut për Llogarinë e Injektimit “A”;
DPR _{rA}	është Detyrimi i Prodhuesit për Shfrytëzimin e Rrjetit Transmetues për Llogarinë e Injektimit “A”;
DPSHOS _A	është Detyrimi i Prodhuesit të Shpërndarjes për Operim të Sistemit për Llogarinë e Injektimit “A”;
DPSHOT _A	është Detyrimi i Prodhuesit të Shpërndarjes për Operim të Tregut për Llogarinë e Injektimit “A”;
EDP _j	janë Shkëmbimet e Paqëllimshme në Periodën e Barazimit Përfundimtar “j”;
EDR _{rTj}	është Energjia e Matur si Dalje nga Rrjeti Transmetues në Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j”;
EHS _{hOj}	është energjia (në MWh) që OSSH “o” duhet ta blejë për mbulimin e Humbjeve në Shpërndarje në Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j”;
EJB _{Bj}	është Jobalanci i Energjisë për Llogarinë “B” për Periodën e Barazimit Përfundimtar “j”;
EJL _{Abj}	është Energjia e Jo-liferuar për Njësine Balancuese “b” në Llogarinë e Palës Tregtare “A” për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j”;
EKA _{nj}	është energjia (në MWh) e Nominimit Kontraktual “n” për Llogarinë “A” për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j”;
ELB _m	është Energjia në Llogarinë Balancuese të OST për muajin “m”;
EMD _{Bj}	është Energjia e Matur e Llogarisë Dalëse për Llogarinë Dalëse “B” për Periodën e Barazimit Përfundimtar “j”;
EMI _{Bj}	është Energjia e Matur nga Llogaria e Injektimit për Llogarinë e Injektimit “B” për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j”;
ENJ _{FAbj}	është Energjia e Matur e Njesisë së Furnizimit për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” për Njehsorin e Furnizimit “b” e regjistruar në Llogarinë Dalëse “A”;
ENJ _{GAbj}	është Energjia e Matur në Llogarinë e Injektimit për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” për Njësine Gjeneruese “b” e regjistruar në Llogarinë e Prodhuesit “A”;
EOB _{bj}	është energjia e liferuar nga Njësia Balancuese “b” në Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” nga Aktivizimi i Ofertës për Blerje;

Ndryshoret	Interpretimi
EOS _{h_{bj}}	është energjia e liferuar nga Njësia Balancuese “b” në Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” nga Aktivizimi i Ofertës për Shitje ;
ESh _{h_{nj}}	është Energjia e Shënjuar për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” ;
EZ _{o_j}	është Energjia e Matur që hyn në Rrjetin e Shpërndarjes për Sistemin Matës “o” për rrjedhën e energjisë nga Sistemi Transmetues në Sistemin e Shpërndarjes ;
PSHP _j	është Pagesa e Shkëmbimit të Paqëllimshëm në Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” në €/MWh që OST-ja llogarit për shlyerjen e Shkëmbimeve të Paqëllimshme ;
H	është kohëzgjatja e Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalancit në orë (p.sh. 0.5h, 1h etj.);
HTM _j	janë Humbjet në Transmetim të matura për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” ;
JBS _j	është Jobalanci i Sistemit për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” ;
KBRE _{Ab_j}	është Korrigjimi Balancues i Energjisë së Ripërtëritshme për Njësinë Balancuese “b” në Llogarinë “A” për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” ;
KShR _j	është Koeficienti i Shfrytëzimit të Rezervës Pozitive i përcaktuar nga OST që shfrytëzohet për Periodën e Barazimit Përfundimtar “j” në përputhje me paragrafin 13.1.2;
KShRN _j	është Koeficienti i Shfrytëzimit të Rezervës Negative i përcaktuar nga OST që shfrytëzohet për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” në përputhje me paragrafin 13.1.2;
N	është numri i Periodave të Barazimit Përfundimtar të Jobalancit në krahasim me një Kontratë të Shërbimeve Ndihmëse për Rezervë në muaj, për të cilat kontrata është aktive;
PNjG _{bm}	është pagesa mujore për Njësinë Gjeneruese të Ripërtëritshme “b” në muajin “m” (nga Skema Mbështetëse ose e Rregulluar);
PJL _{Ab_j}	është Pagesa e Jo-Liferimit për Njësinë Balancuese “b” , në Llogarinë e Palës Tregtare , për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” ;
PLB _{Am}	është Pagesa nga Llogaria Balancuese e OST për Llogarinë “A” në muajin “m”;
POB _{bj}	është Pagesa e Ofertës për Blerje për Njësinë Balancuese “b” për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” ;


Ndryshoret	Interpretimi
POSh _{bj}	është Pagesa nga Oferta për Shitje për Njësine Balancuese “b” për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j”;
PRShNm	është Pagesa për Rezervën e Shërbimeve Ndhmëse (në €) për muajin “m” sipas kushteve të Kontratës së Shërbimeve Ndhmëse “ShN”;
PSMF _{Ab}	është Përpjesa e Sistemit Matës të Furnizuesit për Sistem Matës Jo-Interval “b” e regjistruar për Furnizuesin “A”;
PShShNj	është Pagesa për Shfrytëzimin e Shërbimeve Ndhmëse që i paguhet Palës Tregtare nga OST për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” sipas kushteve të Kontratës së Shërbimeve Ndhmëse “ShN”;
PPFB _{Am}	është Përpjesa e Furnizuesit për BRE për Furnizuesin “A” në muajin “m”
PFB _{Am}	është Pagesa e Furnizuesit për BRE për Furnizuesin “A” në muajin “m”
PFBB _{Am}	është Pagesa e Furnizuesit për Blerje të Energjisë nga BRE për Furnizuesin “A” në muajin “m”
T _{bn}	është numri i minutave për të cilat Niveli i Urdhëruar mbahet brenda intervalit kohor të Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” për një urdhëresë nga një Aktivizim i Ofertës për Blerje ose një urdhëresë nga një Aktivizim i Ofertës për Shitje “n” për Njësine Balancuese “b”;
TER	është Taksa për Energjinë e Ripërtëritshme;
TFOS _Z	është Tarifa e Furnizuesit për Operim të Sistemit për nivel të tensionit “Z”;
TFOT	është Tarifa e Furnizuesit për Operim të Tregut në €/kWh;
TFR _{rZ}	është Tarifa e Furnizuesit për Shfrytëzim të Rrjetit për nivel të tensionit “Z”;
TPOS _Z	është Tarifa e Prodhuesit për Operim të Sistemit për nivel të tensionit “Z”;
TPOT	është Tarifa e Prodhuesit për Operim të Tregut në €/kWh;
TPR _r	është Ngarkesa e Prodhuesit për Rrjetin për nivel të tensionit “Z”;
TPShOS	është Tarifa e Prodhuesit në Shpërndarje për Operim të Sistemit;
TPShOT	është Tarifa e Prodhuesit në Shpërndarje për Operim të Tregut në €/MWh;
TPXNU _{bn}	është Kohëzgjatja e Nivelit të Urdhëruar (në minuta) të një urdhërese “n” nga një Aktivizim i Ofertës për Blerje ose një urdhëresë “n” nga një Aktivizim i Ofertës për Shitje për Njësine Balancuese “b”;

Ndryshoret	Interpretimi
TS _j	është Koha e Startimit të Periodës së Barazimit Përfundimtar “j” në formatin - orë dhe minuta;
TSXNU _{bn}	është Koha e Startimit të Nivelit të Urdhëruar (e shprehur me Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit dhe minutën e fillimit) të një urdhërese “n” nga një Aktivizim i Ofertës për Blerje ose një urdhërese “n” nga një Aktivizim i Ofertës për Shitje për Njësinë Balancuese “b” ;
XMR _b	është kapaciteti i rezervuar (në MW) me një Kontratë të Shërbimeve Ndhmëse për Margjinën e Kapacitetit Rezervë për një Njësi Balancuese “b” ;
XMRN _b	është kapaciteti (në MW) i rezervuar me një Kontratë të Shërbimeve Ndhmëse për Margjinën Negative të Kapacitetit Rezervë për një Njësi Balancuese “b” ;
XN _{bj}	është mesatarja në MW për orë e Nominimit Fizik ose Nominimit të Kapaciteteve Interkonektive i konfirmuar për Njësinë Balancuese “b” për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j” ;
XNU _{bn}	është Niveli i Urdhëruar në MW i një urdhërese “n” nga një Aktivizim i Ofertës për Blerje ose një urdhërese “n” nga një Aktivizim i Ofertës për Shitje për Njësinë Balancuese “b” ;
XPPDFZ _A	është Parashikimi i Pikut Ditor të Furnizuesit “A” gjatë periodës së Konsumit të Pikut ;
XPU _{bj}	është Pozita e Urdhëruar mesatare në MW për orë i një urdhërese “n” nga një Aktivizim i Ofertës për Blerje ose një urdhërese “n” nga një Aktivizim i Ofertës për Shitje për Njësinë Balancuese “b” ;
XRrP _A	është Kapaciteti i Rrjetit për Prodhues për Llogarinë e Injektimit ;

1.8 Çmimet e Rregulluara


1.8.1 Përkundër procedurave të parashtruara në këto **Rregulla të Tregut**, është pranuar që zhvillimi i konkurrencës në Kosovë mund të jetë i pamjaftueshëm për caktimin e çmimeve, prandaj **ZRrE** mund të njoftojë **OT** se cili do nga çmimet e mëposhtme të përdorura në operim të sistemit ose në **Barazimin Përfundimtar** mund të zëvendësohen me një **Çmim të Rregulluar** për të gjitha **Periodat e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit “j”**:

- (a) çmimi i **Ofertës për Blerje** ($\zeta_{OB_{bj}}$), për një **Njësi Balancuese “b”**, për një **Palë të Posaçme** ose për të gjitha **Palët Tregtare**;
- (b) **Çmimi i Jobalancit** (ζ_{JB_j});
- (c) çmimi i **Ofertës për Shitje** ($\zeta_{OS_{bj}}$), për një **Njësi Balancuese “b”**, për një **Palë të Posaçme** ose për të gjitha **Palët Tregtare**;
- (d) **Çmimi i Rezervës për Shërbimet Ndhmëse** ($\zeta_{R_{ShN}}$) në një **Kontratë të Shërbimeve Ndhmëse “ShN”** për një **Palë të Posaçme** ose cilëndo **Palë Tregtare**;

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 33 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (e) **Çmimi i Rezervës Negative për Shërbimet Ndhmëse** (CRN_{ShN}) në një **Kontratë të Shërbimeve Ndhmëse "ShN"** të bërë me një **Palë të Posaçme** ose cilëndo **Palë Tregtare**;
- (f) **Çmimi i Shfrytëzimit të Shërbimeve Ndhmëse** ($ÇSh_{ShN}$) në një **Kontratë të Shërbimeve Ndhmëse "ShN"** të bërë me një **Palë të Posaçme** ose cilëndo **Palë Tregtare**.

1.8.2 Kur aplikohet ndonjë **Çmim i Rregulluar Relevant**, **OT** do të publikojë këtë çmim dhe do ta përdorë atë si zëvendësim të cilit do çmim të përdorur në operim të sistemit ose në **Barazimin Përfundimtar** por për të shmangur dyshimet, **OT** nuk do të bëjë modifikimin e kalkulimeve të specifikuara në këto **Rregulla të Tregut**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 34 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		


2 Palët dhe Llogaritë

2.1 Palët në Rregullat e Tregut


2.1.1 **Pala** është një person juridik, që sipas **Marrëveshjes Kornizë të Rregullave të Tregut** apo **Marrëveshjes për Aderim në Rregullat e Tregut** është e obliguar të zbatojë **Rregullat e Tregut**.

2.1.2 Para aderimit në **Rregullat e Tregut**, një **Palë** duhet të ketë **Licencë** në përputhje me Ligjin për një ose më shumë **Funksione Pjesëmarrëse** (që do të aplikohet për atë **Palë** kur kryen funksionin përkatës, por nuk përjashtohet mundësia që e njëjta **Palë** mund të kryejë edhe aktivitete tjera sipas ndonjë **Funksioni Pjesëmarrës** tjetër që ata kanë të drejtë të kryejnë)


- (a) **OT**, do të jetë përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregtimeve të energjisë elektrike para kohës reale dhe proceseve pas kohës reale të **Barazimit Përfundimtar** ndërmjet të gjitha palëve në **Rregullat e Tregut**. Veçanërisht, **OT** nuk do të tregtojë dhe nuk do të regjistrohet si pronar i energjisë ose kapaciteteve gjeneruese por do të:
- i. menaxhojë procesin e **Aderimit** në **Rregullat e Tregut** për të gjitha **Palët**;
 - ii. mirëmbajë Llogaritë e rrjedhave të energjisë dhe pagesave në emër të Palëve Tregtare, PPB, OSSh dhe OST;
 - iii. menaxhojë procesin e Barazimit Përfundimtar, duke përfshirë edhe kalkulimin e jobalanceve dhe çmimeve (duke përfshirë, ku aplikohen, Çmimet e Rregulluara);
 - iv. lëshojë fatura dhe inkasojë paratë që u janë borxh ose që i kanë borxh PPB ose Palët Tregtare sipas kushteve në Rregullat e Tregut;
 - v. menaxhojë proceset e Modifikimit të Rregullave të Tregut;
 - vi. ofrojë informatat e Tregut në përputhje me dispozitat e Rregullave të Tregut;
 - vii. themelojë AAM për procesimin e të Dhënave Matëse që grumbullohen nga Sistemet Matëse të kyçura në Sistemin e Transmetimit ose Sistemin e Shpërndarjes para përdorimit të tyre në kalkulimet e Barazimit Përfundimtar;
 - viii. themelojë ose caktojë bashkërisht me **OST** një operator (**PX**) për **Tregun e Organizuar të Energjisë Elektrike** për tregtimin e energjisë në baza një ditë para (D-1) dhe brenda ditore (D); dhe
 - ix. realizojë të gjitha funksionet tjera që i janë caktuar në **Rregullat e Tregut**;
- (b) **OST**, do të jetë përgjegjës për **Balancimin** fizik të **Sistemit të Transmetimit**. Në veçanti **OST** do të:
- i. menaxhojë Sistemin e Transmetimit në përputhje me kushtet e Kodit të Rrjetit;
 - ii. operojë çdo Njësi Ruajtjeje të OST-së në përputhje me kushtet e Kodi i Punës i Njësive të Ruajtjes të OST-së dhe mbajë një Llogarie të Injektivit ekskluzivisht për regjistrimin e vëllimeve të Energjisë së Njehsuar dhe pagesave për Barazimin Përfundimtar financiar të energjisë së injektuar ose të marrë nga Sistemi i Transmisionit ose (sipas rastit) Sistemi i Shpërndarjes;

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 35 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		


- iii. blejë ose shesë energji dhe kapacitete për Shërbimet ndihmëse, Humbjet në Transmetim, dhe energjinë Balancuese;
 - iv. bashkëpunon në llogaritjen e Shkëmbimeve të Paqëllimshme;
 - v. parashikojë konsumin e sistemit të cilin ua komunikon të gjithë pjesëmarrësve tjerë në Treg;
 - vi. dorëzojë OT të gjitha të dhënat e kërkuara për nevojat e Barazimit Përfundimtar;
 - vii. kryejë të gjitha detyrat tjera që i janë caktuar në Rregullat e Tregut;
 - viii. përveç si theksohet në paragrafin (b).ii, OST nuk do të tregtojë ose nuk do të regjistrohet si pronar i energjisë ose kapaciteteve gjeneruese;
 - ix. themelojë ose caktoj bashkërisht me OT një operator (a PX) për Tregun e Organizuar të Energjisë Elektrike për tregtimin e energjisë në baza një ditë para (D-1) dhe brenda ditore (D); dhe
 - x. shfrytëzojë **OT** si agent të vet për **Barazimin Përfundimtar** financiar për kontratat e shërbimeve të **OST** dhe inkasimin e të hyrave nga tarifat;
- (c) **Bursat e Energjisë Elektrike (PX)** të cilat do të jenë përgjegjëse për operimin një **TOEE** në përputhje me rregullat e veta, në përputhje me Rregulloren përkatëse të BE-së. Në veçanti, **PX** do të:
- i. mirëmbajë rregullat dhe procedurat e veta për operimet në tregjet një dite para dhe brenda ditës për **Palët**;
 - ii. mirëmbajë dhe të operojë procedurat për aderimin dhe anëtarësimin në bursat për treg të organizuar të **Palëve** që bien dakord të respektojnë procedurat e saj;
 - iii. veprojnë si palë kontraktuale kundrejt të gjitha tregtimeve të kryera nëpërmjet bursës së saj;
 - iv. kur është i emëruar si NEMO, marrë pjesë në organizimin dhe barazimin përfundimtar **të Tregut** të Bashkuar me **TOEE** fqinje në përputhje me rregulloret e **BE-së**;
 - v. paraqesë **Nominimet Kontraktuale** në emër të saj dhe në emër të palës tjetër për secilin tregtim të tillë të **OT-ja** përpara Kohës së Mbylljes së Tregut përkatës;
 - vi. njoftojë **OT-në** sa më shpejt që të jetë e mundur pas operimit të tregut të saj **të një dite para** për çmimin e përcaktuar të tregut (**Çmimi i Bursës-PX**);
- (d) **OSSH** (të), do të jenë përgjegjës për menaxhimin e **Sistemit të Shpërndarjes** dhe sigurimin e informatave për regjistrimin e **Sistemeve Matëse** dhe **Leximeve të Njehsorëve** dhe në veçanti do të:
- i. menaxhojnë **Sistemin e Shpërndarjes** në përputhje me kushtet e Kodit të Shpërndarjes;
 - ii. blejnë energji për mbulimin e Humbjeve në Shpërndarje dhe (në qoftë se kërkohet nga gjeneratorët e kyçur në Sistemin e Shpërndarjes) Shërbimet Ndihmëse por në asnjë mënyrë tjetër nuk do të tregtojnë energji dhe nuk do të jenë të regjistruar si pronarë i kapaciteteve gjeneruese;
 - iii. mbajnë një regjistër të Konsumatorëve në Nevojë; dhe

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 36 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- iv. dorëzojnë **OT** të gjitha të dhënat që kërkohen për nevoja të **Barazimit Përfundimtar**;
- (e) **Prodhuesit** (përveç **Njësive Gjeneruese BRE** që operojnë si **Njësi Gjeneruese BRE të Rregulluara** ose **Njësi Gjeneruese BRE në Skemën Mbështetëse** por duke i përfshirë edhe të tjera që operojnë si **Njësi Gjeneruese BRE**), do të jenë **Palë Tregtare** dhe anëtar të **Grupeve Balancuese** dhe do të kenë një **Llogari të Injektivit** për regjistrimin e **Nominimeve Kontraktuale, Energjisë së Matur** dhe pagesave si rezultat i **Barazimit Përfundimtar**. Në veçanti **Prodhuesit** do të:
- i. operojnë në përputhje me kodet teknike (**Kodin e Rrjetit, Kodin e Shpërndarjes dhe Kodet e Matjes**);
 - ii. nominojnë prodhimin e tyre në përputhje me **Kodin e Rrjetit** (Kodi i Planifikimit Operativ, Neni 4) dhe nenin 11.1 të **Rregullave të Tregut**;
 - iii. nominojnë tek **OT**, tek **PPB** relevant dhe tek **OST**, sasinë e energjisë që do ta tregtojnë me **Palët Tregtare** në përputhje me nenin 11.2;
 - iv. dorëzojnë **Ofertat për Blerje** dhe **Ofertat për Shitje** në **Tregun Balancues** si **OSB** (që janë kualifikuar si të tillë në përputhje me **Procedurën e Rregullave të Tregut**) për të cilët **Aderimi** në këto **Rregulla të Tregut** paraqet një marrëveshje për aplikimin e kualifikimit dhe ofrimin e këtyre shërbimeve në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike;
 - v. dorëzojnë informatat për leximet e njehsorëve për të gjithë energjinë elektrike të dorëzuar në **Sistemin e Transmetimit** ose **Sistemin e Shpërndarjes** nga stabilimentet e tyre dhe nuk do të liferojnë energji elektrike në **Sistemin e Transmetimit** apo në **Sistemin e Shpërndarjes** jashtë dispozitave të **Rregullave të Tregut**. (Leximet e njehsorëve do të dorëzohen nga ana e **Operatorit** relevant të **Rrjetit** që vepron si agjent i **Palës**); dhe
 - vi. kryejnë të gjitha obligimet tjera që parashtrohen në **Rregullat e Tregut**;
- (f) **Operatori i Energjisë Ripërtëritshme**, i cili do të jetë **Palë Tregtare** dhe **PPB** dhe i cili do të:
- i. krijojë dhe operojë Fondin Mbështetës për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë për regjistrimin e Njësive Gjeneruese të BRE;
 - ii. veprojë si **PPB** dhe të bëjë kontrata dypalëshe ose Kontrata për Diferencën me Njësitë përkatëse gjeneruese të Skemës së Mbështetjes së BRE;
 - iii. alokojë energjinë e parashikuar përmes **Nominimeve Kontraktuale** me **Furnizuesit** në përputhje me Ligjislacionin në fuqi;
 - iv. alokojë kostot e jobalancit për Njësitë Gjeneruese të Skemës Mbështetëse të BRE;
 - v. shesë energjinë e ripërtëritshme, të blerë sipas kontratës dypalëshe në emër të Fondit Mbështetës për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë; dhe
 - vi. t'u ngarkojë furnizuesve **Taksën e Energjisë së Ripërtëritshme**;


	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 37 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (g) **Njësitë Gjeneruese BRE**, që nuk do të jenë **Palë Tregtare**, dhe **Njësitë Gjeneruese BRE** të cilat do të jenë të regjistruara nga **OER** në **Fondin Mbështetës për Burimet e Ripërtëritshme** do të:
- i. Dorëzojnë parashikimin e prodhimit për orë tek **OER** si **Nominim Fizik**;
 - ii. Dorëzojnë **Nominimet Kontraktuale** tek **OER** për nevoja të kalkulimit të jobalanceve
 - iii. Kryejnë të gjitha obligimet tjera që janë përcaktuar në **Rregullat e Tregut**.
- (h) **Operatorët e Ruajtjes** të cilët janë **Palë Tregtare** dhe anëtarë të **Grupeve Balancuese** (ose **OST**) të cilët janë të aprovuar nga **ZRRE** për të operuar **Sistemet e Ruajtjes** dhe të cilët do të:
- i. mbajnë një **Llogari të Injektivimit** për regjistrimin e vëllimeve të **Energjisë së Njehsuar (Matur)** dhe pagesat për **Barazimin Përfundimtar** financiar të energjisë së injektuar ose marrë nga **Sistemi i Transmetimit** ose **Sistemi i Shpërndarjes**;
 - ii. marrin energji elektrike nga **Sistemi i Transmetimit** ose **Sistemi i Shpërndarjes**;
 - iii. injektojnë energji elektrike në **Sistemin e Transmetimit** ose **Sistemin e Shpërndarjes**;
 - iv. operojnë në përputhje me kodet teknike përkatëse (**Kodi i Rrjetit**, **Kodi i Shpërndarjes** dhe kodet përkatëse të Matjes);
 - v. njoftojnë nivelet e prodhimit të gjenerimit (positiv ose negativ) në përputhje me Kodin e Rrjetit (**Kodi i Skedulimit**) dhe seksionin 11.1;
 - vi. njoftojnë OT-në, PPB-në përkatëse dhe OST-në, për sasinë e energjisë që do të tregtohet me Palët e tjera Tregtare në përputhje me seksionin 11.2;
 - vii. i nënshtrohen kushteve të çdo Kodi të Punës në fuqi, dorëzojnë Ofertat për blerje dhe Ofertat për shitje në Tregun Balancues si **OShB** (dhe duke u kualifikuar si të tillë në përputhje me Procedurën përkatëse të Rregullave të Tregut) për të cilën Aderimi në këto Rregulla të Tregut përfaqëson një marrëveshje për të aplikuar për kualifikim dhe për të ofruar shërbime të tilla në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike;
 - viii. dorëzojnë informacionin e leximit të njehsorëve për të gjithë energjinë e dorëzuar ose të pranuar në/nga Sistemin e Transmetimit ose Sistemin e Shpërndarjes nga objektet e tyre dhe të mos dorëzojnë ose pranojnë asnjë energji në/nga Sistemin e Transmetimit ose Sistemin e Shpërndarjes jashtë kushteve të Rregullave të Tregut. (Leximi i njehsorit do të dorëzohet nga Operatori përkatës i Rrjetit që vepron si agjent i Palës); dhe
 - ix. marrin përsipër të gjitha detyrimet e tjera të përcaktuara në Rregullat e Tregut;
- (i) **Furnizuesit**, do të jenë **Palë Tregtare** dhe anëtar të **Grupeve Balancuese** dhe do të kenë një **Llogari Dalëse** për regjistrimin e **Nominimeve Kontraktuale**, **Energjisë së Matur** dhe pagesave si rezultat i **Barazimit Përfundimtar**. Në veçanti, **Furnizuesit** do të:
- i. bëjnë kontrata me **Konsumatorët fundor** dhe do të jenë përgjegjës për energjinë elektrike të dhënë nëpërmjet **Njehsorëve të Furnizimit** të kësaj natyre

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 38 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Sistemin e Transmetimit ose Sistemin e Shpërndarjes dhe të regjistruar në **Llogaritë Dalëse** të tyre;

- ii. operojnë në përputhje me kodet teknike (**Kodin e Rrjetit, Kodin e Shpërndarjes dhe Kodet e Matjes**);
 - iii. nominojnë tek **OT**, tek **PPB** relevant dhe tek **OST** konsumin e energjisë për **Konsumatorët fundor** të tyre në përputhje me nenin 11.1;
 - iv. nominojnë tek **OT**, tek **PPB** relevant dhe tek **OST** sasinë e energjisë që do të tregtohet me **Palët Tregtare** në përputhje me nenin 11.2;
 - v. dorëzojnë leximet e njehsorëve për gjithë energjinë e marrë në këta **Njehsorë**. Në rastin e **Furnizuesit Publik**, energjia elektrike e konsumuar nga **Konsumatorët fundor** që gëzojnë të drejtën e **Shërbimit Universal** duhet të paraqitet ndaras nga konsumi i **Konsumatorëve fundor** të tjerë;
 - vi. dorëzojnë **Oferta për Blerje** dhe për **Shitje** në **Tregun Balancues** si **PPB** (në qoftë se janë kualifikuar si të tillë në përputhje me **Procedurën e Rregullave të Tregut**); dhe
 - vii. kryejnë të gjitha obligimet tjera që janë parashtruar në **Rregullat e Tregut**;
- (j) **Konsumatori me Shumicë**, të cilët për qëllime të **Rregullave të Tregut** mund të kenë **Funksionet Pjesëmarrëse** si:
- i. **Konsumatorët me Shumicë** (që gjithashtu mund të inkorporojë **Funksionin Pjesëmarrës** si **Tregtar Ndërkufitar**), do të jenë **Palë Tregtare** dhe anëtar të **Grupeve Balancuese** dhe do të kenë një **Llogari të Injektivit** ose një **Llogari Dalëse** për regjistrimin e **Nominimeve Kontraktuale** dhe pagesave për **Barazimin Përfundimtar** financiar. Në veçanti, **Konsumatori me Shumicë** do të:
 - (1) nominojnë një ditë para (D-1) tek **OT**, **PPB** relevant dhe **OST** sasinë e energjisë që duhet të tregtohen në ditën D me **Palët Tregtare** tjera, në përputhje me nenin 11.2; dhe
 - (2) kryejnë të gjitha obligimet tjera të parashtruara në **Rregullat e Tregut**; dhe/ose
 - ii. **Tregtarët Ndërkufitar** do të jenë **Palë Tregtare** dhe anëtar të **Grupeve Balancuese**, që për qëllim të **Barazimit Përfundimtar** financiar si **Njësi Balancuese Ndërkufitare**, do të kenë një **Llogari të Injektivit** për import të energjisë dhe **Llogari Dalëse** për eksport të energjisë ku do të bëhet regjistrimi i energjisë dhe pagesave në bazë të **Nominimeve Kontraktuale** dhe **Nominimeve Fizike**. Në veçanti, **Tregtarët Ndërkufitar** do të:
 - (1) nominojnë një ditë para (D-1) tek **OT**, **PPB** relevant dhe **OST** sasinë e energjisë që duhet të importohet ose eksportohet fizikisht në interkoneksione dhe që është tregtuar me **Palët Tregtare** tjera, në Kosovë për ditën D në përputhje me nenin 10; dhe
 - (2) kryejnë të gjitha obligimet tjera që janë parashtruar në **Rregullat e Tregut**;
- por nuk do të kenë të regjistruar ndonjë **Njehsor** fizik.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 39 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

2.1.3 **Aderimi në Rregullat e Tregut** është i obligueshëm për të gjithë të licencuarit, dhe personat juridik të cilët nuk kanë nevojë për licencë, me përjashtim të personave juridik stabilimentet e të cilëve janë të kyçur në **Rrjetin e Shpërndarjes**, dhe dëshirojnë të kenë Njehsor fizik të regjistruar në një **Llogari të Furnizuesit** nga ana e **AAM**:

2.1.4 Referenca për një **Palë Tregtare** do të jetë referencë për atë **Palë** që është përfshirë në cilindro nga rolet e specifikuar në paragrafin 2.1.1 pa marrë parasysh ndonjë rol tjetër me të cilën kjo **Palë** gjithashtu mund të ketë **Aderuar** në **Rregullat e Tregut**.

2.1.5 Çdo **Palë Tregtare** mund të emërohet si **Palë e Posaçme** nga ana e **ZRrE**. **Pala e Posaçme** sipas **Rregullave të Tregut** do të trajtohet njëjtë me **Palët Tregtare** tjera, përveç kur parashtrihen kushte specifike në këto **Rregulla të Tregut**.

2.1.6 Të gjitha **Palët** në **Rregullat e Tregut** duhet të kenë licencë valide ose në mënyrë valide janë të përjashtuar nga nevoja për të pas licencë, përndryshe duhet ta informojnë **OT** me kohë dhe të iniciojnë proceset e përshkuara në nenin 3.4.

2.2 Llogaritë

2.2.1 **OT** do të mirëmbajë **Llogaritë** për vete, për **OST**, për **OSSH**, për **PX**, për **PPB** dhe për **Palët Tregtare**.

2.2.2 **Llogaria e Tregtimit e OST** është **Llogaria** për **Barazimin Përfundimtar të Jobalancve** të shkaktuara nga ana e **OST**.

2.2.3 **Llogaria** e mirëmbajtur për **OSSH** është **Llogaria** për **Barazimin Përfundimtar të Jobalanceve**.

2.2.4 **Llogaria Balancuese e OST** do të jetë **Llogaria** për **OST** që nuk ka të bëjë me **Barazimin Përfundimtar të Jobalanceve të OST**.


2.2.5 **OT** do të mirëmbajë **Llogaritë** për **Palët Tregtare** duke regjistruar ndër të tjera:

- (a) **Pagesat e Ofertave për Shitje;**
- (b) **Pagesat e Ofertave për Blerje;**
- (c) **Pagesat për Shfrytëzimin e Shërbimeve Ndhmëse;**
- (d) **Sasitë e Nominimeve Kontraktuale; dhe**
- (e) **Energjinë e Matur;**

si kategori të veçanta për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalancit**; për çdo kategori, **OT** do të regjistrojë pagesat debituese apo kredituese në **Llogarinë e OST** apo të **OT**.

2.2.6 Për çdo anëtar të **Grupeve Balancuese** relevante, **OT** do të mbajë **Llogaritë** për **PPB** në të cilat, ndër të tjerat do të regjistrohen në mënyrë të agreguar edhe:

- (a) **Pagesat për Liferimin e Ofertave për Blerje;**
- (b) **Pagesat për Liferimin e Ofertave për Shitje;**
- (c) **Pagesat për Shfrytëzimin e Kontratës për Shërbime Ndhmëse;**
- (d) **Pagesat për Jobalancet;**
- (e) **Sasitë e Nominimeve Kontraktuale; dhe**

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 40 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

(f) **Energjinë e Matur;**


Si rresht të ndarë për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalancit** për pagesat për **Jobalance, OT** do të bëjë pagesat e kundërta në **Llogarinë** relevante **OST** ose **OT**.

2.2.7 **OT** do të mirëmbajë Llogarinë për **Fondin Mbështetës për Burimet e Ripërtërishme Energjisë** në emër të **OER** si **Llogari të injektimit** për regjistrimin e **Njësive Gjeneruese BRE të Rregulluara** dhe **Njësive Gjeneruese BRE në Skemën Mbështetëse** dhe do të bëjë regjistrimin e informatave vijuese në emër të tyre:

- (a) Sasitë e **Nominimeve Kontraktuale;**
- (b) **Energjinë e Matur;** dhe
- (c) Pagesat për **Jobalancet.**

dhe realizimin e transaksioneve me **Furnizuesit.**

2.2.8 Llogaria Balancimuese e PX do të jetë një llogari për PX që nuk i nënshtrohet Barazimit Përfundimtar të Jobalancit.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 41 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

3 Aderimi në Rregullat e Tregut, Themelimi i PPB dhe Tërheqja

3.1 Dispozitat e Përgjithshme

3.1.1 Që të mund të marrin pjesë në **Treg**, të gjitha **Palët** duhet të **Aderojnë** në **Rregullat e Tregut**. Procedura e pjesëmarrjes është e njohur si **Aderim** dhe kërkon nga **Pala** që të pajtohet me obligimet që dalin nga **Rregullat e Tregut**. Ky **Aderim** do të realizohet ose nëpërmes **Marrëveshjes Kornizë të Rregullave të Tregut** ose nëpërmes **Marrëveshjes për Aderim në Rregullat e Tregut**.

3.1.2 **Palët** Origjinale e kanë nënshkruar **Marrëveshjen Kornizë të Rregullave të Tregut** kurse **Palët** e reja nënshkruajnë **Marrëveshjen për Aderim në Rregullat e Tregut**. Me nënshkrimin e **Marrëveshjes për Aderim në Rregullat e Tregut**, **Pala** e re fiton të drejtat dhe përgjegjësitë sikurse të kishte nënshkruar **Marrëveshjen Kornizë të Rregullave të Tregut**.

3.1.3 Forma e **Marrëveshjes për Aderim në Rregullat e Tregut** është paraqitur në Shtojcën 1 të **Rregullave të Tregut**.

3.2 Aderimi në Rregullat e Tregut


3.2.1 Çdo entitet juridik mund të **Aderojë** në **Rregullat e Tregut** duke shfrytëzuar procedurat e parashtruara në dispozitat e këtij Neni.

3.2.2 **Pala Aplikuese** do t'i dorëzojë **OT**:

- (a) formularin e aplikimit të plotësuar si duhet në formë të tillë ashtu që **OT** mund të përshkruaj herë pas here duke dhënë Detajet e Palës së saj si në kohën e aplikimit. Informatat e prezantuara në formularin e aplikimit mund t'i përdorë sipas nevojë; dhe
- (b) një dëshmi nga **Pala Aplikuese** (të përshkruar në formularin e aplikimit) që **Informatat e Palës Aplikuese** janë complete dhe të sakta.

3.2.3 **Informatat e Palës** do të përfshijnë:

- (a) Emërtimin e plotë dhe të dhënat kontaktuese;
- (b) Emrin, adresën, postën elektronike dhe numrin e faksit të personit të cilit duhet t'i drejtohen njoftimet zyrtare me shkrim;
- (c) **Funksionet Pjesëmarrëse** (nëse ekzistojnë) të cilat **Pala Aplikuese** i ka, ose informatat për funksionet të cilat **Pala Aplikuese** njofton **OT** se pretendon t'i ketë dhe data nga e cila i ka ose pretendon të ketë këto role duke përfshirë çdo obligim për shërbim publik që **Rregullatori** ta ketë caktuar ose pritët ta caktoj për **Palën Aplikuese** duke përfshirë dhe natyrën e një obligimi të tillë;
- (d) për çdo **Funksion Pjesëmarrëse** të **Palës Tregtare**, **Pala Tregtare** e nominuar e cila do të veproj si **PPB** në emër të vet (për eliminimin e dyshimeve, **Pala Aplikuese** mund të nominoj vet veten);
- (e) kur **Pala Tregtare** do të veproj si **PPB**, duhet të nënshkruaj marrëveshjen në formën e paraqitur në Shtojcën 2;
- (f) dokumentacionin përcjellës që **OT** mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme me qëllim që të vlerësojë se cilat **Funksione Pjesëmarrëse** i ka ose do t'i ketë **Pala Aplikuese**;
- (g) identitetin e çdo **Pale** tjetër e cila është **Person i Ndërvarur** me **Palën Aplikuese**; dhe

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 42 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (h) çdo informatë tjetër që **OT** mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme për t'i mundësuar **OT** që të përmbushë aktivitetet e përshkruara në **Licencë** dhe në **Rregullat e Tregut**.

3.2.4 Pas pranimit të shënimeve të referuara në paragrafin 3.2.3, **OT** do të:

- (a) verifikojë që formulari i aplikimit është kompletuar si duhet nga ana e **Palës Aplikuese** dhe se është pranuar dokumentacioni përcjellës relevant;
- (b) verifikojë që **PPB** i nominuar (në qoftë se nuk është **Palë Aplikuese**) ka, ose do të ketë **Llogari të Injektimit të PPB** ose **Llogari të Daljes të PPB** në përputhje me **Funksionin Pjesëmarrës** të propozuar të **Palës Aplikuese** dhe që **PPB** i nominuar dëshiron të veproj si **PPB për Palën Aplikuese**;
- (c) njoftojë:
- i. të gjitha **Palët**; dhe
 - ii. **ZRrE**;
për emrin e **Palës Aplikuese** dhe **Funksionin Pjesëmarrës** (nëse ka) që janë paraqitur nga **Pala Aplikuese** në **Informatat e Palës**, dhe
- (d) përgatisë dhe dërgojë **Marrëveshjen për Aderim në Rregullat e Tregut** për nënshkrim **Palës Aplikuese** kur e konsideron të përshtatshme dhe sa më shpejt që është e mundur.

3.2.5 Çdo **Palë** në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar autorizon **OT** që të nënshkruajë në emër të kësaj **Pale**, **Marrëveshjen për Aderim në Rregullat e Tregut** të nënshkruar nga **Pala Aplikuese**.


3.2.6 **OT** pas pranimit të **Marrëveshjes për Aderim në Rregullat e Tregut** të nënshkruar nga **Pala Aplikuese**, do të:

- (a) nënshkruajë këtë **Marrëveshje për Aderim** në emër të të gjitha **Palëve**;
- (b) dërgojë **Palës Aplikuese** një kopje të **Marrëveshjes për Aderim në Rregullat e Tregut** të nënshkruar nga **Pala Aplikuese** dhe nga **OT**;
- (c) njofton për **Aderimin e Palës Aplikuese**:
- i. të gjitha **Palët**; dhe
 - ii. **ZRrE**.

3.2.7 Në qoftë se procesi në paragrafin 3.2.6 ndërpritet nga ndonjë **Kontest** lidhur me të drejtën e **Palës Aplikuese** për të **Aderuar** në **Rregullat e Tregut** dhe nëse **ZRrE** vendosë në favor të **Palës Aplikuese**, kjo **Palë Aplikuese** ka të drejtë për të **Aderuar** në **Rregullat e Tregut** dhe **OT** do ta nënshkruajë dhe dorëzojë menjëherë **Marrëveshjen për Aderim në Rregullat e Tregut**, të nënshkruar nga **Pala Aplikuese**, me qëllim të vënies në fuqi të këtij **Aderimi**.

3.2.8 **Aderimi i Palës Aplikuese në Rregullat e Tregut** duhet të hyjë në fuqi në datën e fundit e specifikuar në **Marrëveshjen për Aderim në Rregullat e Tregut** dhe data kur **OT** e nënshkruan dhe e dorëzon këtë **Marrëveshje për Aderim në Rregullat e Tregut** në emër të të gjitha **Palëve**.

3.2.9 Pasi që **Pala** të ketë aderuar do t'i kërkojë të regjistrojë një **Llogari** dhe të sigurojë informatat e nevojshme për të mundësuar tregtimin në përputhje me procedurat relevante të tregut.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 43 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

3.2.10 **Pala** nuk mund të fillojë tregtimin, sipas **Rregullave të Tregut**, përderisa nuk i sjellë **OT** dëshminë për **Garancionin Financiar** siç specifikohet në paragrafin 8.3.1.

3.2.11 Është përgjegjësi e çdo **Pale** që të informojë **OT** për çfarëdo ndryshimi në **Informatat e Palës** sa më shpejt që është e mundur dhe **OT** duhet të bëjë azhurnimin e shënimeve të veta gjegjëse.

3.3 Palët Përgjegjëse për Balanc (PPB)

3.3.1 Çdo **Palë Tregtare** mund të aplikoj që të bëhet **PPB** në emër të një **Grupi Balancues** që përbëhet nga vet ajo **Palë Tregtare** dhe cilado **Palë Tregtare** tjetër që dëshiron të marrë pjesë në **Grupin Balancues** (por për evitimin e dyshimeve, një **Grup Balancues** mund të përbëhet vetëm nga një **Palë Tregtare** e vetme).

3.3.2 Një **PPB** është i obliguar të:

- (a) bëjë një marrëveshje me **OT**, në formën e përkufizuar në Shtojcën 2, e cila i përkufizon obligimet si **PPB**;
- (b) njoftoj **OT** për alokimin e jobalanceve të energjisë ndërmjet anëtarëve të **Grupit Balancues** për nevoja të **OT** për të kalkuluar kërkesat minimale të **Garancionit Financiar** për anëtarët e **Grupit Balancues**;
- (c) paguaj të gjitha **Faturat** që i dorëzohen nga **OT** brenda afateve kohore të caktuara pa marrë parasyshë se ndonjë anëtar i **Grupit Balancues** i ka borxh **PPB**.
- (d) bëjë përpjekje për të qenë në balanc ose të ndihmoj balancimin e sistemit. Për këtë qëllim **PPB** do të përdorë të gjitha mjetet që i ka në dispozicion duke bërë përpjekjet më të mira


3.3.3 Për çdo **PPB**, **OT** do të formoj një **Llogari të Injektimit** dhe/ose një **Llogari Dalëse** të ndarë brenda 5 **Ditëve Pune** nga aplikimi sipas paragrafit 3.3.1 dhe do të njoftoj **PPB** për datën në të cilën **Llogaria(të)** relevante do të jetë operacionale.

3.3.4 Në qoftë se një **Palë Tregtare** vendosë që të bëhet **PPB** për një **Grup Balancues** pa ndonjë **Palë Tregtare** tjetër, **Pala Tregtare** mund ta njoftoj **OT** se dëshiron që pagesat e kryera në **Barazimin Përfundimtar** të korrigojohen për nevoja të **Garancionit Financiar**.

3.3.5 Në çdo kohë, një **Palë Tregtare** mund të jetë anëtar vetëm i një **Grupi Balancues** për nevoja të injektimit të energjisë në **Sistemin Transmetues** dhe vetëm i një **Grupi Balancues** (tjetër) për nevoja të marrjes së energjisë nga **Sistemi Transmetues**.

3.3.6 Një **Palë Tregtare** mund të aplikoj që të bëhet anëtare e një **Grupi Balancues** që operohet nga një **PPB** që është një **Palë Tregtare** tjetër, në kushtet vijuese:

- (a) **PPB** relevant pajtohet të veproj në emër të **Palës Tregtare** që ka aplikuar dhe posedon **Llogarinë** e duhur të **PPB** për regjistrimin e jobalanceve të **Palës Tregtare** aplikuese;
- (b) **Pala Tregtare** pajtohet të pranoj çdo njoftim të bërë nga **PPB** për pozitën balancuese të **Palës Tregtare** për nevoja të kalkulimit të **Garancionit Financiar** minimal;
- (c) **Pala Tregtare** aplikuese pajtohet që të ndryshoj të gjitha instrumentet e **Garancionit Financiar** të saj për ti mundësuar **OT** mbulimin e kostove për çfarëdo **Fature** të paguar të **PPB**; dhe

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 44 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (d) **Pala Tregtare** pajtohet të lejoj **OT** që ti vë në dispozitim të **PPB** informatat e agreguara në lidhje me **Nominimet Kontraktuale** të **Palës Tregtare** dhe informatat e agreguara të **Informatave të Njehsorëve** të **Palës Tregtare** për nevoja të verifikimit të **Barazimit Përfundimtar**.

3.3.7 Pranohet që **OT** nuk është palë në marrëveshjen ndërmjet **PPB** dhe anëtarëve tjerë të një **Grupi Balancues** si dhe për alokimin e pagesave për energjinë e jobalanceve përbrenda **Grupit Balancues** dhe prandaj çdo mosmarrëveshje ndërmjet **PPB** dhe cilitdo anëtar tjetër të një **Grupi Balancues** nuk do të zgjidhet sipas kushteve të **Rregullave të Tregut** dhe se një mosmarrëveshje e tillë nuk mund të përdoret nga ana e **PPB** si arsye e vlershme për **Kontestim Fature** sipas kushteve të **Rregullave të Tregut**.

3.3.8 Një **Palë Tregtare** mund të pushoj të jetë anëtare e një **Grupi Balancues** me kusht që ajo palë e ka nominuar vetveten ose ndonjë **Palë Tregtare** tjetër (e cila është pajtuar për një nominim të tillë) duke i dhënë **OT** dhe **PPB** ekzistues një njoftim me shkrim brenda pesë (5) **Ditë Pune** dhe në qoftë se **PPB** ekzistues nuk e kundërshton një pushim të tillë.

3.3.9 Para Kohës së Mbylljes së Tregut ndër-zonal, çdo **PPB** mund të ndryshojë programet e kërkuara për kalkulimin e pozicionit të saj, duke u përpjekur që të jetë e balancuar ose të ndihmojë sistemin që të jetë në balanc. Një **PPB** do të përdorë të gjitha mjetet në dispozicion në bazë të përpjekjeve të arsyeshme.


3.3.10 Pas kohës së mbylljes së tregut ndër-zonal, çdo **PPB** mund të ndryshoj programet e veta komerciale të nevojshme për kalkulimin e pozicionit të saj.

3.4 Pala në Tërheqje

3.4.1 Një **Palë** mund të tërhiqet nga **Rregullat e Tregut** në përputhje me dispozitat e këtij neni
3.4. Pas pranimit të **Njoftimit për Tërheqje**, sa më parë që të jetë e mundur, **OT** do t'i njoftojë të gjitha **Palët** tjera për qëllimin e **Palës** që të ndërpres obligimin me **Rregullat e Tregut**.

3.4.2 Në çdo kohë, një **Palë** mund të aplikojë për ndërprerjen e obligimit me **Rregullat e Tregut** duke i dërguar një **Njoftim për Tërheqje ZRrE** dhe **OT**. Tërheqja do të fillojë të zbatohet pas orës 17:00 të **Datës së Tërheqjes**, e cila nuk do të jetë më parë se pesë **Ditë Pune** prej ditës që janë plotësuar të gjitha kërkesat vijuese:

- (a) është paguar çdo borxh sipas **Rregullave të Tregut** nga kjo **Palë** (pa marrë parasysh se a janë në **Kontest**);
- (b) është realizuar **Barazimi Përfundimtar** final sipas orarit për muajin e fundit (dhe janë realizuar të gjitha pagesat);
- (c) **Pala** është çregjistruar nga **Baza e Matjeve**;
- (d) **Pala** nuk ka **Njësi Gjeneruese** të regjistruar në **Llogarinë e Injektimit**;
- (e) nuk ekziston ndonjë shkelje materiale nga kjo **Palë** e dispozitave të **Rregullave të Tregut** që mund të eliminohet; dhe
- (f) kjo **Palë** nuk kushtëzohet nga **Licenca** me ndonjë kusht me të cilin kërkohet vazhdimi i obligimit me **Rregullat e Tregut**, kusht i cili do të shkelej në qoftë se një **Palë** e tillë ndërprente obligimin me **Rregullat e Tregut**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 45 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

3.4.3 Sa më shpejtë që të jetë e mundur **Pala në Tërheqje** duhet të njoftojë me shkrim **ZRrE** dhe **OT** që kërkesat e parashtruara në paragrafin 3.4.2 janë plotësuar duke njoftuar datën kur është plotësuar edhe kërkesa e fundit.

3.4.4 Pas pranimit të njoftimit nga **Pala** sipas paragrafit 3.4.3, **OT** sa më parë që të jetë e mundur do ta informojë **Palën** për **Datën e Tërheqjes** nga **Rregullat e Tregut**.


3.4.5 Pa marrë parasysh paragrafin 3.4.4, **OT** dhe **Pala në Tërheqje** kanë përgjegjësi të përbushin çdo obligim të paplotësuar ndaj njëri tjetrit ose ndaj një **Pale** tjetër pas **Datës së Tërheqjes**

- (a) për çdo obligim që duhet të paguhet sipas **Rregullave të Tregut** në krahasim me çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** para **Datës së Tërheqjes**; dhe
- (b) Për çdo shkelje të pazgjidhur të ndonjë dispozite të **Rregullave të Tregut** ku një shkelje e tillë nuk ka mundur të eliminohet (për nevoja të paragrafit 3.4.2(e) ose ka mundur të eliminohet por nuk është eliminuar

3.5 Dështimi


3.5.1 Për nevoja të këtij neni **Dështimi** i një **Pale (Pala Dështuese)** do të ketë ndodhur në kushtet ose rrethanat vijuese:

- (a) Kur ka të bëjë me detyrimin e **Palës Dështuese** për ndonjë shumë parash sipas **Rregullave të Tregut** por që nuk kanë të bëjnë me **Pagesat e Palës së Tretë**, të cilat duhet paguar nga **Pala Dështuese** sipas **Rregullave të Tregut** për këto raste:
 - i. **Pala Dështuese** nuk e ka paguar plotësisht shumën e parave brenda katërbëdhjetë (14) **Ditë Pune** pas datës së caktuar për pagesë;
 - ii. **OT** e ka njoftuar me shkrim **Palën Dështuese** ku kërkon pagesën e kësaj shume në ose pas katërbëdhjetë (14) **Ditë Pune** të datës të caktuar për pagesë; dhe
 - iii. **Pala Dështuese** nuk e ka paguar plotësisht një shumë të tillë parash për shtatë (7) **Ditë Pune** pas datës së njoftimit të **OT** sipas paragrafit 3.5.1(a)ii; ose
- (b) kur:
 - i. **Pala Dështuese** ka bërë shkelje materiale të dispozitave materiale (të ndryshme nga obligimi për pagesë) të **Rregullave të Tregut**; dhe
 - ii. Shkelja mund të eliminohet nga **Pala Dështuese**; dhe
 - iii. **OT** i ka dhënë **Palës Dështuese** një njoftim me shkrim (duke iu referuar këtij paragrafi 3.5.1(b) për një shkelje të tillë; dhe
 - iv. brenda katërbëdhjetë (14) **Ditë Pune** pas njoftimit nga ana e **OT** sipas paragrafit 3.5.1(b)iii, **Pala Dështuese** nuk e eliminon shkeljen në të gjitha aspektet materiale, kur shkelja është e natyrës që mund të eliminohet brenda një periode prej katërbëdhjetë (14) **Ditë Pune**; ose
 - v. kur shkelja nuk mund të eliminohet brenda katërbëdhjetë (14) **Ditë Pune**, brenda shtatë (7) **Ditë Pune** pas njoftimit të **OT**, **Pala Dështuese** duhet t'i dorëzojë **OT** një program për eliminimin e shkeljes sa më shpejtë që të jetë e mundur (duke parashtruar hapat që do të ndërmerren nga ana e **Palës Dështuese** dhe afatet kohore për realizimin e këtyre hapave); dhe

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 46 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- vi. në rastin si në paragrafin 3.5.1(b)v:
- (1) **Pala Dështuese** nuk eliminon shkeljen në të gjitha aspektet materiale me një kujdes të arsyeshëm dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur në përputhje me programin e dorëzuar sipas paragrafit 3.5.1(b)v ose sipas një programi të reviduar sipas paragrafit 3.5.1(b)vi(2); ose
 - (2) përkundër kujdesit të arsyeshëm të **Palës**, për **Palën** nuk është e mundur që të eliminojë shkeljen në përputhje me këtë program dhe **Pala Dështuese** nuk i dorëzon **OT** një program të reviduar;
- vii. shkelja mbetet e pa eliminuar në çfarëdo aspekti material pas skadimit të shtatë (7) **Ditë Pune** pas një njoftimi pasues me shkrim nga ana e **OT** për **Palën Dështuese** me faktin që **Pala Dështuese** nuk i është përmbajtur paragrafit 3.5.1(b)iv ose paragrafit 3.5.1(b)v; ose
- (c) kur:
- i. **Pala Dështuese** ka bërë shkelje materiale të cilësdo dispozitë relevante të **Rregullave të Tregut** (të ndryshme nga obligimi për pagesë); dhe
 - ii. Shkelja nuk mund të eliminohet; dhe
 - iii. **OT** i ka dhënë **Palës Dështuese** një njoftim për shkeljen;
 - iv. në çdo kohë brenda periodës prej dymbëdhjetë (12) muajsh pas njoftimit të **OT** sipas paragrafit 3.5.1(c)iii, është paraqitur përsëritja e shkeljes materiale nga ana e **Palës Dështuese** e të njëjtës dispozitë relevante të **Rregullave të Tregut**; dhe
 - v. **OT** i ka dhënë një njoftim **Palës Dështuese** për një shkelje të përsëritur dhe ka skaduar perioda prej shtatë (7) **Ditë Pune** pas këtij njoftimi; ose
- (d) kur:
- i. **Pala Dështuese** i suspendon pagesat e borxheve të veta ose e pranon pamundësinë e saj për të paguar borxhet e veta; ose
 - ii. **Pala Dështuese** nuk është në gjendje t'i paguajë borxhet e veta ose është propozuar ndonjë aranzhim vullnetar për këto borxhe ose ka hyrë në ndonjë strukturë tjetër organizative (përveç për qëllim të rindërtimit të mirëbesimit të mundësisë së pagimit apo është shkruar në një kompani tjetër); ose
 - iii. **Pala Dështuese** e ka bartur tek një palë tjetër tërë ose një pjesë të aseteve të veta ose ka marrëveshje për bartje të aseteve; ose
 - iv. **Pala Dështuese** e ka pranuar një urdhëresë administrative; ose
 - v. **Pala Dështuese** anashkalon ndonjë vendim për zgjidhje alternative (përveç për qëllim të rindërtimit të mirëbesimit të mundësisë së pagimit apo është shkruar në një kompani tjetër); ose
- (e) kur **Licenca** e lëshuar për **Palën Dështuese** ka skaduar apo është revokuar ose për çfarëdo arsye tjetër pushon të jetë në fuqi.

3.5.2 Për nevoja të paragrafit 3.5.1(b)i dhe paragrafit 3.5.1(c)i një shkelje e paqëllimshme e dispozitave të **Rregullave të Tregut** përjashtohet kur **Rregullat e Tregut** japin ndonjë mundësi

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 47 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

tjetër të korrjigimit të një shkelje të tillë dhe që një korrjigim i tillë konsiderohet adekuat për këto rrethana.

3.5.3 Për nevoja të paragrafit 3.5.1(b)i dhe paragrafit 3.5.1(c)i një shkelje është shkelje materiale e dispozitave të caktuara, atëherë dhe vetëm atëherë kur shkelja e një dispozite materiale është e qëllimshme apo e papërgjegjshme, ose kur në rast të ndonjë dispozite tjetër si rezultat i shkeljes një **Palë** tjetër mund të bëjë shkelje të ndonjë dispozite materiale të **Rregullave të Tregut**, ndonjë kërkesë legale apo shkakton ndonjë detyrim material ose shpenzim që tejkalon vlerën €1000.

3.6 Pasojat e Dështimit

3.6.1 Pas paraqitjes së një **Dështimi**, dhe në çdo kohë derisa vazhdon një **Dështim** i tillë, pasi të ketë marrë aprovimin me shkrim nga **ZRrE, OT** mund të ndërmarrë një ose më shumë nga hapat vijues përderisa një **Dështim** i tillë ekziston dhe vazhdon të ekzistojë (për aq kohë sa e konsideron të mjaftueshme duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e **Dështimit**):

- (a) do t'i jap **Palës Dështuese** një **Njoftim për Përrjashtim**, që për pasojë ka përrjashtimin e **Palës** nga **Rregullat e Tregut**, nga data e specifikuar në njoftim (që mund të jetë data kur është dorëzuar njoftimi apo ndonjë datë pas kësaj date);
- (b) do të publikojë **Njoftimin për Përrjashtim** (duke u referuar në nenin 3.6);
- (c) do të vendosë kufizime tjera ndaj aktiviteteve tregtuese të **Palës Dështuese** për të mos lejuar rritjen e borxhit;
- (d) do të pezullojë një ose më shumë nga të drejtat sipas paragrafit 3.6.2 për **Palën Dështuese**, (pas konsultimeve paraprake ose aprovimit sipas paragrafit 3.6.1), për një periudhë kohore që **OT** e konsideron të arsyeshme dhe atë në përgjithësi ose në mënyrë graduale, tërësisht ose pjesërisht;
- (e) do të kërkojë nga **OST** ose nga **OSSh** (sipas rastit) **De-energizimin** e stabilimenteve të **Palës Dështuese** (dhe çdo **Palë** e tillë në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar pranon **De-energizimin**).


3.6.2 Të drejtat e referuara në paragrafin 3.6.1(c) janë:

- (a) e drejta për dorëzimin e **Nominimeve Kontraktuale** dhe **Nominimeve Fizike**,
- (b) e drejta për dorëzimin e **Ofertave për Blerje** dhe **Ofertave për Shitje**, dhe
- (c) e drejta për pranimin e raporteve të **tregut** dhe të dhënave të **Tregut**.

3.6.3 Ndërmarrja e cilit do hap sipas paragrafit 3.6.1 nga ana e **OT** ndaj **Palës Dështuese** nuk duhet të ndikojë ose ndryshojë detyrimet e saj sipas **Rregullave të Tregut** (që janë paraqitur në periodat para dhe pas datës kur është ndërmarrë një hap i tillë) dhe pa marrë parasysh të kaluarën, **Pala Dështuese** do të jetë përgjegjëse për pagesën e të gjitha obligimeve (duke përfshirë taksat) që kërkohen nga ajo sipas **Rregullave të Tregut** për detyrimet e tregtimeve dhe shumat tjera të parave para **De-energizimit** të stabilimenteve të **Palës Dështuese** dhe/ose **Pala Dështuese** pushon të jetë **Palë** sipas 3.6.1(a).

3.6.4 Pas kërkesës nga ana e **OT** sipas 3.6.1(e), **OST** dhe çdo **OSSh** kanë të drejtat e nevojshme të kryejnë ose prokurojnë **De-energizimin** e stabilimenteve.

3.6.5 Në përputhje me çdo urdhëresë për **De-energizimin** e stabilimenteve ose pajisjeve, të dhënë në paragrafin 3.6.1(e)


	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 48 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (a) **OST** dhe/ose **OSSH** (sipas rastit) duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të përmbushur urdhëresën (ose prokurojnë këtë shërbim) sa më shpejtë që të jetë e mundur; dhe
- (b) **OST** dhe/ose **OSSH** do ta dëmshpërblejë **OT** për çfarëdo detyrimi, humbje ose dëmtimi që mund t'i shkaktohen **OT** nga mosekzekutimi i **De-energizimit të Palës Dështuese**.

3.6.6 Dispozitat e nenit 3.6 nuk paragjykojnë asnjë të drejtë tjetër ose kompensim që shkaktohen në rast se Pala Dështuese nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Rregullave të Tregut.

3.6.7 Kur OT i jep një Pale Dështuese një Njoftim për Përrjashtim, që hyn në fuqi nga data e caktuar në njoftim, Pala Dështuese do të përjashtohet nga obligimi me Rregullat e Tregut dhe pjesa tjetër e paragrafit 3.6.1 do të aplikohet.

3.6.8 Dhënia e një **Njoftimi për Përrjashtim** dhe aplikimi i paragrafit 3.6.3 nuk do të ndikojnë në të drejtat dhe obligimet e **OT** dhe **Palës Dështuese** sipas **Rregullave të Tregut** (duke përfshirë edhe të drejtat dhe obligimet në krahasim me **Dështimin**, dhe në krahasim me shumat e parave që duhet paguar nga **Pala Dështuese** përfshirë kamatat, të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga cilado dispozitë e **Rregullave të Tregut** në lidhje me pushimin nga obligimi me **Rregullat e Tregut të Palës Dështuese**) që janë shkaktuar deri në datën që referohet në paragrafin 3.6.1(a), të cilat do të vazhdojnë të mbeten në fuqi pa marrë parasysh atë paragraf.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 49 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

4 Komunikimet Operative

4.1 Dispozitat e Përgjithshme

4.1.1 Përveç obligimit të **Palëve** që të veprojnë në përputhje me dispozitat e **Kodit të Rrjetit** për komunikimin e të dhënave operative me **OST**, **Palët** duhet të sigurojnë pajisje të besueshme për komunikime me **OT** që i plotësojnë kërkesat minimale të parashtruara në këtë nen.

4.1.2 **OT** do të përpilojë dhe publikojë protokollet e interfejsit për komunikimin e **Palëve** me softuerin e **Barazimit Përfundimtar** duke përdorur standardet ndërkombëtare.

4.1.3 Çdo kërkesë për **OT** që ka të bëjë me publikimin e informatave, të dhënave ose rezultateve duhet të përfshijë publikimin e informatave relevante duke shfrytëzuar mediat e shtypura, internetin ose zonën publike të sistemit të **Barazimit Përfundimtar** sipas nevojës.

4.2 Komunikimi në raste të jashtëzakonshme

4.2.1 **Palët** dhe **OT** do të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që shkëmbimi i informatave të parapara sipas **Rregullave të Tregut**, gjithmonë të bëhet në mënyrën siç është specifikuar me protokollet e interfejsit.


4.2.2 Në rastet kur **OT** ose cilado **Palë** tjetër nuk është në gjendje të përdorë mjetet e përshkruara të komunikimit, secila palë duhet të bashkëpunojë që të sigurojë shkëmbimin e informatave brenda afateve të specifikuara sipas **Rregullave të Tregut**.

4.2.3 Dështimi i sigurimit të informatave në kohën e caktuar nuk do të konsiderohet **Forcë Madhore**, përveç në qoftë se pamundësia për sigurimin e informatave shkaktohet nga **Forca Madhore** që zgjatë gjatë tërë periodës në të cilën **Pala** kishte rastin për sigurimin e të dhënave.

4.3 Pajisjet Komunikuese

4.3.1 Çdo **Palë** duhet të jetë përgjegjëse për sigurimin dhe mirëmbajtjen (në shpenzime të **Palës**) e pajisjeve si: telefonit, faksit, dhe pajisjeve tjera komunikuese.

4.3.2 Çdo **Palë** duhet të sigurojë mirëmbajtjen (në shpenzime të **Palës**) e të gjitha pajisjeve kompjuterike për të mundësuar shkëmbimet e të dhënave përmes postës elektronike ndërmjet **OT** dhe **Palëve**. Aty ku vendosen pajisje të veçanta, ato do të përdoren nga ana e **Palës** vetëm për komunikime me softuerin e **Barazimit Përfundimtar**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 50 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

5 Kërkesat për Matjet

5.1 Agjenti për Administrimin e Matjeve

5.1.1 Me qëllim të procesimit të një numri të madh të të **Dhënave Matëse** që grumbullohen nga **Sistemet Matëse** të kyçura në **Sistemin e Transmetimit** ose **Sistemin e Shpërndarjes** para përdorimit të tyre në kalkulimet e **Barazimit Përfundimtar**, **OT** në emër të **OSSH** dhe **OST** do të themelojë zyrën, **Agjenti për Administrimin e Matjeve (AAM)**.

5.1.2 **AAM** do të jetë përgjegjës për detyrat vijuese:

- (a) themelimin e **Bazës së Matjeve** të referuar në nenin 5.2,
- (b) përpilimin e **Procedurave të Rregullave të Tregut** për Leximin, Aprovimin dhe Vlerësimin e Matjeve në emër të **OT**
- (c) përpilimin e një procedure për caktimin e energjisë totale të konsumuar në **Sistemin e Shpërndarjes** nëpërmjet **Sistemeve Matëse Interval** dhe **Sistemeve Matëse Jo-interval**;
- (d) përpilimin e një procedure për caktimin **Energjisë së Matur** për çdo **Njësi Balancuese** të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes** dhe të regjistruar te një **Furnizues**, që mund të përfshijë grumbullimin e të dhënave matëse për **Sistemet Matëse Interval** dhe **Sistemet Matëse Jo-Interval**;
- (e) përpilimin e një procedure për përcaktimin e **Të Dhënave të Matjeve të Korrigjuara** që rrjedhin nga leximet e mëvonshme të **Sistemeve Matëse Jo-interval**;
- (f) përpilimin e një orari sipas së cilit të dhënat e duhura transferohen tek **OT** me kohë, me qëllim që t'i mundësojnë **OT** ekzekutimin e **Barazimit Përfundimtar** në përputhje me **Orarin e Barazimit Përfundimtar**; dhe
- (g) publikimin dhe konsultimin për procedurat e zhvilluara, dorëzimin e tyre tek ZRRE për miratim dhe azhurnimin e tyre.


5.1.3 Në përputhje me orarin e përcaktuar në paragrafin 5.1.2(f), **AAM** i dorëzon te **OT** për **Barazim Përfundimtar** vlerat e **Energjisë së Matur** orë për orë dhe vlerat e korrigjuara për çdo **Njësi Balancuese**.

5.2 Baza e Matjeve

5.2.1 **AAM** është përgjegjës për mirëmbajtjen e bazës së informatave për **Sistemet Matëse** dhe **Njehsorët** e kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes** ose **Sistemin e Transmetimit**. Është përgjegjësi e çdo **Pale** që të ofrojë informata për kompletimin dhe azhurnimin e **Bazës së Matjeve**.

5.2.2 Për çdo **Sistem Matës** në **Bazën e Matjeve**, duhet të mirëmbahen informatat vijuese:

- (a) numri referent unik i **Sistemit Matës** që i caktohet nga ana e **AAM**;
- (b) identiteti i **Palës Tregtare (I Regjistruari)** e cila ka kontraktuar importin ose eksportin e energjisë nëpërmes atij **Sistemi Matës**;
- (c) nëse **Konsumatori fundor** i regjistruar në **Sistemin Matës** është **Konsumator në Nevojë** dhe detajetj për numrin e regjistrimit që OSSH i mban për te;
- (d) nëse **Konsumatori fundor** është i kualifikuar për **Shërbim Universal**;

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 51 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (e) identiteti i çdo **Njehsori** (kur ekziston) që kërkohet të regjistrojë rrjedhat e energjisë;
- (f) informatën nëse **Njehsori** regjistron rrjedhat e energjisë nga Burimi i Ripërtëritshëm i Energjisë që përkrahet me “Rregullën për Skemën Mbështetëse për të cilën është lëshuar Certifikata e Origjinës dhe Procedurat për Pranim në Skemën Mbështetëse”;
- (g) informatën nëse **Sistemi Matës** është **Sistem Matës Interval** apo **Sistem Matës Jo-interval**;
- (h) nëse ekziston **Marrëveshja për Alokimin e Matjeve** valide;
- (i) vlerën e llogaritur të **Sasisë Vjetore të Energjisë** për këtë **Sistem Matës**;

5.2.3 Për çdo **Njehsor** në **Bazën e Matjeve**, duhet të mirëmbahen informatat vijuese:

- (a) Numri referent unik i **Njehsorit** (NUNj), që i caktohet nga **Operatori i Rrjetit** relevant;
- (b) **Numri Referent i Sistemit Matës** tek i cili është caktuar **Njehsori**;
- (c) **Drejtimi i Rrjedhave**;
- (d) statusi i **Njehsorit** (**Njehsor me Lexim Interval** apo **Njehsor me Lexim Jo-interval**); dhe
- (e) informatat për karakteristikat fizike të **Njehsorit** dhe pajisjeve përcjellëse për transmetimin e informatave, si mund të kërkohet në **Kodin e Matjeve**.

5.2.4 Prodhuesit e energjisë së Ripërtëritshme të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes** dhe që nuk kanë nevojë për **Licencë**, mund të zgjedhin se a do të veprojnë si **Të Regjistruar** për **Njehsorët** e regjistruar në **Bazën e Matjeve** apo do të merren vesh me ndonjë **Furnizues të Licencuar** që ai të ketë këtë përgjegjësi.

5.3 Regjistrimi i Njehsorëve

5.3.1 Të gjitha **Pajisjet Matëse** të çdo **Sistemi Matës** që kërkohen për nevoja të **Rregullave të Tregut** duhet të regjistrohen në përputhje me kërkesat e **Kodit të Matjes** përkatës dhe aty ku është e nevojshme të regjistrohen edhe në bazën e themeluar nga **AAM**.

5.3.2 Nga **Palët** kërkohet që të regjistrojnë relacionet dhe konfigurimet ndërmjet leximeve të **Njehsorëve** ashtu që të mund të realizohen në mënyrë korrekte grumbullimet e duhura për të lehtësuar tregtimin dhe **Barazimin Përfundimtar** në përputhje me procedurat relevante.


5.3.3 Vetëm **Sistemet Matëse** të cilat janë regjistruar në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me paragrafin 5.3.1 do të përdoren si madhësi hyrëse në **Barazimin Përfundimtar**.

5.4 Pajisjet Matëse

5.4.1 Dizajni teknik dhe standardet operuese minimale për **Sistemet Matëse** që përdoren për **Barazimin Përfundimtar** janë përcaktuar në **Kodin e Matjeve** përkatës.

5.4.2 Kur kërkohet që **Sistemi Matës** të jetë **Sistem Matës Interval** atëherë **Pajisjet Matëse** në të gjithë **Njehsorët** në **Sistemin Matës** duhet të jenë në gjendje të regjistrojnë energjinë elektrike që ka rrjedhur nëpër këta **Njehsorë**, në çdo interval kohor, në mënyrë që të përcaktohet **Energjia e Matur** që ka rrjedhur nëpër atë **Sistem Matës** gjatë një **Periode të Barazimit Përfundimtar të Jobalancit**. Kjo informatë duhet t'i dorëzohet **OT** në orarin e definuar në **Rregullat e Tregut**.

5.4.3 **Operatorët e Rrjetit** janë përgjegjës për sigurimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e **Pajisjeve Matëse** dhe pajisjeve përcjellëse për ruajtjen dhe transmetimin e matjeve siç specifikohet në **Kodin e Matjes** përkatës dhe në përputhje me paragrafin 5.4.2.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 52 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

5.4.4 Nëse nga **Konsumatori fundor** kërkohet që **Sistemi Matës** të jetë **Sistem Matës Interval** atëherë me kërkesën e **Konsumatorit fundor**, **Operatori i Rrjetit** përkatës (**OST** ose **OSSH**, sipas rastit) menjëherë do të ndërmerr hapa për të siguruar instalimin e pajisjeve të nevojshme sa më shpejtë të jetë e mundur, por mungesa e një pajisjeje të tillë nuk do ta parandalojë **Konsumatorin fundor** të furnizohet nga një **Furnizues** që nuk është **Furnizuesi Publik**. Në qoftë se **Sistemi Matës** është në përputhshmëri me **Kodin e Matjes** relevant para kërkesës së **Konsumatorit fundor** për instalimin e **Sistemit Matës Interval** atëherë **Operatori i Rrjetit** relevant mund të shtyjë instalimin deri sa **Konsumatori fundor** të mos paguaj një kosto të arsyeshme për një instalim të tillë.

5.4.5 Asgjë nuk e përjashton instalimin e **Pajisjeve Matëse** me standard më të lartë se sa standardi që kërkohet me **Kodin e Matjes**.

5.4.6 **Palët Tregtare** duhet të lejojnë dhe lehtësojnë qasjen e **OST** ose **OSSH** në nënstacionet e tyre me qëllim që të lexojnë **Njehsorët** në përputhje me **Kodin e Matjes** ose **Kodin e Matjes të Shpërndarjes**.

5.4.7 Në përputhje me procedurat relevante, **Palët Tregtare** do të informojnë me kohë **OST** ose **OSSH** për detalet e konfigurimit të njehsorit duke përfshirë vendin e instalimit të **Njehsorit**, **Palën** përgjegjëse dhe procesin e qasjes në nënstacion.

5.4.8 Pesë (5) **Ditë Pune** pas rrjedhës fizike të energjisë elektrike **AAM** do t'i dërgojë çdo **Pale** gjendjen e **Energjisë së Matur** për **Sistemet Matëse Intervale** të regjistruara në **Llogaritë** e tyre.

5.5 Të Dhënat Matëse të Prodhuesit

5.5.1 Në çdo **Kufi Komercial** të çdo **Njësie Gjeneruese** me **Operatorin e Rrjetit** përkatës, që mund të jetë **OST** ose **OSSH**, kërkohet të instalohet një **Sistem Matës**, si definohet në **Kodin e Matjes** përkatës.

5.5.2 Për nevoja të **Barazimit Përfundimtar**, **Operatori i Rrjetit** përkatës duhet t'i dorëzojë **OT** në kohë të duhur **Të Dhënat Matëse** nga të gjitha **Sistemet Matëse** sipas paragrafit 5.5.1.


5.5.3 Në qoftë se të dhënat nuk janë konfirmuar dhe dorëzuar në kohën e paraparë sipas paragrafit 5.5.2, atëherë **Operatori i Rrjetit** përkatës duhet të dorëzojë **Të Dhënat Matëse** të përafuara që do të përdoren për **Barazimin Përfundimtar**. Në qoftë se **Të Dhënat Matëse** që kanë munguar janë konfirmuar më vonë, atëherë duhet të bëhen korrigjime në **Barazimin Përfundimtar** në përputhje me nenin 16.9.

5.6 Të Dhënat Matëse të Interkonektorit

5.6.1 Për çdo **Importues/Eksportues (Konsumator me Shumicë)** në çdo **Interkonektor** do të regjistrohet një **Njësi Balancuese**.

5.6.2 **OST**, për nevoja të **Barazimit Përfundimtar**, duhet t'i dorëzojë **OT** të gjitha **Nominimet Interkonektive** të konfirmuara për të gjitha **Njësitë Balancuese** (të cilat **OT** do t'i konsiderojë si **Të Dhëna Matëse**) sipas paragrafit 5.6.1.

5.6.3 Në qoftë se **Të Dhënat Matëse** nuk janë konfirmuar dhe dorëzuar në kohën e duhur, atëherë **OST** duhet të dorëzojë **Të Dhënat Matëse** të përafuara që do të përdoren për **Barazimin Përfundimtar**. Në qoftë se **Të Dhënat Matëse**, si kërkohet në paragrafin 5.6.2, që kanë munguar janë konfirmuar më vonë atëherë do të bëhen korrigjimet në **Barazimin Përfundimtar** në përputhje me nenin 16.9.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 53 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

5.7 Të Dhënat Matëse të Shpërndarjes

5.7.1 Në çdo **Kufi Komercial** ndërmjet **OST** dhe **OSSH** kërkohet një **Sistem Matës**.

5.7.2 **OST**, për nevoja të **Barazimit Përfundimtar**, duhet t'i dorëzojë **OT** të gjitha **Të Dhënat Matëse** të nevojshme nga të gjitha **Sistemet Matëse** të specifikuar në paragrafin 5.7.1.

5.7.3 Në qoftë se të dhënat nuk janë konfirmuar dhe dorëzuar në kohën e duhur si kërkohet në paragrafin 5.7.2, **OST** duhet të dorëzojë **Të Dhënat Matëse** të përafuara që do të përdoren për **Barazimin Përfundimtar**. Në qoftë se **Të Dhënat Matëse** që kanë munguar janë konfirmuar më vonë atëherë do të bëhen korrigjimet në **Barazimin Përfundimtar** në përputhje me nenin 16.9.

5.8 Të Dhënat Matëse të Konsumatorit fundor

5.8.1 Në çdo pikë kyçese të çdo **Konsumatori fundor** në **Rrjetin e Transmetimit** ose **Rrjetin e Shpërndarjes** duhet të jetë i instaluar një **Sistem Matës**.

5.8.2 Përveç në qoftë se lejohet në mënyrë decitive me **Rregullat e Tregut**, një **Sistem Matës** mund të përfshijë vetëm **Njehsorët** ku stabilimentet prodhuese të energjisë elektrike ose stabilimentet që furnizohen me energji elektrike janë:

- (a) në pronësi ose në shfrytëzim nga një person i vetëm juridik;
- (b) në afërsi gjeografike me njëra tjetrën;
- (c) të përfshira në të njëjtën hapësirë; dhe
- (d) që i shërbejnë njëra tjetrës në ndonjë mënyrë të nevojshme dhe të dobishme.

5.8.3 Me përjashtim të Sistemeve Matëse Jo-intervale që ende janë në procesin e regjistrimit në Bazën e Matjeve, Operatori i Rrjetit përkatës, për nevoja të Barazimit Përfundimtar, duhet t'i dorëzojë **AAM** në kohë të duhur **Të Dhënat Matëse** të nevojshme nga të gjitha **Sistemet Matëse** sipas paragrafit 5.8.1.

5.8.4 Operatori i Rrjetit të Shpërndarjes, për nevoja të **Barazimit Përfundimtar** duhet t'i dorëzojë **AAM** të gjitha të dhënat e nevojshme për energjinë që i atribuohen një **Sistemi Matës Jo-interval**.


5.8.5 Në qoftë se nuk janë konfirmuar dhe dorëzuar në kohën e duhur, në përputhje me paragrafin 5.8.3 **Operatori i Rrjetit** përkatës do të bëjë përafrimin e **Të Dhënave Matëse** të kërkuara dhe këto do të jenë meritore për **Barazimin Përfundimtar**. Në qoftë se **Të Dhënat Matëse** që kanë munguar janë konfirmuar më vonë atëherë do të bëhen korrigjimet në **Barazimin Përfundimtar** në përputhje me nenin 16.9.

5.9 Të dhënat Matëse të Sistemit të Ruajtjes

5.9.1 **Sistemet Matëse** kërkohen në çdo **Kufi Komercial** të çdo **Sistemi Ruajtjeje** me **Operatorin e Rrjetit** përkatës, ose siç përcaktohet në **Kodin Matës** përkatës; për shmangien e dyshimit, kjo vlen edhe për një **Njësi Ruajtjeje të OST**.


5.9.2 **Sistemet Matëse** të përmendura në paragrafin 5.9.1 do të jenë **Pika Matëse** të veçanta:

- (a) Një për Energjinë e Matur të injektuar në **Sistemin e Transmetimit** ose të **Sistemit të Shpërndarjes**; dhe
- (b) Një për Energjinë e Matur që merret nga **Sistemi i Transmetimit** ose **Sistemi i Shpërndarjes**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 54 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

5.9.3 Operatori përkatës i Rrjetit do të sigurojë që të dhënat e nevojshme matëse nga të gjitha **Sistemet Matëse** në paragrafin 5.9.2 të dorëzohen te **OT**-ja në kohën e duhur, për qëllime të **Barazimit Përfundimtar**.

5.9.4 Nëse të dhënat nuk konfirmohen dhe sigurohen në kohën e duhur, sipas paragrafit 5.9.3, Operatori përkatës i Rrjetit do të japë vlerësimin e tij më të përafërt për të dhënat e kërkuara Matëse që do të konsiderohen për **Barazim Përfundimtar**. Nëse dhe kur të dhënat matëse që mungojnë konfirmohen më pas, do të bëhen korrigjimet e **Barazimit Përfundimtar**, aty ku është e nevojshme, në përputhje me seksionin 16.9.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 55 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

6 Ndërrimi i Furnizuesit

6.1 Procesi i Transferimit të Konsumatorëve

6.1.1 Kurdo që **Furnizuesi (Furnizuesi Propozues)** kërkon të bëhet **I Regjistruar** për një **Sistem Matës** ekzistues, atëherë **Furnizuesi Propozues** duhet të:

- (a) njoftojë **AAM** për:
 - i. identitetin e **Sistemit Matës** të propozuar për transferim;
 - ii. propozimi i **Datës së Transferimit**, që nuk duhet të jetë më pak se njëzetë (20) Ditë Pune nga data e njoftimit; dhe
- (b) garantojë **OT** se posedon (ose do të posedojë në **Datën e Transferimit**) kontratën për furnizimin e një **Konsumatori fundor** si një **Furnizues** i vetëm ose si **Furnizues** në bashkë-furnizim me **Furnizues** tjerë në përputhje me **Marrëveshjen për Alokimin e Matjeve** të dorëzuar në përputhje me paragrafin 6.4.

6.1.2 Brenda dy (2) **Ditë Pune** pas pranimit të njoftimit të dorëzuar sipas paragrafit 6.1.1(a) **AAM** do të njoftojë **Furnizuesin Aktual** për datën e propozuar të transferimit përfshirë edhe identifikimin e **Furnizuesit Propozues** dhe do ti ofroj **Furnizuesit Propozues** detalet në lidhje me **Konsumatorin fundor** i regjistruar në **Bazën e Matjeve** duke përfshirë (por jo duke u kufizuar) statusin e **Konsumatorit fundor** në lidhje me **Konsumatorin në Nevojë** dhe **Shërbimin Universal**.

6.1.3 Në qoftë se **Furnizuesi Aktual** me të drejtë konsideron se, në **Datën e Transferimit** të propozuar, **Konsumatori fundor** edhe më tutje është i obliguar sipas kontratës me **Furnizuesin Aktual**, atëherë brenda pesë (5) **Ditë Pune** nga pranimi i njoftimit të referuar në paragrafin 6.1.2 mund të dorëzojë një njoftim për **Kundërshtim të Transferimit** tek **AAM** duke dhënë një të një nga arsyet për refuzim të specifikuar në këtë paragraf.


6.1.4 Në qoftë se **AAM** pranon një kundërshtim të vlefshëm për transferim të dorëzuar brenda afatit të caktuar kohor, **AAM** njofton **Furnizuesin Propozues** dhe **Rregullatorin** për **Kundërshtimin e Transferimit** brenda dy (2) **Ditë Pune** me:

- (a) arsyet e dhëna në **Kundërshtimin e Transferimit**; dhe
- (b) identitetin e **Furnizuesit Aktual**.

6.1.5 Në çdo kohë një **Furnizues Aktual** i cili ka dorëzuar një njoftim për **Kundërshtim të Transferimit** mund të njoftojë **AAM** se dëshiron ta tërheqë njoftimin për **Kundërshtim të Transferimit** të referuar në paragrafin 6.1.3 dhe pastaj **AAM** do ta njoftojë **Furnizuesin Propozues** që njoftimi për **Kundërshtim të Transferimit** nuk është më në fuqi.

6.1.6 Në datën kur **Baza e Matjeve** do të ndryshohet nga **AAM** për të reflektuar faktin që **Furnizuesi Propozues** ose do të jetë i vetmi **I Regjistruar** nga fillimi i asaj dite ose do të jetë **I Regjistruar** bashkërisht në përputhje me paragrafin 6.4 dhe do të dorëzojë njoftimet respektivisht **Operatorit të Tregut**, **Furnizuesit(ve) Ekzistues** dhe **Furnizuesit Propozues**:

6.1.7 Nga **Data e Transferimit të Konsumatorit**, **Operatori i Tregut** do të sigurohet që të **Dhënat Matëse** nga **Sistemi Matës** relevant janë përdorur në kalkulimet e **Barazimit Përfundimtar** në **Llogarinë e Furnizuesit Propozues** nga fillimi i ditës së referuar në atë njoftim dhe do të regjistrojë, sa më shpejt që është e mundur, të **Dhënat Matëse** për njehsorin e transferuar nga data e transferit, kur këto lexime kërkohen **Furnizuesi Propozues** për nevoja të zhvillimit të biznesit me **Konsumatorët fundor**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 56 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

6.1.8 Në qoftë se **ZRrE** konsideron (për shkak të ankesës nga **Furnizuesi Ekzistues** i mëparshëm ose për ndonjë arsye tjetër) që **Furnizuesi Ekzistues** i mëparshëm ka të drejtë të jetë **I Regjistruar** në një **Sistem Matës** specifik dhe lëshon një njoftim ku kërkon që transferimi të anulohet, atëherë **AAM** do të sigurohet që regjistrimi i kërkuar të bëhet në datën e caktuar nga **ZRrE** dhe do t'i njoftojë të gjitha **Palët** për atë se transferimi është kthyer në gjendjen e mëparme dhe se **Data e Transferimit** të propozuar do të jetë data e caktuar nga **ZRrE**. Për evitimin e dyshimeve, çdo kompensim për çfarëdo transferi të gabueshëm do të zgjidhet ndërmjet **Palëve** nën drejtimin e **Rregullatorit** dhe nuk do të jetë përgjegjësi e **OT** ose **AAM**

6.1.9 Të gjitha **Sistemet Matëse** të reja në objektet e **Konsumatorit fundor** duhet të instalohen nga ana e operatorit relevant të rrjetit ku është i kyçur **Konsumatori fundor** në përputhje me **Kodin e Matjes** përkatës.

6.2 Ndërrimi Grupor i Furnizuesit

6.2.1 Aty ku dakordohet ndërmjet **Furnizuesve** që një portfolio e **Konsumatorëve fundor** duhet të transferohet ndërmjet **Furnizuesve** atëherë transferimi i portfolios do të njoftohet **AAM** i cili do të njoftoj **OT** që **Sistemi Matës** në portfolio do të ketë **Furnizuesin** e ri të regjistruar si **I Regjistruari** për **Njehsor**.

6.2.2 Aty ku **Furnizuesi Ekzistues** nuk mundet më tutje të furnizoj **Konsumatorët fundor** të tij, pasi të njoftohet nga **Rregullatori**, atëherë portfolio i tij do të ri-regjistrohet në **Llogarinë** e regjistruar me **Furnizuesin** e **Mundësisë së Fundit** duke përfshirë datën në të cilën është realizuar transferimi dhe **AAM** do të njoftoj **Konsumatorët fundor** të ndikuar nga kjo ngjarje.

6.2.3 Pranohet fakti që nuk do të ketë matje fillestare specifike për **Konsumatorët fundor** gjatë transferimit në grup dhe që përafrimi i matjeve fillestare të nevojshme do të jetë përgjegjësi e **Furnizuesit** të ri.


6.3 Konsumatori pa Furnizues

6.3.1 Kur **AAM** konstaton se një **Konsumator fundor** nuk është i regjistruar me asnjë **Furnizues** atëherë **AAM** do të njoftoj **Furnizuesin e Mundësisë së Fundit** dhe menjëherë do ta regjistroj këtë **Konsumator fundor** në **Llogarinë** e **Furnizuesit të Mundësisë së Fundit** dhe do të shënoj datën e transferimit dhe do të kërkoj që leximi fillestar i njehsorit të bëhet nga **Sistemi Matës** i **Konsumatorit fundor** sa më shpejt që të jetë e mundur pas transferimit.

6.4 Rasti me më shumë Furnizues në një Njehsor

6.4.1 Në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike, **Konsumatori fundor** ka të drejtë të përmbyllë kontrata me më shumë se një **Furnizues**. Aty ku **Furnizuesi Propozues** propozon se do të jetë **Furnizuesi** i dytë (ose pasues) në **Sistemin Matës** të **Konsumatorit fundor** atëherë **Furnizuesi Propozues** duhet të dorëzoj **Marrëveshjen për Alokimin e Matjeve** të nënshkruar nga **Konsumatori fundor**.

6.4.2 Pas pranimit të **Marrëveshjes për Alokimin e Matjeve**, **AAM** do të dorëzoj **OT** një kopje të kësaj marrëveshje brenda [tri (3)] **Ditë Pune** nga dita e pranimit dhe **OT** do të tregoj **AAM** brenda [tri (3)] **Ditë Pune** se a mund të implementohet kjo **Marrëveshje për Alokimin e Matjeve** nga ana e **OT**, duke cekur arsyet për të cilat kjo marrëveshje nuk mund të implementohet.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 57 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

6.4.3 **AAM** do ta këshilloj **Furnizuesin Propozues** për vendimin e **OT** në lidhje me **Marrëveshjen për Alokimin e Matjeve** të propozuar dhe **Furnizuesi Propozues** mund të dorëzoj **OT** për vlerësim një **Marrëveshje për Alokimin e Matjeve** të korigjuar.


6.4.4 Asnjë **Marrëveshje për Alokimin e Matjeve** nuk do të implementohet nga **OT** deri në datën e cila është së paku [katërmbëdhjetë (14)] ditë pasi që **OT** i është dorëzuar një **Marrëveshje për Alokimin e Matjeve** valide.

6.4.5 Në rastet kur nuk është realizuar **Marrëveshja për Alokimin e Matjeve** valide alokimi i plotë i **Energjisë së Matur** do ti alokohet **Furnizuesit Ekzistues**. Aty ku **Marrëveshja për Alokimin e Matjeve** e propozuar mendohet të zëvendësoj **Marrëveshjen për Alokimin e Matjeve** ekzistuese **OT** do të vazhdoj të shfrytëzoj **Marrëveshjen për Alokimin e Matjeve** ekzistuese deri [katërmbëdhjetë (14)] ditë pasi që **OT** i është dorëzuar një **Marrëveshje për Alokimin e Matjeve** zëvendësuese valide.

6.5 Tërheqja e Furnizuesit nga Marrëveshja për Alokimin e Matjeve ekzistuese

6.5.1 Në çdo kohë, një **Furnizues** mund ta njoftoj **AAM** se dëshiron të tërhiqet nga **Marrëveshje për Alokimin e Matjeve** duke dhënë një njoftim së paku njëzet e një (21) ditë para. Nga data e njoftimit të **Furnizuesit** në tërheqje, ky **Furnizues** do të pushoj alokimin e **Energjisë së Matur** për të, **Furnizuesi** në tërheqje do të pushoj të jetë **Furnizues** i **Regjistruar** në **Sistemin Matës** dhe **Marrëveshja për Alokimin e Matjeve** do të pushoj së qeni valide.

6.5.2 Në rastet kur **Marrëveshja për Alokimin e Matjeve** valide nuk ekziston atëherë, derisa të realizohet një **Marrëveshje për Alokimin e Matjeve** e re, **OT** do të alokoj **Energjinë e Matur** në pjesë të barabarta tek **Furnizuesit** tjerë të regjistruar në atë **Sistem Matës**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 58 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

7 Alokimi dhe Tregtimi i Kapaciteteve Ndërkufitare

7.1 Dispozitat e Përgjithshme

7.1.1 **OST dhe OT** do të sigurojnë që ekzistojnë procedura për alokimin dhe nominimin për përdorimin e kapacitetit të ndërkufitar në Interkonektorët për të cilët **OST**-ja ka përgjegjësi. **OST**-ja është bërë aksionar në **SEE CAO** dhe në këtë mënyrë angazhohet të përdorë **SEE CAO** për të përmbushur detyrimet e tij në lidhje me ankandin, alokimin dhe transferimin e të drejtave të transmetimit fizik. **OST** nuk regjistron tregtimin e kapaciteteve ndërkufitare, por pranon njoftimet për të drejtat e kapaciteteve të Palëve të dorëzuara nga **SEE CAO** në të gjithë kufijtë e shërbyer nga **SEE CAO**, por mban një regjistër të të drejtave të kapaciteteve në çdo kufi që nuk shërbehet nga **SEE CAO**. Kur një kufi nuk shërbehet nga **SEE CAO**, **OST** do të zhvillojë dhe aplikojë procedurat përkatëse.

7.1.2 **OST** do të zbatojë procedura për të siguruar që **Kapacitetet e Disponueshme të Transmetimit (KTD)** në Interkonektorët përkatës mund të përcaktohen për secilën periudhë të alokimit dhe këto **Kapacitete Transmetuese të Disponueshme (KTD)** në Interkonektorët përkatës do t'i njoftohen **SEE CAO** dhe gjithashtu **Bursës së Energjisë Elektrike (PX)**.

7.2 Regjistrimi i Kapaciteteve Ndërkufitare

7.2.1 Çdo **Palë Tregtare** që vepron me **Funksionin Pjesëmarrës** si **Tregtar Ndërkufitar** dhe **Palët jo Tregtare** dhe të cilët dëshirojnë të fitojnë, tregtojnë ose shfrytëzojnë të drejtat për kapacitetet në **Interkonektorë**, duhet të aplikojnë për regjistrim në **SEE CAO** me përjashtim të kufijve që nuk shërbehen nga **SEE CAO**, për të cilat **Palët Tregtare** duhet të regjistrohen në **Regjistrin e Kapaciteteve Ndërkufitare** që mbahet nga **OT**. Për sqarim, vetëm **Tregtarët Ndërkufitar** mund të regjistrohen në **Regjistrin e Kapaciteteve Ndërkufitare**.

7.3 Ankandet e Kapaciteteve Ndërkufitare


7.3.1 Ankandet e Kapaciteteve Ndërkufitare do të kryhen nga **SEE CAO** në pajtueshmëri me rregullat e saj dhe **SEE CAO** do të njoftojë **OST**) me rezultatet e alokimit të **Të Drejtave të Transmetimit Fizik**. Në kufijtë që nuk shërbehen nga **SEE CAO**, marrëveshjet e **OST**-së me **OST**-në në anën tjetër të atij kufiri në lidhje me alokimin dhe tregtimin e të **Drejtave të Transmetimit Fizik** dhe nëse këto marrëveshje përfshijnë **ankandin**, **OST** do të përpiqet të sigurojë që procedurat janë të ngjashme me ato të aplikuara nga **SEE CAO**.

7.4 Tregtimi i Të Drejtave të Transmetimit Fizik


7.4.1 Të gjitha aktivitetet e tregimit dhe të transferimit të **Të Drejtave të Transmetimit Fizik** do të kryhen nga **SEE CAO** në pajtueshmëri me rregullat e saj dhe **SEE CAO** do të njoftojë **OST** me rezultatet e alokimit të **Të Drejtave të Transmetimit Fizik**.

7.5 Veprimet e Pjesëmarrësit në Ankand

7.5.1 Nëse **OST** informohet nga **SEE CAO** që ndonjë **Tregtar Ndërkufitar** ka kryer veprime apo është sjellë në atë mënyrë që kërcënon se do të ndikojë negativisht në konkurrencën dhe Procesin e Ankandit, ose kërcënon se do të prishë Procesin e Ankandit ose Transparencën, kosto-efektivitetin ose lojalitetin, atëherë **OST** do të informojë **ZRRë** për aktivitete të tilla dhe do të

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 59 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

zbatojë çdo instruksion të **ZRrE** që ka të bëjë me pjesëmarrjen në të ardhmen të **Tregtarit Ndërkufitar** në ankandin e **Të Drejtave të Transmetimit Fizik**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 60 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

8 Garancioni Financiar

8.1 Procedura për Garancionin Financiar

8.1.1 Para se një **Palë Tregtare** të mund të dorëzojë **Nominimet Kontraktuale, Nominimet Fizike, Ofertat për Blerje dhe/ose Ofertat për Shitje**, sipas **Rregullave të Tregut**, duhet të dëshmojë që ka **Garancion Financiar** adekuat në favor të **OT**.

8.1.2 **OT** do të publikojë dhe do të azhurnojë një procedurë që mbulon çështjet për **Garancionin Financiar**, e cila do të detalizojë procedurat për:


- (a) kalkulimin e nivelit të **Garancionit Financiar** që një **Palë Tregtare** duhet ta ketë;
- (b) dëshminë që **Garancioni Financiar** është në favor të **OT**;
- (c) monitorimin e mjaftueshmërisë së **Garancionit Financiar**;
- (d) kërkesat për rritjen ose zvogëlimin e nivelit të **Garancionit Financiar** të **Palës Tregtare**; dhe
- (e) kufizimin e aktiviteteve të **Palës Tregtare** kur **Garancioni Financiar** nuk është adekuat.

8.1.3 **OT** do të mbajë një regjistër të **Garancioneve Financiare** që kërkohet për çdo **Palë Tregtare**. Asgjë nuk e kufizon **Palën Tregtare** që vlera e **Garancionit Financiar** të jetë më e madhe se vlera minimale e kërkuar.

8.2 Kalkulimi i nivelit të Garancionit Financiar

8.2.1 **Procedura e Rregullave të Tregut** për **Garancionin Financiar** do të parashtrojë metodologjinë për kalkulimin e nivelit minimal të **Garancionit Financiar** të cilin duhet ta ketë çdo **Palë Tregtare**; Metodologjia do të aplikojë principet vijuese:

- (a) Vlera minimale e **Garancionit Financiar** që **Furnizuesi** duhet ta ketë, do të merr parasysh:
 - i. pritjet e arsyeshme të nivelit të Çmimit të Jobalancit në të ardhmen;
 - ii. SVE totale e **Sistemeve Matëse** të regjistruara te **Furnizuesi**; dhe
 - iii. një pasqyrë historike për të gjithë **Furnizuesit** që nuk kanë kontraktuar sasi të mjaftuar;
- (b) niveli minimal i **Garancionit Financiar** që një Gjenerues (i cili, për qëllimet e këtij Seksioni 8, do të përfshijë pronarët e **Njësisë Gjeneruese të BRE** në masën që **OT**, sipas një vlerësimi të vetë të arsyeshëm, konsideron se një garancion i tillë financiar është i nevojshëm nga pronarët në fjalë të **Njësisë Gjeneruese të BRE** dhe **Njësisë Balancuese të Sistemit të Ruajtjes**) duhet të mbajë dhe do të marrë parasysh:
 - i. pritjet e arsyeshme për nivelin e **Çmimit të Jobalancit** në të ardhmen; dhe
 - ii. një pasqyrë historike të ndalesave të paplanifikuara para **Kohës së Mbylljes së Tregut** për **Njësitë Gjeneruese** të regjistruara tek ai;
- (c) vlera minimale e **Garancionit Financiar** që një **Konsumator me Shumicë** duhet ta ketë, duhet të merr parasysh:
 - i. pritjet e arsyeshme për nivelin e **Çmimit të Jobalancit** në të ardhmen; dhe
 - ii. pasqyrën historike të blerjes së energjisë nga ana e **Konsumatorit me Shumicë**;

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 61 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (d) vlera minimale e **Garancionit Financiar** që një **Tregtar Ndërkufitar** duhet ta ketë, do të jetë zero pa marrë parasysh ndonjë **Garancion Financiar** tjetër që mund të kërkohej nga ana e **OST** në lidhje me blerjen e **Të Drejtave të Transmetimit Fizik**.

8.2.2 **OT** do të njoftojë çdo **Palë Tregtare** për vlerën e kërkuar minimale për **Garancionin Financiar** dhe kjo vlerë minimale do të aplikohet deri sa të rikalkulohet nga ana e **OT** ose derisa **OT** të njoftohet nga **ZRrE** se do të aplikohet vlera minimale më e vogël e **Garancionit Financiar**, për shkak të një kërkesë të parashtruar nga **Pala Tregtare**.

8.3 Deponimi i Garancionit Financiar

8.3.1 **Procedura e Rregullave të Tregut** për **Garancionin Financiar** do të përcaktojë format standarde që do të përdoren si garancion i pakthyesëm dhe të specifikojë llojet e instrumenteve adekuate të **Garancionit Financiar**, që mund të jenë:

- (a) para të gatshme; dhe
- (b) garancionet e parevokueshme bankare.

8.3.2 **Të gjitha** instrumentet financiare do të regjistrohen në regjistrin e **Garancionit Financiar** të mbajtur nga **OT** duke përfshirë edhe informata të tilla si: data e skadimit.

8.4 Monitorimi i Garancionit Financiar

8.4.1 Jo më pak se një herë në muaj, **OT** do të shqyrtojë:

- (a) **Garancionin Financiar** të deponuar nga çdo **Palë Tregtare**; dhe
- (b) Vlerën minimale të **Garancionit Financiar** të kërkuar nga çdo **Palë Tregtare** krahasuar me vlerën e detyrimeve për të cilat **PPB** i **Palës Tregtare** është faturuar dhe që **PPB** ia kishte atribuar kësaj **Pale Tregtare** në ekzekutimin e fundit të **Barazimit Përfundimtar** (dhe paraparak).


8.4.2 Kurdo që niveli i **Garancionit Financiar** konsiderohet joadekuat, **OT** do ta njoftojë menjëherë **Palën Tregtare** e cila do të ketë në dispozicion tri (3) **Ditë Pune** për të korrigjuar situatën.

8.4.3 Në qoftë se **OT** beson se vlera e **Garancionit Financiar** të **Palës Tregtare** nuk është adekuate, **OT** do ta njoftojë **Palën Tregtare** se e ka bërë rikalkulimin e vlerës minimale të **Garancionit Financiar**.

8.4.4 Kur një **Palë Tregtare** me arsye beson se vlera minimale e **Garancionit Financiar** e llogaritur nga ana e **OT** është shumë e lartë, atëherë ajo mund të kërkojë rikalkulimin e vlerës minimale të **Garancionit Financiar** dhe në qoftë se **Garancioni Financiar** është i mbivlerësuar, **OT** do të mundësojë zvogëlimin ose korrigjimin e këtyre instrumenteve financiare për vlerën e tejkualuar.

8.5 Pasojat e Garancionit Financiar joadekuat

8.5.1 Në qoftë se pas një periode prej tre (3) **Ditë Pune** nga njoftimi nga ana e **OT** se **Pala Tregtare** disponon **Garancion Financiar** joadekuat, atëherë **OT** do t'i dorëzojë **Palës Tregtare** një njoftim se ajo ka bërë shkelje materiale të **Rregullave të Tregut** sipas paragrafit 3.5.1(b)iii.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 62 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

PJESA II: OPERIMI I SISTEMIT

9 Parashikimi një Ditë Para (D-1)

9.1 Parashikimi i Konsumit Nacional


9.1.1 Në (D-1) deri në orën 09:00 (ose i reviduar pastaj sipas **Orarit të Tregtimit**) **OST** do informojë **OT** mbi parashikimin e konsumit total të sistemit orë për orë për ditën që vjen, në përputhje me **Orarin e Tregtimit**, përfshirë së paku:

- (a) Parashikimin e konsumit për çdo orë (në MW) si shumë e të gjitha pikave dalëse nga **Sistemi Transmetues** përfshirë edhe injektimin e parashikuar të **Prodhuesve** të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes**; dhe
- (b) margjinën e kërkuar të sistemit (në MW) për **Rezervën për Restaurimin e Frekuencës** dhe për **Rezervën Zëvendësuese**.

9.1.2 Kur është e nevojshme, **OST** do të azhurnojë parashikimin e tij në ditën D dhe do ta informojë **OT** për vlerat e reja dhe pastaj **OT** do të publikojë vlerat e azhurnuara.

9.2 Publikimi

9.2.1 Informatat e siguruar sipas këtij seksioni, sa më shpejt që të jetë e mundur [09:30] të (D-1) (ose informatat që janë azhurnuar më vonë sipas **Orarit të Tregtimit**), do të publikohen nga **OS** posa të jenë të disponueshme, dhe më së voni deri në orën 12:30 të (D-1).

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 63 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

10 Nominimet Ndërkufitare

10.1 Kapaciteti Transmetues në Disponim

10.1.1 Kapacitetet **Ndërkufitare** të dhëna në **Ankandet e Kapaciteteve Ndërkufitare** garantojnë në kushtet normale të operimit të sistemit.

10.1.2 **OST** ka të drejtën që të kufizojë ose anulojë të drejtën për shfrytëzimin e kapacitetit **Ndërkufitare** vetëm në rastet e çrregullimeve në sistem dhe për nevoja të sigurisë së sistemit të deklaruar nga **OST**. Në këto rrethana, **OST** do të informojë **OT**, i cili do t'i njoftojë **Tregtarët Ndërkufitar** se të drejtat e tyre për shfrytëzimin e kapacitetit **Ndërkufitar** mund të reduktohen, duke cekur arsyet dhe kohëzgjatjen e reduktimit.

10.1.3 Fituesit e **Të Drejtave të Transmetimit Fizik** nuk kanë të drejtë për kompensimin e vënë në dispozicion nga **SEE CAO** në përputhje me rregullat e saj nëse e drejta e tyre për të përdorur kapacitetin është mohuar ose kufizuar për arsyet e përcaktuara në paragrafin 10.1.2.

10.1.4 **OST** do të njoftojë **OT** për kthimin në kushte normale të operimit të sistemit dhe **OT** do të publikojë këtë informatë të rëndësishme për të gjithë **Tregtarët Ndërkufitarë**.

10.2 Nominimet Ndërkufitare

10.2.1 Detajet e **Nominimeve Ndërkufitare** dhe rrethanat në të cilat mund të aplikohen rregulla të ndryshme përcaktohen në Procedurën e Rregullave të Tregut për Nominimet.

10.2.2 **OT** do të publikojë në faqen e tij të internetit, afatet për dorëzimin e Nominimeve Ndërkufitare për çdo Ditë dhe për çdo kufi.


10.2.3 **Palët Tregtare** do t'i dorëzojnë **OT**-së Nominimet Ndërkufitare, i cili do të validojë të gjitha nominimet e tilla Ndërkufitare kundrejt informacionit të vënë në dispozicion nga **SEE CAO** ose informacioneve të tjera të disponueshme kur Nominimi Ndërkufitar lidhet me një kufi që nuk shërbehet nga **SEE CAO**. **OT** do të njoftojë **Palën Tregtare** përkatëse për rezultatin e procedurës së tij të validimit dhe, kur nominimi i tillë Ndërkufitar refuzohet, **OT** do të jap një arsye për refuzimin. Refuzimi nuk pengon ridorëzimin e një Nominimi të ndryshuar, me kusht që të dorëzohet përpara afatit të fundit për Nominime. **OT** do t'i ofroj **OST**-së Nominimet Ndërkufitare (importit dhe eksportit) për çdo orë të ditës **D** për çdo Interkonektor brenda tridhjetë minutave nga afati i fundit i përmendur në paragrafin 10.2.1.

10.2.4 Nominimi Ndërkufitar që kalon validimin në përputhje me paragrafin 10.2.3 do të bëhet një Nominim i pranuar Ndërkufitar.

10.2.5 Në përputhje me procedurën përkatëse për Interkonektorët duke përfshirë ndonjë që nuk shërbehet nga **SEE CAO**, **Tregtarët Ndërkufitar** do të njoftohen se:

- (a) **Nominimet Ndërkufitare** përputhen me kapacitetin e disponueshëm në Interkoneksion, ose;
- (b) ka tepriçë të kapaciteteve Ndërkufitare (në MW) për një drejtim dhe kufi specifik, për cilëndo **Periodë** specifike të **Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**; ose
- (c) ka mungesë të **Kapaciteteve Ndërkufitare** (në MW) për një drejtim dhe kufi specifik, për cilëndo **Periodë** specifike të **Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**.

10.2.6 Aty ku **OST** duhet të shkurtojë çdo Nominim Ndërkufitar, ai do të zbatojë parimet e minimizimit të shkurtimit/kufizimit dhe alokimit të drejtë të shkurtimeve ndërmjet Tregtarëve

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 64 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Ndërkufitar në kufirin e prekur në përputhje me standardet përkatëse të BE-së dhe **ENTSO-E** siç detajohen në Procedurën e Rregullave të Tregut për nominimet.

- (a) Pasi të finalizohen nominimet ndërkufitare (të rishikuara nëse është e nevojshme), ato do të publikohen nga **OT** deri në orën 16:00 në D-1 (ose edhe më vonë nëse ato korrighohen). **OT** do t'i dërgojë **OST**-së nominimet ndërkufitare të grumbulluara për çdo drejtim për secilin Interkoneksion përkatës.

10.3 Dispozita Shfrytëzo ose Shit të Drejtën për Transmetimin Fizik

10.3.1 Pranohet se, pas **Nominimeve fillestare (nominimeve afatëgjatë) Ndërkufitare**, çdo e **Drejtë e Transmetimit Fizik** ndaj së cilës nuk është marrë asnjë **Nominim Ndërkufitare**, tërësisht ose pjesërisht, do të vihet në dispozicion si më poshtë:


- (a) kur një kufi i nënshtrohet **Bashkimit të Tregut**, atëherë **SEE CAO** do t'i alokojë të gjitha këto të drejta të transmetimit fizik për qëllimin e bashkimit të tregut në fjalë dhe kompensimi për ato të drejta do t'u bëhet nga **SEE CAO** mbajtësve të atyre të drejtave të transmetimit fizik në përputhje me rregullat e saj;
- (b) kur një kufi nuk i nënshtrohet **Bashkimit të Tregut**, por **SEE CAO** ka nxjerrë në ankand të drejta të tilla, atëherë **SEE CAO** do të iniciojë një ankand ditor të të **Drejtave afatshkurtëra të Transmetimit Fizik** në përputhje me rregullat e saj;
- (c) kur një kufi nuk shërbehet nga **SEE CAO**, atëherë **OST-ja** rezervon të drejtën për t'i ofruar këto të drejta të transmetimit fizik të gjitha **Palëve Tregtare** të cilat do të paguajnë një çmim të rënë dakord nga **ZRRE** për këto të drejta ose përndryshe të drejtat e tilla të transmetimit fizik mund të shiten në një ankand të organizuar bashkërisht nga **OST** dhe **OST-ja** përkatëse përtej kufirit.

10.3.2 Në secilin rast të përmendur në paragrafin 10.3.1, **OT-ja** do të informojë **SEE CAO** (ose **OST**-në fqinje përkatëse) për **nominimet përkatëse ndërkufitare**, përpara **Koha e Mbylljes së Tregut për Tregjet** e energjisë së Kosovës.

10.4 Bashkimi i Tregut

10.4.1 Kur nuk ka **bashkim tregu** në një kufi që nuk shërbehet nga **SEE CAO**, **OT** do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të bashkëpunuar me **OST**-në përkatëse kufitare në mënyrë që të pranojë **Nominimet Kontraktuale** të bëra nga një **Palë Tregtare** kundrejt të **Drejtave të Transmetimit Fizik** të njoftuara të mbajtura nga ajo **Palë Tregtare** që janë dorëzuar përpara **Koha e Mbylljes së Tregut**, por nuk do të pranojë asnjë përgjegjësi për mospranimin e një **nominimi të tillë kontraktual** ose, nëse një nominim i tillë kontraktual pranohet, por rrjedha rezultuese e energjisë nuk ndodh, atëherë nuk pranohet asnjë përgjegjësi për çdo **jobalancë** rezultuese. Pranohet se **nominimet kontraktuale** të dorëzuara deri në orën 14:00 në D-1, në rrethana normale, do të kenë shumë gjasa të procesohen me sukses.


10.4.2 Kur nuk ka **bashkim tregu** në një kufi të shërbyer nga **SEE CAO**, në të cilin **SEE CAO** ka zhvilluar një ankand ditor, pranohet se **SEE CAO** do të njoftojë **OST**-në për të gjitha të drejtat të transmetimit fizik të alokuara si rezultat i ankandit ditor dhe **OT** do të pranojë **Nominimet Kontraktuale** të bëra kundrejt këtij kapaciteti të bëra nga të gjitha **Palët Tregtare**, që veprojnë në **Funksionin e Pjesëmarrjes të Tregtarëve Ndërkufitar** (nëse licencohen si të tillë), në përputhje me **Procedurën e Operatorit të Tregut** për nominimet.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 65 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

10.4.3 Aty ku ekziston **bashkimi i tregut**, pranohet se **OT** do të njoftojë **SEE CAO** për mbajtësit përkatës të **DTF-ve** dhe të **nominimeve kontraktuale** për transmetimin e energjisë përmes të drejtave përkatëse të Interkonektorit (ve) prej tyre dhe do të njoftojë **PX** (të) për shumën neto në çdo drejtim të **DTF-ve** të alokuara atyre për të cilat nuk ka ose ka **nominim kontraktual** të pjesëshëm.

10.4.4 Pranohet se, në rrethana të caktuara, një **bashkim i planifikuar i tregut** në përputhje me paragrafin 10.4.3 mund të mos ndodhë dhe se **OST-ja** do të pranojë **nominime të tilla ndërkufitare** siç mund t'i janë njoftohen atij nga **SEE CAO** duke zbatuar marrëveshjet e tij të ankandit rezervë/alternativ.

10.4.5 Në të gjitha rastet e transmetimit të energjisë përmes **Interkonektorëve**, **OST-ja** do të jetë përgjegjës për informimin e **OT-së** për të gjitha alokimet rezultuese të të **Drejtave të Transmetimit Fizik** që i njoftohen atij nga **SEE CAO** sa më shpejt të jetë e mundur pasi një informacion i tillë të bëhet i disponueshëm për OST-në dhe **Palët Tregtare** kanë të drejtë të konsiderojnë se çdo kohë e identifikuar në rregullat e **SEE CAO** ose (sipas rastit) **Orarin e Tregut** do të jetë koha në të cilën informacioni bëhet i disponueshëm për **OT-në**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 66 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

11 Nominimet Fizike, Nominimet Kontraktuale, Ofertat për Shitje dhe Ofertat për Blerje

11.1 Dorëzimi i Nominimeve Fizike

11.1.1 Nominimet Fizike do t'i dorëzohen **OT** dhe **OST** nga çdo **Palë Tregtare** që ka të regjistruar **Sistemin Matës** relevant në **Llogarinë e Injektivit** dhe **Llogarinë Dalëse** për çdo **Njësi Balancuese**, në përputhje me **Procedurën e Rregullave të Tregut** për **Nominimet** të publikuara nga ana e **OT**.

11.1.2 Njësi Balancuese do të jenë:


- (a) **Njësitë Gjeneruese;**
- (b) **Njësitë Gjeneruese BRE** me kapacitet të instaluar jo më të vogël se dhjetë (10) MW;
- (c) **Sistemet Matëse të Konsumatorëve fundor** të kyçur në **Sistemin e Transmetimit;**
- (d) **Konsumatorët fundor** individualë, ose një grup i **Konsumatorëve fundor** të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes** që me **Furnizuesin** e tyre kanë kontraktuar pjesëmarrjen në **Tregun Balancues;**
- (e) **Tregtarët Ndërkufitarë** të regjistruar në një **Interkonektor** përmes mbajtjes së **Të Drejtave të Transmetimit Fizik;**
- (f) **Sistemet Matëse** të mbetura të **Konsumatorëve fundor**, për çdo **Furnizues**, që nuk përfshihen në paragrafin (d); dhe
- (g) **Sistemi i Ruajtjes**, i cili mund të operojë në modin e injektivit (gjenerues) ose modin e marrjes (mbushjes).

11.1.3 Çdo Palë Tregtare do të dorëzojë **Nominimin Fizik** (XN_{bj}) si vlerë mesatare në MW për orë për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** për ditën D deri në orën 14:00 të ditës D-1 (ose si përcaktohet ndryshe në **Orarin e Tregtimit**), për çdo **Njësi Balancuese "b"** (përveç për **Njësitë Balancuese të Tregtarëve Ndërkufitarë**) të regjistruar tek ajo **Palë Tregtare**. Për shmangien e dyshimit, **Njësitë Gjeneruese të Skemës Mbështetëse të BRE-ve** do të dorëzojnë gjithashtu **nominime fizike** (dhe çdo rishikim të mëvonshëm) të **OER-ja**, i cili menjëherë do t'ia kalojë këtë informacion **OT-së**.

11.1.4 OST do të dorëzojë **Nominimet Interkonektive** të konfirmuara (XN_{bj}), si vlerë mesatare në MW për orë të përcaktuara në përputhje me paragrafin 10.3 për çdo **Njësi Balancuese të Tregtarëve Ndërkufitarë "b"** si **Nominime Fizike** për **Njësinë Balancuese "b"** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalancit "j"** të ditës D deri në orën 14:00 të D-1 ose si specifikohet në **Orarin e Tregtimit**.

11.1.5 Për eliminimin e dyshimeve, një **Nominim Fizik** i bërë në emër të një **Njësie Gjeneruese**, një **Njësie Balancuese të Sistemit të Ruajtjes Injektuese**, ose **Njësie Balancuese të një Tregtari Ndërkufitar** që është duke importuar energji do të regjistrohet si MW pozitiv ndërsa një **Nominim Fizik** i bërë në emër të një **Njësie Balancuese të Furnizimit**, **Njësie Balancuese Ruajtëse** zbrazëse ose një **Njësie Balancuese të një Tregtari Ndërkufitar** që është duke eksportuar energji do të regjistrohet si MW negativ.

11.1.6 Nominimi Fizik dorëzohet nga **Pala Tregtare** nëpërmes formës dhe pajisjeve komunikuese të përcaktuara nga **OST**, si vlerë në MW, për një **Periodë të caktuar të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** dhe do të interpretohet si injektiv ose dalje mesatare në kufirin e **Sistemit të Transmetimit** gjatë **Periodës së caktuar të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 67 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

11.1.7 **OST** do të verifikojë çdo **Nominim Fizik** sipas **Parametrave Dinamik të Dispeçimit** dhe nëse e sheh të arsyeshme do të njoftojë **Palën Tregtare** se **Nominimi Fizik** për **Njësinë Balancuese** relevante nuk është në përputhje me këta parametra dhe do të udhëzojë **OT** që ta refuzojë këtë **Nominim Fizik** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** në të cilën ky **Nominim Fizik** nuk është në përputhje me **Parametrat Dinamik të Dispeçimit** dhe **OT** do të ftojë **Palën Tregtare** që të bëjë ri-dorëzimin e tij.

11.1.8 **Nominimi Fizik** mbetet valid për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** derisa të zëvendësohet me një **Nominim Fizik** valid të dorëzuar më vonë.

11.1.9 Nga **Palët Tregtare** kërkohet që të ndihmojnë **OST** në kryerjen e obligimeve ndaj **ENTSO-E** për minimizimin e **Shkëmbimit të Paqëllimshëm**. **Palët Tregtare** janë përgjegjëse të sigurojnë që injektimi dhe konsumi momental të jetë sa më afër vlerës që është nominuar tek **OT** nga ana e tyre.

11.2 Dorëzimi i Nominimeve Kontraktuale

11.2.1 **Palët Tregtare** i dorëzojnë **OT Nominimet Kontraktuale** në përputhje me **Procedurën e Rregullave të Tregut për Nominimet Kontraktuale**.

11.2.2 **Nominimet Kontraktuale** do të kërkohen nga **OST** në lidhje me **Llogarinë Tregtare të OST-së** për blerjen e humbjeve sipas një **Kontrate të Humbjeve të Transmetimit** dhe nga **OSSH** në lidhje me **Llogarinë Tregtare të OSSH** për blerjen e energjisë për mbulimin **Humbjeve në Shpërndarje**. Pranohet se humbjet e tilla mund të blihen në përputhje me tregtimin e bërë nga **OST**, ose **OSSH** në një **TOEE**.

11.2.3 **Palët Tregtare** duhet t'i dorëzojnë të gjitha **Nominimet Kontraktuale** për ditën D deri në **Kohën e Mbylljes së Tregut** të ditës paraprake, (D-1).


11.2.4 **Nominimet Kontraktuale** duhet të dorëzohen nga çdo **Palë Tregtare** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** siç specifikohet në **Orarin e Tregimit**.

11.2.5 Në çdo kohë pas Mbylljes së Tregut në D-1, **Nominimet Kontraktuale** në D mund të dorëzohen nga një **Palë Tregtare** (duke përfshirë **Njësitë Gjeneruese BRE të Rregulluara** ose **Njësitë Gjeneruese BRE në Skemën Mbështetëse**, por duke përjashtuar **Njësitë Gjeneruese BRE të Skemës Mbështetëse të Trashëguar**) në përputhje me Procedurën e Rregullave të Tregut për **Nominimet Kontraktuale** dhe **Orarin e Tregimit**, për tregun D.

11.2.6 Çdo **Nominim Kontraktual** për ditën D duhet të specifikojë:

- (a) identitetin e **Llogarisë "A"** të **Palës Tregtare** që nominon;
- (b) identitetin e **Llogarisë së Injektivit**, **Llogarisë Dalëse** ose **Llogarisë së OST** të palës tjetër kontraktuale në nominim;
- (c) Energjinë në MWh ($E_{K_{Aj}}$) për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar "j"**; dhe
- (d) nëse importon ose eksporton energji **Pala Tregtare** ose **OST** (sipas rastit) në çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**.

11.2.7 Një **nominim kontraktual** nuk do të validohet nga **OT** derisa pala tjetër e identifikuar nga paragrafi 11.2.6.(b) e kontratës të ketë dorëzuar një nominim kontraktual të harmonizuar, ku në atë moment **OT** do të njoftojë secilën palë që **nominimi kontraktual** është i harmonizuar me përjashtim që një **nominim kontraktual** i dorëzuar nga **PX** në emër të një **Pale Tregtare** ose **OST** ose **OSSH** (blerja për të mbuluar humbjet) do të konsiderohet i harmonizuar kundrejt një

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 68 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

nominimi kontraktual të regjistruar në **Llogarinë Balancuese të PX**, i cili do të validohet automatikisht.

11.3 Nominimet e Harmonizuara

11.3.1 Pas dorëzimit të **Nominimeve Fizike, Nominimeve Kontraktuale** dhe **Kohës së Mbylljes së Tregut një ditët para (D-1)**, **OT** do të bëjë një kontroll verifikues dhe çdo **Palë Tregtare** do t'i dorëzojë një raport ku identifikon **Nominimet Fizike** dhe **Nominimet Kontraktuale** që janë pranuar dhe **Nominimet Fizike** dhe **Nominimet Kontraktuale** që janë miratuar.

11.3.2 **OT** nuk do të bëjë miratimin e **Nominimeve Fizike** dhe **Nominimeve Kontraktuale** për një **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** në qoftë se:

- (a) **Nominimi Fizik** nuk është konsistent me **Parametrat Dinamik të Dispeçimit të Njesisë Balancuese** (përveç **Njesisë Balancuese** të një **Tregtari Ndërkufitar**);
- (b) **Nominimet Kontraktuale** të palëve kontraktuale nuk përputhen.

11.3.3 **OT** do të informoj **Palën Tregtare** në qoftë se **Nominimet Kontraktuale** të dorëzuara nuk mund të harmonizohen nga pala homologe dhe do të kërkoj nga **Palët Tregtare** që bënë korrigjimin e nominimeve para **Kohës së Mbylljes së Tregut** në D-1 dhe do ta përsëris të njëjtën gjë para **Kohës së Mbylljes së Tregut** në D, për **Nominimet Fizike** të reja dhe **Nominimet Kontraktuale** të reja të dorëzuara.

11.3.4 Në qoftë se në **Kohën e Mbylljes së Tregut** në D-1 ose **Kohën e Mbylljes së Tregut** harmonizimi nuk është arritur, **OT** do të aplikoj rregullën vijuese me qëllim të harmonizimit të nominimit.


- (a) Në rastin kur vlerat për cilëndo **Periodë të Barazimit Përfundimtarë të Jobalanceve** dallojnë, do të aplikohet vlera më ulët;
- (b) Në rastin kur vlerat për cilëndo **Periodë të Barazimit Përfundimtarë të Jobalanceve** kanë parashenja të ndryshme, do të aplikohen vlerat zero.

11.3.5 **Palët Tregtare** mund të dorëzojnë pa kufizim **Nominimet Fizike** dhe **Nominimet Kontraktuale** deri në **Kohën e Mbylljes së Tregut** në D-1 dhe pastaj ata mund të dorëzojnë **Nominimet Fizike** të reja dhe **Nominimet Kontraktuale** të reja pa kufizim deri në **Kohën e Mbylljes së Tregut** në D.

11.3.6 Nëse, gjatë procesit për konfirmimin e **Nominimeve Interkonektive** në përputhje me rregullat e **ENTSO-E, OST** dakordohet me **PPB** për ndryshimet në **Nominimet Interkonektive** të dorëzuara, atëherë **OST** do të bëjë ndryshimet në **Nominimet Kontraktuale** dhe në **Nominimet Fizike** për **Njesisë Balancuese** specifike dhe këto ndryshime do të pranohen nga ana e **OT** si nominime valide përkundër skadimit të **Kohës së Mbylljes së Tregut** në D-1.

11.3.7 **Palët Tregtare** mund të dorëzojnë **Nominimet Fizike** dhe **Nominimet Kontraktuale** për një **jo-Ditë Pune** në **Ditën e Punës** para **jo-Ditës së Punës**.

11.3.8 **OT** do të monitorojë **PPB** duke krahasuar realizimin me **Nominimet Fizike**, dhe në rast të mos-përputhjeve të vazhdueshme, në diskrecionin e vet do ndërmarrë veprimet që i konsideron të nevojshme duke përfshirë (por jo edhe duke u kufizuar vetëm në):

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 69 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (a) publikimin e detaleve të jo-korrektësisë; dhe
- (b) referimin e çështjes të ZRrE për zgjidhjen e saj.

11.4 Nominimet brenda ditore (D)

11.4.1 Në çdo kohë pas **Kohës të Mbylljes së Tregut** një ditë para (D-1) dhe deri në **Kohën e Mbylljes së Tregut** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** të aplikueshme, një **Palë Tregtare** (duke përfshirë edhe **Sistemin e Ruajtjes, Njësitë Gjeneruese BRE të Rregulluara** ose **Njësitë Gjeneruese BRE** nga Skema Mbështetëse) mund t'i dorëzojnë **OT, Nominimet Fizike dhe Nominimet Kontraktuale** të reja.

11.4.2 Në **Kohën e Mbylljes së Tregut**, **OT** do të realizoj verifikimin e njëjtë të validimit të referuar në paragrafin 11.3.1 dhe do të aplikohen kushtet e paragrafit 11.3.2. për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtarë të Jobalanceve**.

11.5 Tregu Një Ditë Para (D-1)

11.5.1 Pranohet se, në përputhje me Procedurën e Rregullave të Tregut për Nominimet, **PX** do të dorëzojë nominime kontraktuale në emër të saj dhe **Palëve Tregtare** (dhe, kur kërkohet, **OST** dhe **OSSH** në lidhje me Humbjet në Transmetim dhe/ose Humbjet e Shpërndarjes) duke shfrytëzuar tregun e caktuar dhe se nominimet kontraktuale do të mbahen të vlefshme pavarësisht nëse ato janë përputhur kundrejt nominimeve fizike.

11.5.2 Kur një **Nominim Kontraktual** i dorëzuar në emër të një **Palë Tregtare** nuk është harmonizuar me **Nominimin Fizik** të dorëzuar nga kjo **Palë Tregtare** deri në **Kohën e Mbylljes së Tregut** në D-1 ose (si mund të jetë rasti) në **Kohën e Mbylljes së Tregut**, atëherë **OT** do ta njoftoj **OST** dhe **Rregullatorin** për këtë për ndodhinë nëse në mënyrë të arsyeshme beson se arsyeja e dështimit është një përpjekje e qëllimshme për të manipuluar tregun.


11.5.3 **PX** do të njoftojë **OT** sa më shpejt që të jetë e mundur për Çmimin e tregut nga Bursa e Energjisë që është përcaktuar nga tregu një dite para dhe **OT** do të kalkulojë çdo korrigjim të nevojshëm të Çmimit të tregut nga Bursa e Energjisë (që rezulton nga operimi i më shumë se një **PX** në Kosovë) dhe do ta publikojë këtë çmim në faqen e saj të internetit si çmim përcaktues për barazimin përfundimtar të çdo kontrate në treg që varet nga çmimi i një dite para (përfshirë, për shmangien e dyshimit, Kontratat për Diferencë të Burimeve të Ripërtëritshme).

11.6 Dorëzimi i Ofertave për Blerje dhe Ofertave për Shitje

11.6.1 **Ofertat për Blerje** dhe **Ofertat për Shitje** përmbajnë çmimet e **Ofertave për Blerje** (ζOB_{bj}) dhe çmimet e **Ofertave për Shitje** (ζOS_{bj}) respektivisht dhe i dorëzohen **OT** dhe **OST**, për çdo Ditë dhe për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**, nga **Palët Tregtare** që kanë të regjistruar **Llogari të Injektimit** ose **Llogari Dalëse** për çdo **Njësi Balancuese "b"** të aftë për pranimin e pavarur të urdhëresave pa ndikuar në pozicionin e **Barazimit Përfundimtar të Palëve Tregtare** tjera.

11.6.2 Kur **Tregtarët Ndërkufitarë** i dorëzojnë **Ofertat për Shitje** ose **Ofertat për Blerje** në **Tregun Balancues** në përputhje me marrëveshjet ndërmjet dy **OST** relevante, këto do të pranohen vetëm në qoftë se dëshmojnë se zotërojnë **Të Drejtat e Transmetimit Fizik** të nevojshme, si përshkruhet në nenin 7, për transferimin e **Ofertave për Shitje** ose **Ofertave për Blerje**.

11.6.3 **Prodhuesit dhe Njësitë Balancuese të Sistemit të Ruajtjes** dorëzojnë **Ofertat për Blerje** të energjisë nga **OST** me çmim të **Ofertave për Blerje** dhe zvogëlojnë prodhimin e tyre (ose, në

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 70 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

rastin e një **Njësie Balancuese të Sistemit të Ruajtjes** për të rritur potencialisht marrjen). **Furnizuesit** i dorëzojnë **OST Ofertat për Blerje** të energjisë dhe të rrisin konsumin e tyre. **Tregtarët Ndërkufitarë** i dorëzojnë **OST Ofertat për Blerje** të energjisë me çmim të **Ofertave për Blerje** për të zvogëluar importet e tyre ose për të rritur eksportet e tyre. Një **Aktivizim i Ofertës për Blerje** nga ana e **OST** do të nënkuptojë zvogëlimin e prodhimit nga ana e **Prodhuesit** (ose rritjen e konsumit nga ana e **Furnizuesit**) për mesataren e specifikuar të MW nën nivelin e **Nominimit Fizik**.

11.6.4 **Prodhuesit** dhe **Njësitë Balancuese të Sistemit** të dorëzojnë **Ofertat për Shitje** të energjisë **OST** me çmim të **Ofertës për Shitje** për të rritur prodhimin e tyre (ose, në rastin e një **Njësie Balancuese të Sistemit të Ruajtjes** për të reduktuar potencialisht marrjen). **Furnizuesit** dorëzojnë **Ofertat për Shitje** të energjisë **OST** me çmim të **Ofertave për Shitje** për të zvogëluar konsumin e energjisë. **Tregtarët Ndërkufitarë** dorëzojnë **Ofertat për Shitje** të energjisë **OST** për të rritur importet e tyre ose për të zvogëluar eksportet e tyre. Një **Aktivizim i Ofertës për Shitje** nga ana e **OST** nënkupton rritjen e prodhimit nga ana e **Prodhuesit** (ose zvogëlimin e konsumit nga ana e **Furnizuesit**) për mesataren e specifikuar të MW mbi nivelin e **Nominimit Fizik**.

11.6.5 Një **Palë Tregtare** mund të dorëzojë vetëm nga një çmim për **Ofertë për Blerje** apo **Ofertë për Shitje** për një **Njësi Balancuese** specifike për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**, që është çmimi për të cilin **Njësia Balancuese** do të zvogëlojë ose rrisë prodhimin (dhe rrisë ose zvogëlojë konsumin e tij në rastin e **Furnizuesit**), varësisht nga pozita e **Nominimit Fizik** të saj.

11.6.6 Të gjitha çmimet e **Ofertave për Blerje** dhe **Ofertave për Shitje** duhet të dorëzohen deri në **Kohën e Mbylljes së Tregut** në D-1 të ditës para ditës për të cilën aplikohen çmimet e **Ofertave për Blerje** dhe **Ofertave për Shitje** dhe nuk mund të ndryshohen më vonë.

11.6.7 Për një **Njësi Balancuese** të tipit të definuar në paragrafin 11.1.2(f), çmimi i **Ofertës për Shitje** do të regjistrohet në **Barazimin Përfundimtar** si **Çmimi i Kompensimit për Shkyçje të Ngarkesës**. **Çmimi i Kompensimit për Shkyçje të Ngarkesës** do të propozohet nga **Paneli Shqyrtues** dhe do të aprovohet nga **ZRrE** para përdorimit në kalkulimet e **Barazimit Përfundimtar**. **Paneli Shqyrtues** duhet të merr parasysh:

- (a) kushtet ekonomike në Kosovë;
- (b) kushtet ekzistuese në tregun regional të energjisë elektrike; dhe
- (c) stimulimet e nevojshme për minimizimin e reduktimeve të konsumit të Kosovës.


11.6.8 **Palët e Posaçme** janë të obliguara që të dorëzojnë **Oferta për Blerje** dhe **Oferta për Shitje** për të gjitha **Njësitë Balancuese** që kanë mundësi të rregullimit të pavarur.

11.6.9 **Palët Tregtare** duhet ta dinë se **OT** e rezervon të drejtën për monitorimin e nivelit të çmimeve të ofruara në **Tregun Balancues** dhe kur beson me arsye se çmimet janë jo të drejta do t'a informojë **ZRrE**. **OT** mund të mirëmbajë një model për llogaritjen e çmimeve të **Ofertave për Shitje** dhe **Ofertave për Blerje** që mund të priten nga **Palët** në Tregun konkurrues.

11.7 Parashikimi mujor i Furnizuesit

11.7.1 Deri në ditën e [njëzet e pestë (25)] të çdo muaji kalendarik ($m-1$), çdo **Furnizues** duhet të dorëzojë një **Parashikim Mujor** (QF_{Am}) tek **OT** për marrjen e pritshme të konsumatorëve për një muaj para.

11.7.2 **OT** do të bëjë rishikimin e dorëzuar nga çdo **Furnizues** dhe do të bëjë përshtatjet e parashikimeve të **Furnizuesve** ose do ti ndërroj me parashikimet e veta në rastet kur **Furnizuesi**

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 71 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

dështon të dorëzoj **Parashikimin Mujor** deri në datën e caktuar dhe kur beson me arsye se **Parashikimi Mujor** relevant është jo i saktë, dhe e informon **Furnizuesin** për vendimin e tij dhe arsyet për marrjen e këtij vendimi.

11.7.3 **OT** do të bëjë mbledhjen e **Parashikimeve Mujore** të të gjithë **Furnizuesve** dhe do të kalkuloj **Përpjesën e BRE për Furnizuesin** ($PPFB_{Am}$) për **Furnizuesin "A"** për muajin "*m*" duke pjesëtuar **Parashikimin Mujor të Furnizuesit "A"** me shumën e **Parashikimeve Mujore**.

11.8 Prodhimi nga BRE

11.8.1 Çdo **Njësi Gjeneruese BRE "b"** do t'i dorëzojë **OT** një **Nominim Kontraktual** (QC_{bj}) dhe një **Nominim Fizik** përputhës (XN_{bj}) për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalancit "j"** të një dite para tek **OER**-ja në përputhje me Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë të bërë ndërmjet **Njësisë Gjeneruese të BRE** dhe **OER**-së, të cilat **OER** do t'i regjistrojë në llogarinë e tij të **Fondit Mbështetës për Burimet e Ripërtëritshme** të Energjisë. Nëse një **Njësi Gjeneruese e BRE** dështon të dorëzojë nominimet fizike ose nominime kontraktuale, atëherë **OER** mund të zhvillojë rregulla për zëvendësimin e nominimeve të supozuara kur beson se kjo do të reduktojë përgjegjësinë e tij për jobalancë.

11.8.2 Derisa **OER** të jetë në gjendje të shesë energjinë e prokuruar përmes nominimeve kontraktuale të bëra në përputhje me paragrafin 11.8.1 në një **PX** ose, sipas rastit, sipas një kontrate dypalëshe, **OER** do të nxjerrë shumën totale të energjisë së nominuar dhe do të deklarojë nominimet e duhura fizike për llogarinë e **Fondit Mbështetës për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë** dhe do të dorëzojë nominimet kontraktuale (QCA_j) për çdo llogari të Furnizuesit "*A*" ku sasia e energjisë për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** do të llogaritet duke përdorur formulën:

$$EK_{A_j} = \left(\sum_b EK_{b_j} \right) * PPFB_{Am}$$

Ku:


EK_{b_j} është **Nominimi Kontraktual** për **Njësinë Gjeneruese BRE "b"** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** i kalkuluar në përputhje me paragrafin 11.8.1; dhe

$PPFB_{Am}$ është **Përpjesa e BRE për Furnizuesin** për **Furnizuesin "A"** për muajin "*m*" e kalkuluar në përputhje me paragrafin 11.7.3.


11.8.3 **OT** do ta njoftoj menjëherë çdo **Furnizues** për **Nominimet Kontraktuale** të bëra në emër të saj në përputhje me paragrafin 11.8.1.

11.8.4 Nëse **OER** është në gjendje të shesë energjinë e prokuruar përmes nominimeve kontraktuale të bëra në përputhje me paragrafin 11.8.1, atëherë paragrafi 11.8.2 dhe paragrafi 11.8.3 do të pushojnë së zbatuari dhe **OER** do të shesë energjinë e prokuruar në emër të **Fondit Mbështetës për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë** si **Palë Tregtare** nëpërmjet një **PX** ose në çdo mënyrë tjetër në përputhje me detyrimin e tij për të shitur këtë energji përmes kontratave.

11.8.5 **Njësitë Gjeneruese të BRE**, deri në Kohën e Mbylljes së Tregut të **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalancit** mund të paraqesin nominime kontraktuale dhe nominime fizike të rishikuara dhe **OER** do të përsërisë procedurat e specifikuara në paragrafët 11.8.1 deri në 11.8.4,

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 72 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

por, kur **OER** nuk mund të bëjë nominime kontraktuale ekuivalente në mënyrë të arsyeshme për të balancuar pozicionin e vet për shkak të marrjes së nominimit kontraktual që është marrë nga **Njësia Gjeneruese e BRE** më pak se një (1) orë përpara kohës së mbylljes së tregut (nominimet e BRE të trashëguara do të paraqesin nominimet e tyre të rishikuara deri në 3 orë para aplikimit të cilësdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**), atëherë **OER** mund ta trajtojë jobalancin e tij rezultues ashtu që ai t'i atribuohet **Njesisë Gjeneruese të BRE** nominuese, por do të përdorë përpjekje të arsyeshme për të balancuar pozicionin e tij.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 73 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

12 Tregu Balancues

12.1 Parametrat Dinamik të Dispeçimit

12.1.1 **Parametrat Dinamik të Dispeçimit** duhet t'i jepen **OST** për çdo **Njësi Balancuese** nga **Pala Tregtare** në **Llogarinë e Injektimit** ose **Llogarinë Dalëse** të së cilës është e regjistruar.

12.1.2 **Parametrat Dinamik të Dispeçimit** do t'i komunikohen **OST** në përputhje me dispozitat e **Kodit të Rrjetit** duke përdorur pajisjet e komunikimit të ofruara, ose siç udhëzohet ndryshe nga **OST**.

12.1.3 **OST** do të sigurojë që çdo **Aktivizim i Ofertës për Blerje** ose **Aktivizim i Ofertës për Shitje** është i realizueshëm për **Njësinë Balancuese** në kushtet e **Parametrave Dinamik të Dispeçimit** të saj.

12.1.4 **Palët Tregtare** do të sigurojnë që **Parametrat Dinamik të Dispeçimit** të pasqyrojnë në mënyrë të arsyeshme operimin e cilësdo **Njësie Balancuese** dhe që **Parametrat Dinamik të Dispeçimit** të mund të ndryshohen në çdo kohë.

12.2 Urdhëresat në Tregun Balancues

12.2.1 Sipas nevojës, por në përputhje me objektivat e operimit ekonomik dhe efikas të **Sistemit të Transmetimit, OST** do t'i japë urdhëresa operatorëve të **Njësie Balancuese "b"** për **Aktivizimin e Ofertave për Blerje** dhe **Aktivizimin e Ofertave për Shitje**, për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** që **Njësitë Balancuese** të ndryshojnë nivelin e dhënies/marrjes (së energjisë) në **Pozitën e Urdhëruar (XPU_{bj})** të re.

12.2.2 Një urdhëresë për **Aktivizimin e Ofertës për Blerje** ose një urdhëresë për **Aktivizimin e Ofertës për Shitje "n"** për **Njësinë Balancuese "b"** do të specifikojë:


- (a) **Nivelin e Urdhëruar (XNU_{bn})** të shprehur në MW;
- (b) **Kohën e Startimit për Nivelin e Urdhëruar ($TSXNU_{bn}$)**, që do të specifikojë minutën "m" në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** nga e cila do të fillojë **Niveli i Urdhëruar**, dhe
- (c) **Kohëzgjatjen e Nivelit të Urdhëruar ($TPXNU_{bn}$)** në minuta.

12.2.3 Çdo **Aktivizim i Ofertave për Blerje** ose **Aktivizim i Ofertave për Shitje** do të zëvendësohet me **Aktivizimin e Ofertave për Blerje** ose **Aktivizimin e Ofertave për Shitje** të bëra më vonë nga ana e **OST** e cila mbulon të njëjtën periudë kohore.

12.2.4 Kur bëhet **Aktivizimi i Ofertave për Blerje** ose **Aktivizimi i Ofertave për Shitje** për ndonjë **Njësi Balancuese "b"**, në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**, **OST** do të sigurohet që **Aktivizimi i Ofertave për Blerje** ose **Aktivizimi i Ofertave për Shitje** në çdo kohë të plotësojë kushtet e **Parametrave Dinamik të Dispeçimit** të dorëzuar për atë **Njësi Balancuese**.

12.2.5 Kur një **Kontratë e Shërbimeve Ndhmëse** është në implementim për një **Njësi Balancuese** atëherë **OST** do të:

- (a) trajtojë nivelin maksimal të prodhimit të **Njësis Gjeneruese** si nivel maksimal të prodhimit të specifikuar në **Parametrat Dinamik të Dispeçimit** minus **Margjinën e Kapacitetit Rezervë** (në MW);

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 74 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (b) trajtojë nivelin minimal të prodhimit stabil të **Njësia Gjeneruese** si nivelin minimal të gjenerimit stabil të specifikuar në **Parametrat Dinamik të Dispeçimit plus Margjina Negative e Kapacitetit Rezervë** (në MW);
- (c) trajtojë nivelin minimal të konsumit të **Njësia Balancuese** të **Furnizuesit** (të tipit të referuar në paragrafët 11.1.2(c) dhe 11.1.2(d)) si nivelin minimal të konsumit të specifikuar në **Parametrat Dinamik të Dispeçimit minus Margjina e Kapacitetit Rezervë** (në MW); dhe
- (d) trajtojë nivelin maksimal të konsumit të **Njësia Balancuese** të **Furnizuesit** (të tipit të referuar në paragrafët 11.1.2(c) dhe 11.1.2(d)) si nivelin maksimal të konsumit të specifikuar në **Parametrat Dinamik të Dispeçimit plus Margjina Negative e Kapacitetit Rezervë** (në MW).

12.2.6 Në qoftë se operatori i **Njësia Balancuese** është i vetëdijshëm se **Njësia Gjeneruese** e ndikuar nuk mund ta arrijë nivelin e urdhëruar, nëse është në përputhje me **Parametrat Dinamik të Dispeçimit** ose jo, do ta njoftojë menjëherë **OST** dhe nëse nuk urdhërohet ndryshe nga **OST** do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të arritur nivelin e urdhëresës sa më afër që është e mundur në ato kushte.

12.2.7 **OST** mund të bëjë një urdhëresë për **Aktivizimin e Ofertës për Blerje** ose një urdhëresë për **Aktivizimin e Ofertës për Shitje** çdo ditë dhe në çdo kohë pas **Kohës së Mbylljes së Tregut** në D-1 për ditën D dhe deri në mbarimin e ditës D në shqyrtim.

12.3 Rezultatet e Aktivizimit të Ofertave për Blerje dhe Ofertave për Shitje

12.3.1 Një **Aktivizim i Ofertës për Blerje** ose një **Aktivizim i Ofertës për Shitje** formon kontratë bilaterale për liferim të energjisë (EOB_{bj} ose $EOSH_{bj}$ sipas rastit) ndërmjet **Llogarisë Balancuese të OST** dhe **Palës Tregtare** në **Llogarinë e Injektimit** ose **Llogarinë Dalëse** në të cilën është regjistruar **Njësia Balancuese "b"** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**.


12.3.2 Rezultat i **Aktivizimit të Ofertës për Blerje** është pagesa në **Llogarinë Balancuese të OST** nga **Pala Tregtare** me çmim të **Ofertës për Blerje** e diferencës së energjisë së llogaritur nga niveli mesatar i **Pozitës së Urdhëruar** në çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** me energjinë e llogaritur nga niveli i specifikuar në **Nominimin Fizik** kur niveli i urdhëruar është më i ulët se niveli i specifikuar në **Nominimin Fizik**.

12.3.3 Rezultat i **Aktivizimit të Ofertës për Shitje** është pagesa nga **Llogaria Balancuese e OST** tek **Pala Tregtare** me çmim të **Ofertës për Shitje** e diferencës së energjisë së llogaritur nga niveli mesatar i **Pozitës së Urdhëruar** në çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** me energjinë e llogaritur nga niveli i specifikuar në **Nominimin Fizik** kur niveli i urdhëruar është më i lartë se niveli i specifikuar në **Nominimin Fizik**.

12.3.4 Rezultatet që dalin nga paragrafët 12.3.2 dhe 12.3.3 aplikohen njësoj edhe për **Njësia Balancuese** të regjistruar në **Llogarinë Dalëse**, duke referuar se rrjedhat e konsumit të energjisë do të kenë parashnjë negative.

12.4 Aktivizimi i Shënjuar

12.4.1 Kur **OST** bënë një urdhëresë për **Aktivizimin e Ofertës për Blerje** ose një urdhëresë për **Aktivizimin e Ofertës për Shitje** për korigjimin e jobalanceve të shkaktuara nga sforcimet në sistem ose sforcimet në **Interkoneksion**, që paraqiten pas pranimit të konfirmimit të **Nominimeve Interkonektive** atëherë ofertat e **Aktivizuara** do të shënjohen dhe ofertat e tilla do të jenë **Oferta**

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 75 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

të Shënjuara për Blerje dhe Oferta të Shënjuara për Shitje dhe OST do të njoftojë OT për këto Aktivizime ashtu që energjia dhe çmimet e liferimeve sipas këtyre Aktivizimeve nuk do të përdoren në kalkulimin e Çmimit të Jobalancit.

12.4.2 Një urdhëresë për Aktivizim të Ofertës për Blerje do të jetë Ofertë e Shënjuar për Blerje dhe një urdhëresë për Aktivizim të Ofertës për Shitje do të jetë Ofertë e Shënjuar për Shitje sipas vlerësimit të OST që vepron si operator i arsyeshëm dhe i matur në përputhje me kushtet e Licencës së tij.

12.5 Aktivizimet e Imponueshme

12.5.1 Në rrethana të caktuara kur OST është i detyruar të urdhërojë reduktimin e energjisë (sipas vlerësimit të arsyeshëm të OST) (EO_{bj}) Konsumatorëve fundor të kyçur në Sistemin e Transmetimit ose Sistemin e Shpërndarjes si pasojë e ngarkesës së pa-furnizuar në Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancit "j" të Njesisë Balancuese "b", atëherë OST do të bëjë një Aktivizim të Imponueshëm (Aktivizimin e Ofertës për Shitje në Tregun Balancues) për çdo Palë Tregtare të ndikuar.

12.5.2 Rrethanat që do të ndikojnë në aplikimin e paragrafit 12.5.1 janë si në vijim:

- (a) një sforcim që ndikon në aftësinë e Sistemit të Transmetimit për të liferuar energjinë e kërkuar që nuk mund të eliminohet me Aktivizimin e Ofertës për Shitje për të zbutur sforcimin; ose
- (b) kur çmimi i Ofertave në dispozicion për t'u Aktivizuar në Tregun Balancues e tejkalon çmimin e specifikuar në paragrafin 12.5.3 ose OST nuk ka në dispozicion Oferta për Shitje në Tregun Balancues.

12.5.3 Çmimi i Ofertës për Shitje që aplikohet për Aktivizim të Imponueshëm të Ofertës për Shitje do të jetë Çmimi i Kompensimit për Shkycje të Ngarkesës të referuar në paragrafin 11.6.7.

12.5.4 Në qoftë se aplikohen kushtet e përshkruara në paragrafin 12.4.1, atëherë, një Aktivizim i Imponueshëm mund të jetë një Aktivizim i Shënjuar me çmim të Aktivizimit të Imponueshëm.


12.6 Orari i Tregtimit

12.6.1 Në përputhje me Oraret e Tregtimit të ENTSO-E, OT do të publikojë një Orar të Tregtimit për aktivitetet në Treg.

12.6.2 Kur është e nevojshme OT do të revidojë kohë pas kohe Orarin e Tregtimit dhe jo më pak se një herë në vit pas një periode të konsultimeve të nevojshme me industrinë.

12.6.3 Procesi i operimit të Tregut që do të aplikohet për ditën D, është si vijon:

- (a) Parashikimin në D-1 e konsumit për çdo Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve të ditës D, duke specifikuar vlerën e agreguar të konsumit në MW (të definuar si ngarkesë që dëshirohet të furnizohet, e cila nuk parashikon reduktimet e ngarkesës) dhe margjinën e kërkuar të Rezervës si vlerë mesatare në MW për çdo Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve;
- (b) Kapacitetin Transmetues në Dispozicion në çdo Interkonektor për import dhe eksport
- (c) Nominimet Fizike për çdo Njësi Gjeneruese dhe çdo Furnizues (duke përfshirë Furnizuesin Publik) dorëzimin e Nominimeve Fizike për konsumin e çdo Njesisë

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 76 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Balancuese të Furnizuesit për çdo Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve tek OST dhe OT.

- (d) **Palët Tregtare** i dorëzojnë **OT Nominimet Kontraktuale** të agregura.
- (e) Validimi i **Nominimeve Fizike** dhe **Nominimeve Kontraktuale**
- (f) **Mbyllja e Tregut** për Nominime
- (g) Agregimi i **Ofertave për Blerje** dhe **Ofertave për Shitje** të Tregut Balancues.

13 Prokurimet e OST-së dhe shfrytëzimi për Shërbimet Ndhmëse dhe Humbjet; Shkëmbimet e Paqëllimshme

13.1 Vlerësimi i shërbimeve ndihmëse të Kërkesave për Rezerva

13.1.1 Çdo vit deri me 30 Nëntor, në përputhje me **Kodin e Rrjetit, OST** do të llogarisë nivelin e marginës së rezervës të kërkuar për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** (mund të përcaktohet edhe sipas tarifave), që do të varej nga vlerat e parashikuara të konsumit, disponueshmërisë dhe fleksibilitetit të parashikuar të gjenerimit në përputhje me procedurën operative të publikuar nga **OST**. Për nevoja të **Tregut**, margjina e rezervës mund t'i referohet kapacitetit shtesë të gjenerimit që **OST** do të dëshironte ta kishte në disponim për të mbuluar **Periodat e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** kur konsumi është më i madh si dhe **Periodat e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** kur konsumi mund të jetë më i vogël se gjenerimi minimal që duhet të mbahet nga **Prodhuesit** në fjalë.


13.1.2 **OST** gjithashtu do të llogarisë koeficientet e shfrytëzimit për **Rezervën** e kontraktuar, **Koeficientin e Shfrytëzimit të Rezervës Pozitive** dhe **Koeficientin e Shfrytëzimit të Rezervës Negative** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** nga Paragrafi 13.1.1. **Koeficientet e Shfrytëzimit të Rezervës** (KShR_i dhe KShRN_i) do të përcaktohen si herës i probabilitetit të shfrytëzimit të **Rezervës** së kontraktuar në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** me probabilitetin mesatar që kjo **Rezervë** e kontraktuar të shfrytëzohet në çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të jobalanceve** gjatë vitit.

13.2 Prokurimi i Kontratave të Shërbimeve Ndhmëse

13.2.1 **OST** do të publikojë format standarde të **Kontratave të Shërbimeve Ndhmëse** për prokurime periodike të Shërbimeve Ndhmëse nga **PPB** dhe do të ndër marrë aso veprimesh prokurorese që mund t'i gjykojë të matura për të siguruar kontrata të mjaftueshme të shërbimit ndihmës ekzistojnë dhe janë të disponueshme për t'u përdorur për çdo lloj shërbimi ndihmës para çdo **Periode të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**, duke përfshirë kontratat që mund të lidhen deri në më shumë se një vit përpara **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**. Për të shmangur dyshimet, **OST** mund të iniciojë një ose më shumë ankande për të prokuruar rezervat e kërkuara në të cilat mund të marrin pjesë pjesëmarrësit jashtë Kosovës. **OST** mund të prokurojë gjithashtu shërbime të caktuara ndihmëse për produkte standarde siç specifikohet në Rregulloren e Bashkimit Evropian për Balancimin e Energjisë në tregjet afatshkurtra.

13.2.2 Do të publikohen forma të standardizuara të **Kontratave të Shërbimeve Ndhmëse** për prokurimin e:

- (a) **Rezervën për Restaurimin automatike të Frekuencës (aFRR);**
- (b) **Rezervën për Restaurimin Manual të Frekuencës (mFRR);** dhe
- (c) **Rezervës Zëvendësuese (RR).**

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 77 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

13.2.3 Çdo **Palë e Posaçme** është e obliguar të negociojë **Kontratat e Shërbimeve Ndhmëse** nëse ato kërkohen nga **OST** ose mund të jetë e detyruar të ofertojnë në nivele konkurruese në çdo ankand për kontratat e shërbimit ndihmës. Për shmangien e dyshimit, kjo vlen për **Sistemin e Ruajtjes**, duke përfshirë Njësitë e Ruajtjes të **OST**, përveç se, në rastin e njërive të ruajtjes të **OST-së**, çmimi i kontratës së shërbimit ndihmës duhet të jetë në përputhje me **Kodi i Punës i Njërive të Ruajtjes të OST-së**.

13.2.4 **OST** mund (por nuk është i detyruar) të prokurojë ndonjë rezervë nga **Palët Tregtare** duke shfrytëzuar Kontratën e tij standarde të Shërbimit Ndhmës. **OST** mund të vendosë çmime në kontrata të tilla të bëra pas prokurimit nëpërmjet një ankandi transparent që respekton çmimet e ofruara në atë ankand.

13.2.5 **Kontrata e Shërbimeve Ndhmëse "ShN"** për prokurimin e **Rezervës** përveç tjerash do të përfshijë edhe kushtet që specifikojnë:

- (a) **Njësinë Balancuese "b"** për të cilën aplikohet kontrata;
- (b) **Margjinën e Kapacitetit Rezervë (XMR_b)** në MW;
- (c) **Margjinën Negative të Kapacitetit Rezervë ($XMRN_b$)** në MW;
- (d) **Çmimin e Rezervës për Shërbimin Ndhmës (CR_{ShN})** në €/MW/orë) për kapacitetin e rezervuar sipas kontratës;
- (e) **Çmimin e Rezervës Negative për Shërbimin Ndhmës (CRN_{ShN})** në €/MW/orë për kapacitetin e rezervuar sipas kontratës; dhe
- (f) **Çmimin e Shfrytëzimit të Shërbimit Ndhmës (CSh_{ShN})** në €/MWh.


Asnjë e dhënë tjetër nga **Kontrata për Shërbimet Ndhmëse** për prokurimin e **Rezervës** nuk është relevante për **Barazimin Përfundimtar**.

13.3 Kontratat për Humbjet

13.3.1 **OST** duhet të prokurojë energji për të mbuluar Humbjet në Transmetim. **OST** mund të zhvillojë ankande për të prokuruar kontratat e humbjeve në të cilat mund të marrin pjesë përveç pjesëmarrësve të licencuar në Kosovë, edhe pjesëmarrës të licencuar jashtë Kosovës, sipas parimit të reciprocitetit dhe në përputhje me rregullat e aplikueshme të tregut në Kosovë duke përfshirë rregullat fiskale. **OST** gjithashtu mund të prokurojë energji për të mbuluar humbjet nga një **PX**.

13.3.2 Kontrata e Humbjeve në Transmetim "HT" do të përfshijë kushtet që specifikojnë:

- (a) që **OST** do të udhëzojë **Palën Tregtare** me të cilën është lidhur kontrata që të dorëzojë një nominim kontraktual për llogarinë e tij përkatëse të injektimit ose llogarinë e dalëse "A" për të ofruar vëllimin e energjisë (QCAj) të njoftuar asaj nga **OST** në Llogarinë Tregtare të **OST-së** në lidhje me Humbjet e Transmetimit për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalancit "j"** të ditës para përpara se të bëhen nominime të tjera kontraktuale në lidhje me atë **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalancit** dhe **OST** do të marrë përsipër të paraqesë nominimin kontraktual të harmonizuar;
- (b) pagesat (në €) e rezervës të kontratës së humbjeve të transmetimit ($CASCR_{HTm}$) për çdo muaj "m";

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 78 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (c) një çmim i vetëm i shfrytëzimit të kontratës për humbjet në transmetim (ÇSHK_{HT}) në €/MWh.

Asnjë kusht tjetër i Kontratës së Humbjeve në Transmetim nuk është relevant për **Barazimin Përfundimtar**.

13.4 Operimi i Kontratave të Shërbimeve Ndihmëse

13.4.1 **OST** do t'i shfrytëzojë **Kontratat e Shërbimeve Ndihmëse** sipas kushteve të **Kodit të Rrjetit**, dhe do ti udhëzojë **Njësitë Balancuese** sipas kushteve të **Kontratës së Shërbimeve Ndihmëse**.

13.4.2 Kur një **Kontratë e Shërbimit Ndihmës "ShN"** për **aFRR, mFRR** ose **Rezervën Zëvendësuese RR** është në operim atëherë, **OST** do ta njoftojë **OT** për:

- (a) Energjinë " EK_{Aj} " të liferuar ose të marrë nga **Llogaria "A"** e **Palës Tregtare** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalancit "j"**; të cilën **OT** do ta trajtoj si një **Aktivizim të Ofertës për Blerje** ose (si mund të jetë) rasti **Aktivizim të Ofertës për Shitje** në përputhje me paragrafin 12.3

dhe **OT** do të kreditojë ose (sipas rastit) debitojë **Llogarinë "A"** e **Palës Tregtare** të specifikuar nga **OST** dhe do të:

- (b) debitojë ose (sipas rastit) kreditojë **Llogarinë Tregtuese të OST** me **Pagesën për Rezervën e Shërbimit Ndihmës (PR_{ShNm})** (në €) për muajin relevant " m " të kalkuluar si:

$$PR_{ShNm} = (XMR_b * \zeta R_{ShN} + XMRN_b * \zeta RN_{ShN}) * H * N$$


ku:

- XMR_b është **Margjina e Kapacitetit Rezervë** në MW;
- $XMRN_b$ është **Margjina Negative e Kapacitetit Rezervë** në MW
- ζR_{ShN} është **Çmimi i Rezervës për Shërbimin Ndihmës** (në €/MW/orë) për kapacitetin e rezervuar sipas kontratës;
- ζRN_{ShN} është **Çmimi për Rezervën Negative për Shërbimin Ndihmës** (në €/MW/orë) për kapacitetin e rezervuar sipas kontratës;
- H është kohëzgjatja e **Periodës të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** në orë; dhe
- N është numri **Periodave të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** për të cilat kontrata është aktive;

- (c) dhe debitojë ose (sipas rastit) kreditojë **Llogarinë Balancuese të OST** me **Pagesa për Shfrytëzimin e Shërbimit Ndihmës (PSh_{ShNj})** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** e kalkuluar si:

$$PSh_{ShNj} = EK_{Aj} * \zeta Sh_{ShN}$$

ku:

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 79 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

EK_{Aj} është energjia e angazhuar (në MWh) që i është deklaruar **OT** nga ana e **OST**;

ζSh_{ShN} është **Çmimi i Shfrytëzimit të Shërbimit Ndhmës** në €/MWh;

dhe vlen të ceket se kur shuma EK_{Aj} është negative (do të thotë që **Margjina Negative e Kapacitetit Rezervë** është shfrytëzuar sipas kontratës), **Pagesa për Shfrytëzimin e Shërbimit Ndhmës** do të rezultojë me debitimin e parave në **Llogarinë e Palës Tregtare** dhe kreditimin në **Llogarinë Balancuese të OST**.

13.5 Përfshirja e Rezervës në Çmimin e Jobalancit

13.5.1 Për nevoja të përfshirjes së **Rezervës për Restaurimin e Frekuencës** dhe **Rezervës Zëvendësuese** në kalkulimin e **Çmimit të Jobalancit** (dhe jo për ndonjë qëllim tjetër), shfrytëzimi i kontratës për rezervë për të rritur liferimin e energjisë do të trajtohet si **Aktivizim i Ofertës për Shitje** dhe shfrytëzimi i kontratës për të zvogëluar liferimin e energjisë do të trajtohet si **Aktivizim i Ofertës për Blerje** në përputhje me këtë nen 13.5.

13.5.2 Për çdo **Kontratë të Shërbimeve Ndhmëse "ShN"** ku energjia e nominuar e shfrytëzuar EK_{ShNj} është më e madhe se zero për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** atëherë **OT** do të regjistrojë një **Aktivizim të Ofertës për Shitje** me parametrat vijues:

(a) Çmimi i **Ofertës për Shitje** (ζOSh_{ShNj}) do të kalkulohet si vijon:

$$\zeta OSh_{ShNj} = \zeta Sh_{ShN} + \zeta R_{ShN} * KShR_j$$

ku:

ζSh_{ShN} është **Çmimi i Shfrytëzimit të Shërbimit Ndhmës** në €/MWh;

ζR_{ShN} është **Çmimi i Rezervës për Shërbimin Ndhmës** në €/MW/orë për kapacitetin e rezervuar sipas kontratës;

$KShR_j$ është **Koeficienti i Shfrytëzimit të Rezervës Pozitive** i njoftuar nga ana e **OST** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**; dhe

(b) Energjia e **Ofertës për Shitje** ($E OSh_{ShNj}$) është energjia e njoftuar nga ana e **OST** ($E K_{ShNj}$).


13.5.3 Për çdo **Kontratë të Shërbimeve Ndhmëse "ShN"** ku energjia e shfrytëzuar $E K_{ShNj}$ është më e vogël se zero për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** atëherë **OT** do të regjistrojë një **Aktivizim të Ofertës për Blerje** me parametrat vijues:

(a) çmimi i **Ofertës për Blerje** ($\zeta O B_{ShNj}$) do të kalkulohet sipas formulës;

$$\zeta O B_{ShNj} = \zeta Sh_{ShN} - (\zeta R_{ShN} * KShRN_j)$$

ku:

ζSh_{ShN} është **Çmimi i Shfrytëzimit të Shërbimit Ndhmës** në €/MWh;

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 80 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

ζRN_{ShN} është **Çmimi i Rezervës Negative për Shërbimet Ndhmëse** në €/MWh/orë për kapacitetin e rezervuar sipas kontratës;

$KShRN_j$ është **Koeficienti i Shfrytëzimit të Rezervës Negative** i njoftuar nga **OST për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**; dhe

- (b) Energjia e **Ofertës për Blerje** (EOB_{ShNj}) do të jetë energjia e njoftuar nga **OST** (EK_{ShNj}).

13.5.4 **OST** mund të shënjojë një **Aktivizim të Ofertës për Blerje** ose të shënjojë një **Aktivizim të Ofertës për Shitje** sipas **Kontratës së Shërbimeve Ndhmëse** në përputhje me nenin 12.4;

13.6 Operimi i Kontratave të Humbjeve

13.6.1 Kur një Kontratë e Humbjeve të Transmetimit "HT" është në veprim, **OT** do të kreditojë llogarinë "A" të **Palës Tregtare** të specifikuar në nominimin përkatës kontraktual dhe do të debitojë llogarinë Tregtare të **OST**-së me:

- (a) Pagesën (në €) e Rezervës të Kontratës së Humbjeve të Transmetimit ($PRSHK_{HTm}$) për muajin përkatës "m"; dhe
- (b) Pagesa e Shfrytëzimit të Kontratës së Humbjeve të Transmetimit ($PSHK_{HTj}$) për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** e llogaritur si:

$$PSHK_{HTj} = EK_{Anj} * \zeta SHK_{HT}$$

ku:


EK_{Anj} është vëllimi i energjisë (në MWh) në Nominimin Kontraktual "n";

ζSHK_{HT} është çmimi i shfrytëzimit të kontratës së humbjeve të transmetimit në €/MWh

13.7 Shkëmbimet e Paqëllimshme

13.7.1 Në përputhje me kërkesat e Rregullores së Bashkimit Evropian për Balancimin e Energjisë, **OST**-të në **Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale** kanë rënë dakord për rregullat e përbashkëta të **Barazimit Përfundimtar për Shkëmbimet e Paqëllimshme**. **OST** do të ofrojë informacion të tillë që kërkohet për të përcaktuar çmimin e **Shkëmbimeve të Paqëllimshme**, të cilat do të përdoren për të kompensuar **OST**-të në zonën sinkrone për jobalancat e sistemit që ndodhin. Sipas kushteve të marrëveshjes, **OST** do t'i sigurohet një **Çmim i Shkëmbimit të Paqëllimshëm** që pasqyron koston brenda të gjithë zonës sinkrone dhe ky çmim do të përdoret për **Barazimin Përfundimtar për Shkëmbimet e Paqëllimshme**.

- a) Kur **OST** njoftohet për **Çmimin e Shkëmbimit të Paqëllimshëm** dhe është njoftuar ose ka llogaritur Shkëmbimin e Paqëllimshëm neto, **OST** do të debitojë ose kreditojë llogarinë Balancuese të **OST "A"** me pagesat e shkëmbimit të paqëllimshëm ($PSHPA_j$) për një **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** të llogaritur duke përdorur formulën:

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 81 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		


$$PSHP_{Aj} = ESHP_{Aj} \times \text{ÇSHP}_j$$

Ku:

j është **Perioda e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** në të cilën është bërë rregullimi financiar (dhe, për të shmangur dyshimin, kjo mund të ndryshojë nga **Perioda e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** në të cilën ka ndodhur shkëmbimi i paqëllimshëm);

$ESHP_{Aj}$ është shkëmbimi i paqëllimshëm në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**; dhe

ÇSHP_j është **çmimi i shkëmbimit të paqëllimshëm në Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 82 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

PJESA III: BARAZIMI PËRFUNDIMTAR

14 Barazimi Përfundimtar i Aktivizimit të Ofertave për Blerje dhe Aktivizimit të Ofertave për Shitje

14.1 Pagesa për Aktivizimin e Ofertave për Blerje dhe për Aktivizimin e Ofertave për Shitje

14.1.1 Në përfundim të çdo **Periode të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** për çdo **Njësi Balancuese "b"**, **OST** do ta informojë **OT** për çdo urdhëresë për **Aktivizimin e Ofertës për Blerje** dhe urdhëresë për **Aktivizimin e Ofertës për Shitje "n"** dhe **OT** do të përcaktojë **Pozitën e Urdhëruar (XPU_{bj})** që do të jetë vlera mesatare e MW për orë mbi ose nën nivelin e **Nominimit Fizik të Njesisë Balancuese** të kalkuluar si vijon:

(a) kohëzgjatja (në minuta) T_{bn} e **Nivelit të Urdhëruar (XNU_{bn})** do të jetë:

i. kur $TSXNU_{bn}$ është para TS_j :

$$T_{bn} = \text{minimumi} (TSXNU_{bn} + TPXNU_{bn} - TS_j, H * 60)$$

ii. kur $TSXNU_{bn}$ është gjatë ose pas TS_j dhe $TPXNU_{bn} + TSXNU_{bn}$ është pas TS_{j+1} :

$$T_{bn} = TS_{j+1} - TSXNU_{bn}$$

iii. përndryshe $T_{bn} = TPXNU_{bn}$

ku:

$TSXNU_{bn}$ është **Koha e Startimit të Nivelit të Urdhëruar;**

$TPXNU_{bn}$ është **Kohëzgjatja e Nivelit të Urdhëruar;**

TS_j është koha e fillimit të **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve;**

TS_{j+1} është koha e përfundimit të **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve;**


H është kohëzgjatja në orë e **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve;**

(b) kohëzgjatja (T_{b0}) kur nuk ka **Aktivizim të Ofertës për Blerje** ose **Aktivizim të Ofertës për Shitje** kalkullohet si:

$$T_{b0} = H * 60 - \sum_n T_{bn}$$

(c) **Pozita e Urdhëruar (XPU_{bj})** kalkullohet si:

$$XPU_{bj} = \frac{\left((XN_{bj} * T_{b0}) + \sum_n (XNU_{bn} * T_{bn}) \right)}{H * 60}$$

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 83 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

ku:

XN_{bj} është pozita e **Nominimit Fizik** e dorëzuar në përputhje me nenin 11.1.

14.1.2 Për **Njësinë Balancuese "b"** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**, në qoftë se **Pozita e Urdhëruar** (XPU_{bj}) është më e madhe ose e barabartë me pozicionin (XN_{bj}) e **Nominimit Fizik** të dorëzuar në përputhje me nenin 11.1 ose nenin 11.4, atëherë konsiderohet se është bërë një **Aktivizim i Ofertës për Shitje**, përndryshe konsiderohet se është bërë **Aktivizim i Ofertës për Blerje**, dhe:

(a) energjia e **Aktivizimit të Ofertës për Shitje** ($EOSh_{bj}$) kalkullohet nga formula:

$$EOSh_{bj} = (XPU_{bj} - XN_{bj}) * H$$

ndërsa

(b) energjia e **Aktivizimit të Ofertës për Blerje** (EOB_{bj}) kalkullohet nga formula:

$$EOB_{bj} = (XPU_{bj} - XN_{bj}) * H$$

ku:

H është kohëzgjatja e **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** në orë.

14.1.3 **Pagesa e Ofertës për Shitje** ($POSh_{bj}$) për energjinë e një **Aktivizimi të Ofertës për Shitje** ($EOSh_{bj}$) për **Njësinë Balancuese "b"**, për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** kalkullohet nga formula:

$$POSh_{bj} = EOSh_{bj} * \zeta OSh_{bj}$$

ku:


ζOSh_{bj} është çmimi i **Ofertës për Shitje** i dorëzuar për **Njësinë Balancuese "b"** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**.

14.1.4 **Pagesa e Ofertës për Blerje** (POB_{bj}) për energjinë e një **Aktivizimi të Ofertës për Blerje** (EOB_{bj}) për **Njësinë Balancuese "b"** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** kalkullohet nga formula:

$$POB_{bj} = EOB_{bj} * \zeta OB_{bj}$$

ku:


ζOB_{bj} është çmimi i **Ofertës për Blerje** i dorëzuar për **Njësinë Balancuese "b"** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 84 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

14.1.5 **Pagesa e Ofertës për Shitje** do të kreditohet në **Llogarinë** relevante të **Palës Tregtare** dhe do të debitohet në **Llogarinë Balancuese të OST**.

14.1.6 **Pagesa e Ofertës për Blerje** do të kreditohet në **Llogarinë Balancuese të OST** dhe do të debitohet nga **Llogaria e Palës Tregtare** relevante.

14.1.7 Në qoftë se ndonjë urdhëresë e dhënë nga **OT** sipas paragrafit 14.1.1 është **Ofertë e Shënjuar për Blerje** ose **Ofertë e Shënjuar për Shitje** atëherë rezulton se **Aktivizimi i Ofertës për Blerje** ose **Aktivizimi i Ofertës për Shitje** do të trajtohet si **Ofertë e Shënjuar për Blerje** ose **Ofertë e Shënjuar për Shitje** pa marrë parasysh se a ka pasur ndonjë urdhëresë tjetër që ndikon në **Njësinë Balancuese** për atë **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	ver. 3.1	Faqe 85 nga 123
Departamenti: Operatori i Tregut		

15 Kalkulimi i Çmimit të Jobalancit

15.1 Jobalanci i Sistemit

15.1.1 Sa më shpejt që të jetë e mundur pas ditës D, **OST** do të informojë **OT** për **Shkëmbimet e Paqëllimshme (EDP_j)** në MWh për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** të ditës D.

15.1.2 Për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”**, **OT** do të përcaktojë **Jobalancin e Sistemit (JBS_j)** nëpërmes formulës:

$$JBS_j = \sum_n EOSh_{nj} + \sum_{nn} EOB_{nnj} + EDP_j$$

ku:

EOSh_{nj} është energjia e liferuar nga **Aktivizimi i Ofertave për Shitje “n”** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** të përcaktuar në përputhje me paragrafin 12.3.1, paragrafin 12.5.1 ose paragrafin 13.5.2(b);

EOB_{nnj} është energjia e liferuar nga **Aktivizimi i Ofertave për Blerje “nn”** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** të përcaktuar në përputhje me paragrafin 12.3.1 ose paragrafin 13.5.3(b);

EDP_j janë **Shkëmbimet e Paqëllimshme** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”**.

15.2 Përrjashtimi i Aktivizimeve të Shënjuara

15.2.1 Për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”**, **OT** do të përcaktojë (ose ri-përcaktojë, sipas rastit) **Energjinë e Shënjuar Neto (EShënj_j)** nëpërmes:

$$EShënj_j = \sum_n EOSh_{Tnj} + \sum_{nn} EOB_{Tnnj}$$


ku:

EOSh_{Tnj} është energjia e liferuar nga **Aktivizimi i Ofertave për Shitje “n”** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** e përcaktuar në përputhje me paragrafin 12.3.1, paragrafin 12.5.1 ose paragrafin 13.5.2(b) ku statusi i shënjuar “T” është vënë në “1”;


EOB_{Tnnj} është energjia e liferuar nga **Aktivizimi i Ofertave për Blerje “nn”** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** e përcaktuar në përputhje me paragrafin 12.3.1 ose paragrafin 13.5.3(b) ku statusi i shënjuar “T” është vënë në “1”.

15.2.2 Pasi që **OT** të ketë përcaktuar (ose ri-përcaktuar, sipas rastit) **Energjinë e Shënjuar Neto (EShënj_j)** të kalkular në përputhje me paragrafin 15.2.1 atëherë:

- (a) Në qoftë se **Jobalanci i Sistemit (JBS_j)** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** i kalkular në përputhje me paragrafin 15.1.2 është më i madh se zero dhe në qoftë se **Energjia e Shënjuar Neto (EShënj_j)** e kalkular në përputhje me paragrafin 15.2.1 është më e vogël se zero, atëherë **OT** do të:

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 86 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- i. bëjë sortimin e të gjitha **Ofertave për Shitje të Aktivizuara “n”** ku statusi i shënjuar “T” është zero sipas çmimit më të lartë të **Ofertave për Shitje (ÇOSH_{Tnj})** dhe pastaj.
 - ii. Nëse “n” është më i madh se zero, do të analizojë **Aktivizimin e Ofertës për Shitje** të parën sipas sortimit të bërë në paragrafin 15.2.2(a) i dhe:
 - (1) nëse vlera e energjisë (në kahun pozitiv) të **Aktivizimit të Ofertës për Shitje (EOSH_{Tij})** është më e vogël ose e barabartë me vlerën (në kahun pozitiv) e **Energjisë së Shënjuar Neto (ESHënjj)** të kalkuluar në përputhje me paragrafin 15.2.1 atëherë **OT** do ta bëjë **Aktivizimin e Ofertës për Shitje si Ofertë të Shënjuar për Shitje** duke i dhënë statusin e shënjuar “1” dhe do të ri-caktojë **Energjinë e Shënjuar Neto (Eshënjj)** në paragrafin 15.2.1; ose
 - (2) nëse vlera e energjisë (në kahun pozitiv) e **Aktivizimit të Ofertës për Shitje (EOSH_{Tij})** është më e madhe se vlera e **Energjisë së Shënjuar Neto** (në kahun pozitiv) (ESHënjj) e kalkuluar në përputhje me paragrafin 15.2.1 atëherë **OT**, për nevoja të kalkulimit të **Çmimit të Jobalancit** (dhe jo për nevoja tjera), do t’i shtojë **Energjinë e Shënjuar Neto** energjisë së **Aktivizimit të Ofertës për Shitje (EOSH_{Tij})**;
 - iii. nëse “n” është e barabartë me zero atëherë **Çmimi i Jobalancit** do të jetë **Çmim Mesatar i Jobalancit** dhe nuk do të bëhen kalkulime të mëtejme; ose
- (b) Në qoftë se **Jobalanci i Sistemit (JBS_j)** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** i kalkuluar në përputhje me paragrafin 15.1.2 është më i vogël se zero dhe në qoftë se **Energjia e Shënjuar Neto (ESHënjj)** e kalkuluar në përputhje me paragrafin 15.2.1 është më e madhe se zero, atëherë **OT** do të:
- i. bëjë sortimin e të gjitha **Ofertave për Blerje të Aktivizuara “n”** ku statusi i shënjuar “T” është zero sipas çmimit më të ulët të **Ofertave për Blerje (ÇOB_{Tnj})** dhe
 - ii. Nëse “n” është më i madh se zero, do të analizojë **Aktivizimin e Ofertës për Blerje**, të parën sipas sortimit të bërë në paragrafin 15.2.2(b) i dhe:
 - (1) Nëse vlera e energjisë të **Aktivizimit të Ofertës për Blerje (EOB_{Tij})** është më e vogël ose e barabartë me vlerën e **Energjisë të Shënjuar Neto (ESHënjj)** të kalkuluar në përputhje me paragrafin 15.2.1 atëherë **OT** do ta bëjë **Aktivizimin e Ofertës për Blerje si Ofertë e Shënjuar për Blerje** duke i dhënë statusin e shënjuar “1” dhe do të ri-caktojë **Energjinë e Shënjuar Neto (ESHënjj)** në paragrafin 15.2.1; ose
 - (2) Nëse vlera e energjisë së **Aktivizimit të Ofertës për Blerje (EOB_{Tij})** është më e vogël se vlera e **Energjisë të Shënjuar Neto (ESHënjj)** e kalkuluar në përputhje me paragrafin 15.2.1 atëherë **OT**, për nevoja të kalkulimit të **Çmimit të Jobalancit**, do t’i shtojë **Energjisë të Shënjuar Neto** energjinë e **Aktivizimit të Ofertës për Blerje (EOB_{Tij})**.
 - iii. nëse “n” është e barabartë me zero, atëherë **Çmimi i Jobalancit** do të jetë **Çmimi Mesatar i Jobalancit** dhe nuk do të bëhen kalkulime të mëtejme;.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	ver. 3.1	Faqe 87 nga 123
Departamenti: Operatori i Tregut		

15.3 Kalkulimi i Çmimit të Jobalancit

15.3.1 Në qoftë se **Jobalanci i Sistemit (JBS_j)** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar "j"** i kalkuluar sipas paragrafit 15.1.2 është më i madh se zero atëherë: **OT** do t'i mbledhë të gjitha **Aktivizimet e Ofertave për Shitje (EOSH_{Tnj})** të pa shënuara "n" (duke përfshirë edhe korrigjimet në përputhje me nenin 15.2) ku statusi i shënuar është zero, dhe

- (a) në qoftë se shuma totale e **Aktivizimeve të Ofertave për Shitje** është më e madhe se zero atëherë **OT** do të kalkulojë **Çmimin e Jobalancit (ÇJB_j)** si:

$$\zeta JB_j = \frac{\sum_n (EOSH_{Tnj} * \zeta COSh_{Tnj})}{\sum_n EOSH_{Tnj}}$$

ku:

EOSH_{Tnj} është energjia e liferuar nga **Aktivizimi i Ofertës për Shitje "n"** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** ku statusi i shënuar "T" është vendosur në "0";

ÇOSH_{Tnj} është çmimi i **Ofertës për Shitje** nga **Aktivizimi i Ofertës për Shitje "n"** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** ku statusi i shënuar "T" është vendosur në "0";

- (b) në qoftë se shuma e **Aktivizimeve të Ofertave për Shitje** është zero, atëherë **OT** do të përcaktojë **Çmimin e Jobalancit (ÇJB_j)** si **Çmimi Mesatar i Jobalancit** i kalkuluar në përputhje me paragrafin 15.4.1

15.3.2 Në qoftë se **Jobalanci i Sistemit (JBS_j)** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** i kalkuluar sipas paragrafit 15.1.2 është më i vogël se zero atëherë: **OT** do të mbledhë të gjitha **Aktivizimet e Ofertave për Blerje (EOB_{Tnj})** të pa shënuara "n" (duke përfshirë edhe korrigjimet në përputhje me nenin 15.2) ku statusi i shënuar është zero, dhe

- (a) në qoftë se shuma totale e **Aktivizimeve të Ofertave për Blerje** është më e vogël se zero atëherë **OT** do të kalkulojë **Çmimin e Jobalancit (ÇJB_j)** si:


$$\zeta JB_j = \frac{\sum_n (EOB_{Tnj} * \zeta COB_{Tnj})}{\sum_n EOB_{Tnj}}$$

ku:

EOB_{Tnj} është energjia e liferuar nga **Aktivizimi i Ofertave për Blerje "n"** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** ku statusi i shënuar "T" është vendosur në "0";

ÇOB_{Tnj} është çmimi i **Ofertës për Blerje** nga **Aktivizimi i Ofertës për Blerje "n"** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** ku statusi i shënuar "T" është vendosur në "0";

- (b) në qoftë se shuma e **Aktivizimeve të Ofertave për Blerje** është zero atëherë **OT** do të përcaktojë **Çmimin e Jobalancit (ÇJB_j)** si **Çmim Mesatar të Jobalancit** të kalkuluar në përputhje me paragrafin 15.4.1.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 88 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

15.3.3 Në qoftë se **Jobalanci i Sistemit (JBS_j)** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar “j”** i kalkuluar sipas paragrafit 15.1.2 është zero atëherë: **OT** do të përcaktojë **Çmimin e Jobalancit (ÇJB_j)** si **Çmim Mesatar të Jobalancit** të kalkuluar në përputhje me paragrafin 15.4.1.

15.4 Çmimi Mesatar i Jobalancit


15.4.1 **Çmimi Mesatar i Jobalancit** për një **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** është mesatarja aritmetike e **Çmimit të Jobalanceve** në **Periodat e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** që mbulon 720 orë paraprake.

15.4.2 **Çmimi Mesatar i Jobalancit** do të aplikohet në përputhje me rrethanat e parashtruara në nenin 15.3 ose kur **OST** të ketë deklaruar gjendje emergjente në sistem.

15.5 Publikimi i Çmimit të Jobalancit

15.5.1 **OT** do të publikojë **Çmimin e Jobalancit** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar** deri në orën 12:00 të **Ditës së Punës** pas **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**.

15.5.2 **OT** nuk mund të kalkulojë dhe publikojë **Çmimet e Jobalancit** deri sa të pranojë nga **OST** kalkulimet relevante për **Shkëmbimet e Paqëllimshme**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 89 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

16 Kalkulimet e Barazimit Përfundimtar

16.1 Të Dhënat e Barazimit Përfundimtar

16.1.1 Të dhënat e **Barazimit Përfundimtar** janë të gjitha të dhënat që sipas **Rregullave të Tregut** kërkohen të sigurohen nga **OT** ose **Palët** tjera. Të dhënat e **Barazimit Përfundimtar** që duhet të sigurohen nga **Palët** duhet të dorëzohen në sektorët ose adresat që i përcakton **OT**.

16.1.2 **OT** do të mirëmbajë të gjitha të dhënat e sakta dhe komplete për **Barazimin Përfundimtar**. Format i të dhënave duhet të jetë i përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga **OT**.

16.1.3 Të gjitha të dhënat e **Barazimit Përfundimtar** duhet të ruhen për një periudë jo më të shkurtër se gjashtë (6) vjet, duke filluar nga data kur është bërë ekzekutimi i parë i **Barazimit Përfundimtar**.

16.1.4 **OT** do t'u mundësojë **Palëve** të kenë qasje në të dhënat e tyre të **Barazimit Përfundimtar** që administrohen nga **OT**.

16.2 Çmimet e Rregulluara dhe të dhënat e Barazimit Përfundimtar

16.2.1 **ZRrE** do t'i sigurojë **OT** të gjitha çmimet e rregulluara dhe të dhënat përcjellëse që duhet të përdoren në **Barazimin Përfundimtar** dhe lëshimin e faturave për palët e treta.

16.2.2 **OST** dhe **OSSH** do t'i dorëzojnë **AAM** në kohë të caktuar **Të Dhënat Matëse** nga të gjitha **Sistemet Matëse** të nevojshme për **Barazimin Përfundimtar**. Në qoftë se këto të dhëna nuk janë të disponueshme, **OST** ose **OSSH** (sipas rastit) duhet të bëjnë përafrimet e tyre më të mira për të dhënat që mungojnë, sipas nenit 5.5, 5.6, 5.7 dhe 5.8.


16.2.3 **Palët Tregtare** do t'i dërgojnë me kohë **OT** të gjitha vlerat e energjisë nga **Nominimet Kontraktuale** me të dhënat e tyre përcjellëse.

16.3 Të Dhënat që përdoren në Barazimin Përfundimtar

16.3.1 Brenda pesë (5) **Ditë Pune** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**, **Palët Tregtare** duhet ti dërgojnë **OT** dhe **AAM** të gjitha **Të Dhënat Matëse** (ose përafrimet e tyre) që duhet të përdoren në **Barazimin Përfundimtar të Jobalanceve**.

16.3.2 **Të Dhënat Matëse** që kërkohen për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** janë:

- (a) **Energjia e Matur e Njesisë Gjeneruese** (e cila, për të shmangur dyshimin, përfshin edhe Energjinë e matur të **Njesisë së Balancimit të Sistemit të Ruajtjes** që mund të jetë pozitive ose negative) ($ENjG_{BAbj}$) për çdo **Njësi Gjeneruese "b"** të regjistruar tek **Pala Tregtare "A"** dhe çdo **Nominim Interkonektiv** të konfirmuar "b" për **Njësi Balancuese në Interkonektor** të regjistruar tek **Pala Tregtare "A"**, ku **Pala Tregtare "A"** është e regjistruar në **Llogarinë Injektuese të PPB "B"**;
- (b) **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese** ($ENjF_{Abj}$) për çdo **Sistem Matës të Furnizimit "b"** të regjistruar tek **Pala Tregtare "A"**, duke përfshirë **Energjinë e Matur** të korriguar të kalkuluar në emër të **Palës Tregtare** në përputhje me **Marrëveshjen për Alokimin e Matjeve** dhe çdo **Nominim Interkonektiv** të konfirmuar "b" për **Njesisë Balancuese në Interkonektor** të regjistruar të **Palës Tregtare "A"** ku **Pala Tregtare "A"** është e regjistruar në **Llogarinë Injektuese të PPB "B"**; **Energjia e Matur** në

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 90 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Rrjetin e Shpërndarjes (EZ_{oj}) për çdo Sistem Matës “o” nga Sistemi i Transmetimit; dhe

(c) **Energjia e Matur Ndërkufitare (EMN)** për çdo Sistem Matës të linjës interkonektive

16.3.3 Të dhënat e **Nominimit Kontraktual** të kërkuara për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** janë:

- (a) energjia ($EK_{BA_{nj}}$ në MWh) për çdo **Nominim Kontraktual “n”** të bërë për **Palën Tregtare “A”** që është e regjistruar në **Llogarinë e PPB “B”** ose, në rastin e një **OST-je, OSSH-je** ose një **PX** me Llogarinë Tregtare përkatëse të **OST-së, Llogarinë e Injektimit të Njesisë së Ruajtjes të OST-së, Llogarinë e Injektimit të Sistemit të Ruajtjes, Llogarinë Tregtare të OSSh-së, Llogarinë Balancuese të OST-së** ose Llogarinë Balancuese të **PX**, secila një llogari “B”;
- (b) **Nominimet Interkonektive** të konfirmuara ($EK_{BA_{nj}}$ në MWh) për çdo **Interkonektor “n”** të bërë për **Palën Tregtare “A”** që është e regjistruar në **Llogarinë e PPB “B”**.

16.4 Energjia e Matur e Konsumatorit


16.4.1 Për **Konsumatorin fundor, Sistemi Matës “b”** i të cilit është **Sistem Matës Interval, Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese ($ENjF_{Abj}$)** do t’i dërgohet **OT** nga ana e **AAM** duke u bazuar në **Të Dhënat Matëse** aktuale (ose sipas rastit) të përafëruara për çdo **Palë Tregtare “A”** që është e regjistruar në **Llogarinë Dalëse të PPB “B”** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”**.

16.4.2 **OT** do të publikojë një procedurë për përcaktimin e **Energjisë së Matur** në të cilën do të përcaktojë se si ndahet Energjia e Matur e Rrjetit të Shpërndarjes ndërmjet Furnizuesve me **Konsumator fundor** në **Sistemet e Shpërndarjes**, të cilët do të aplikojnë principet vijuese:

- (a) sasia e energjisë që do t’i përcaktohet **Njehsorëve me Lexim Jo-Interval** do të jetë shuma e **Energjisë së Matur** në **Rrjetin e Shpërndarjes** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** minus shuma e **Energjisë së Matur e Njësive Furnizuese** në **Sistemet Matëse Intervale** minus **Humbjet** në **Shpërndarje**;
- (b) **Sasia Vjetore e Energjisë** e llogaritur për çdo **Sistem Matës Jo-Interval të Furnizuesit “A”** (të ndryshëm nga **Sistemet Matëse të Furnizuesit Publik**) do të kalkulohet si **Përpjesë e Sistemit Matës të Furnizuesit ($PSMF_{Ab}$)** për **Sistemin Matës “b”** nga energjia totale e llogaritur si marrje nga ana e **Sistemit të Shpërndarjes** (e zvogëluar për shumën vjetore të **Humbjeve në Shpërndarje**) që nuk është matur nga **Sistemet Matëse me Njehsor Interval**;
- (c) **Përpjesa e Sistemit Matës të Furnizuesit** do të aplikohet në përcaktimin e **Energjisë së Matur** në **Rrjetin e Shpërndarjes** për **Sistemin Matës Jointerval të Furnizuesit** për nevojat të kalkulimit të **Jobalanceve** për atë **Furnizues**.

16.4.3 Në raport me **Palën Tregtare “A”** që është e regjistruar në **Llogarinë Dalëse të PPB “B”**, të gjitha **Sistemet Matëse Jo-intervale** të regjistruara tek ajo **Palë Tregtare** do të trajtohen si një **Sistem Matës i vetëm “b”** dhe **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese ($ENjF_{BA_{bj}}$)**, për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** si:

$$ENjF_{BA_{bj}} = PSMF_{Ab} * \left(\sum_o EZ_{oj} - \sum_n EHS_{h_{oj}} - \sum_n ENjF_{nj} \right)$$

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	ver. 3.1	Faqe 91 nga 123
Departamenti: Operatori i Tregut		

ku:

$PSMF_{Ab}$ është **Përpjesa e Sistemit Matës të Furnizuesit** e kalkuluar në përputhje me **Procedurën e Rregullave të Tregut** për përcaktimin e **Energjisë së Matur** për **Sistemet Matëse Jo-intervale** të regjistruara në **Llogarinë Dalëse**;

EZ_{oj} është sasia e energjisë së matur e liferuar në **Sistemin Matës të Rrjetit të Shpërndarjes "o"**;

EHS_{oj} është energjia e përcaktuar si **Humbje në Shpërndarje** në **Sistemin Matës "o"**;

$ENjF_{nj}$ është **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese të Sistemit Matës Interval "n"** të kyçur në shpërndarje.

16.4.4 Deri në kohën kur mund të kalkuloohen profilet objektive të klasave matëse për **Furnizuesit Publik "A"**, të regjistruar në **Llogarinë Dalëse të PPB "B"** të gjitha **Sistemet Matëse** të kyçura në shpërndarje të regjistruara tek **Furnizuesi Publik** do të trajtohen si një **Njësi Balancuese** e vetme "b" dhe **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese** ($ENjF_{BAbj}$), për **Periodën e Barazimit Përfundimtar "j"** do të kalkulohet si:

$$ENjF_{BAbj} = \sum_o EZ_{oj} - \sum_n EHS_{oj} - \sum_n ENjF_{nj}$$

ku:

EZ_{oj} është energjia e matur e liferuar në **Sistemin Matës të Rrjetit të Shpërndarjes "o"**;

EHS_{oj} është energjia e përcaktuar si **Humbje në Shpërndarje** në **Sistemin Matës "o"**;

$ENjF_{nj}$ është **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese të Sistemit Matës** të kyçur në shpërndarje "n" e regjistruar tek një **Furnizuesi** i ndryshëm nga **Furnizuesi Publik**.

16.5 Kalkulimi i Jobalancit


16.5.1 Për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalancëve**, dita e **Barazimit Përfundimtar** do të jetë shtatë (7) **Ditë Pune** pas ditës së **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalancëve**.

16.5.2 Për çdo ditë të **Barazimit përfundimtar, OT** do të kryej të gjitha aktivitetet e **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalancëve** të përshkruara në këtë nen, sipas paragrafit 16.5.1.

16.5.3 Për **Llogarinë e Injektivit "B"** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalancëve "j"**, **Energjia e Matur e Llogarisë së Injektivit** (EMI_{Bj}), **Jobalanci i Llogarisë së Injektivit** (EJB_{Bj}) dhe **Pagesa e Energjisë së Jobalancit e Llogarisë së Injektivit** e ($PEJB_{Bj}$) llogariten si vijon:

$$EMI_{Bj} = \sum_A \sum_b ENjG_{BAbj}$$

$$EJB_{Bj} = EMI_{Bj} - \sum_A \sum_n EK_{BA nj} - \sum_A \sum_b EOSH_{BAbj} - \sum_A \sum_b EOB_{BAbj} - \sum_A \sum_b EK_{BS nj}$$

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	ver. 3.1	Faqe 92 nga 123
Departamenti: Operatori i Tregut		

$$PEJB_{Bj} = EJB_{Bj} * \zeta JB_j$$

ku:

$ENjG_{BAbj}$ është energjia e matur e liferuar nga **Njësia Gjeneruese** e kyçur në transmetim “b” e regjistruar tek **Pala Tregtare “A”** që është e regjistruar me **PPB “B”** dhe **Nominimi Interkonektiv** i konfirmuar “b” në një **Njësi Balancuese** importuese në **Interkonektor** të regjistruar tek **Pala Tregtare “A”** që është e regjistruar me **PPB “B”**;

$EK_{BA nj}$ është energjia e **Nominimit Kontraktual “n”** dhe **Nominimi Interkonektiv** i konfirmuar “n” të bërë nga **Pala Tregtare “A”** që është e regjistruar **Llogarinë “B”**;

$EOSH_{BA b}$ është energjia e liferuar në një **Aktivizim të Ofertës për Shitje** nga **Njësia Balancuese “b”** e regjistruar tek **Pala Tregtare “A”** që është e regjistruar **Llogarinë “B”**;

$EOB_{BA b}$ është energjia e liferuar në një **Aktivizim të Ofertës për Blerje** nga **Njësia Balancuese “b”** e regjistruar në **Llogarinë “A”**;

$EK_{BSh nj}$ është energjia e liferuar sipas **Kontratës së Shërbimeve Ndhmëse** për prokurimin “ShN” kur **Njësia Balancuese** e regjistruar tek **Pala Tregtare “A”** që është e regjistruar **Llogarinë “B”**

ζJB_j është **Çmimi i Jobalancit** i llogaritur në përputhje me nenin 15.

Për të shmangur dyshimin, ky paragraf është gjithashtu i zbatueshëm për Llogarinë e **Fondit Mbështetës për Burimet e Ripërtëritshme** të Energjisë, e cila trajtohet si një Llogari Injektimi.

16.5.4 Për **Llogarinë Dalëse “B”** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”**, **Energjia e Matur e Llogarisë Dalëse (EMD_{Bj})**, **Jobalanca e Llogarisë Dalëse (EJB_{Bj})** dhe **Pagesa e Jobalancit e Llogarisë Dalëse ($PEJB_{Bj}$)** llogariten si vijon:

$$EMD_{Bj} = \sum_A \sum_b ENjF_{BAbj}$$


$$EJB_{Bj} = EMD_{Bj} - \sum_A \sum_n EK_{BA nj} - \sum_A \sum_b EOSH_{BA bj} - \sum_A \sum_b EOB_{BA bj} - \sum_A \sum_b EK_{BSh nj}$$

$$PEJB_{Bj} = EJB_{Bj} * \zeta JB_j$$

ku:

EMD_{Bj} është **Energjia e Matur e Llogarisë Dalëse të Furnizuesit për Llogarinë Dalëse “B”** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar “j”**

$ENjF_{BAbj}$ është **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese** e marr ose e përcaktuar si marrje në **Sistemin Matës “b”** e regjistruar tek **Pala Tregtare “A”** që është e regjistruar **Llogarinë “B”** dhe **Nominimi Interkonektiv** i konfirmuar “b” në një **Njësi Balancuese** eksportuese në **Interkonektor** e regjistruar tek **Pala Tregtare “A”** që është e regjistruar **Llogarinë “B”**;

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	ver. 3.1	Faqe 93 nga 123
Departamenti: Operatori i Tregut		

- EK_{BAnj} është energjia në **Nominimet Kontraktuale “n”** dhe **Nominimi Interkonektiv** i konfirmuar në **Interkonektorin “n”** e bërë nga **Pala Tregtare “A”** që është e regjistruar **Llogarinë “B”**;
- EOS_{BAB} është energjia e liferuar në një **Aktivizim të Ofertës për Shitje** nga **Njësia Balancuese “b”** nga **Pala Tregtare “A”** që është e regjistruar **Llogarinë “B”**;
- EOB_{BAB} është energjia e liferuar në një **Aktivizim të Ofertës për Blerje** nga **Njësia Balancuese “b”** nga **Pala Tregtare “A”** që është e regjistruar **Llogarinë “B”**;
- EK_{BShNj} është energjia e liferuar sipas **Kontratës së Shërbimeve Ndihmëse** për prokurimin e **“ShN”** kur **Njësia Balancuese** është regjistruar tek **Pala Tregtare “A”** që është e regjistruar **Llogarinë “B”**
- $ÇJB_j$ është **Çmimi i Jobalancit** i llogaritur në përputhje me nenin 15.

16.5.5 **Llogaria e PPB** relevante **“B”** do të kreditohet ose (sipas rastit) debitohet me **Pagesën për Energjinë e Jobalancit** ($PEJB_{Bj}$) për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** dhe shuma korresponduese do të debitohet ose (sipas rastit) kreditohet në **Llogarinë Balancuese të OST**.

16.6 Pagesat e Prodhuesve BRE dhe Jobalancet

16.6.1 Për çdo **Njesisë Gjeneruese të BRE “b”** të regjistruar në **Llogarinë e Fondit Mbështetës për Burimet e Ripërtëritshme “A”**, **OER** do të kalkulojë pagesën e zbatueshme për energjinë ($PNjG_{bm}$) dhe **Korrigjimin Balancues të Energjisë së Ripërtëritshme** ($KBER_{bm}$) për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** për muajin **“m”**, duke përdorur formulat:

- (a) për **Njësinë Gjeneruese të Skemës së Mbështetjes së BRE të Trashëguar “b”**;

$$PNjG_{bm} = \sum_j CBRE_b * \sum_j ENjG_{Abj}$$

$$KBER_{bm} = \sum_j \left(\sum_j \left(\left(ENjG_{bj} - XN_{bj} * H \right) \right) * 0.25 \right)$$


- (b) Për një **Njësi Gjeneruese të Skemës së Mbështetjes së Vetëshitjes së BRE “b”**:

$$PNjG_{bm} = \sum_j ENjG_{bj} \times (\sum_j CR_b - \sum_j \sum_j XP_j)$$

$$KBER_{bm} = 0$$

dhe, për të shmangur dyshimin, të gjitha pagesat e balancimit janë përgjegjësi e operatorit të **Njesisë Gjeneruese të Skemës së Mbështetjes së Vetëshitjes së BRE**.

- (c) për **Njësinë Gjeneruese të Skemës Mbështetëse të BRE “b”** që nuk është një **Njësi Gjeneruese e skemës së mbështetjes së BRE e trashëguar** dhe nuk është një **njësi gjeneruese e skemës së mbështetjes së vetëshitjes së BRE**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	ver. 3.1	Faqe 94 nga 123
Departamenti: Operatori i Tregut		

$$PNjG_{bm} = \zeta BRE_b * \sum_j ENjG_{bj}$$

$$KBER_{bm} = \zeta JB_j \times (ENjG_{bj} - EK_{bj})$$

për Njësinë Gjeneruese të Rregulluar të BRE "B" OT do të llogarisë pagesën mujore për energjinë e kontraktuar nga Njësia Gjeneruese e BRE "B" (CREGBm) dhe Korrigjimin Balancues të Energjisë së Ripërtërishme (KBEbM) për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j" në muajin "m" duke përdorur formulën:

$$PNjG_{bm} = \zeta REF \times \sum_j \sum_n EK_{Bn,j}$$

$$KBER_{bm} = \zeta JB_j \times (ENjG_{bj} - EK_{bj})$$

të gjitha pagesat ($PNjG_{bm}$) për Gjeneratorët e Energjisë së Ripërtërishme të debituar nga Llogaria e Fondit Mbështetës për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë së Ripërtërishme dhe Korrigjimin Balancues të Energjisë së Ripërtërishme ($KBER_{bj}$) të kredituar në Llogarinë e Fondit Mbështetës për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë

- (d) nëse OER-ja nuk mund të shesë energjinë e blerë përmes kontratave dypalëshe, për çdo Furnizues "A" OER-ja do të llogarisë pagesën mujore të blerjes së BRE të Furnizuesit ($FPEB_{Am}$) të nominuar duke përdorur formulën:

$$PFEB_{Am} = \sum_j \sum_n (EK_{F_{Aj}}) * \zeta REF$$


- (e) Dhe për pagesën e Taksës për Energjinë e Ripërtërishme, Llogaria e Fondit Mbështetës për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë do të kreditohet dhe çdo Furnizues "A" do të debitohet me Pagesat mujore të Furnizuesit për Blerje të Energjisë nga BRE ($PFBRE_{Am}$) duke përdorur formulën

$$PFBRE_{Am} = \left(\sum_B \sum_j EMF_{Bj} \right) * TER$$

ku:

ζBRE_b është Çmimi i BRE për Njësinë Gjeneruese në Skemën Mbështetëse të BRE "b" dhe mund të jetë çmimi i garantuar në një RCfD;

PXP_j është çmimi i bursës së energjisë elektrike në Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j";


	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 95 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- EJB_{bj} është Jobalanci i Llogarisë së Injektivit për **Njësine Gjeneruese të Skemës së Mbështetjes së BRE "b"** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** llogaritur në përputhje me paragrafin 16.5.3 duke supozuar se llogaria e injektivit përbëhet nga një Njësi e vetme Balancuese;
- ζREF është **Çmimi Referent për Njësine Gjeneruese BRE të Rregulluar "B"** në Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j";
- TER është **Taksa për Energjinë e Ripërtërishme**;
- $ENJG_{bj}$ është energjia e matur si liferim nga **Njësia Gjeneruese në Skemën Mbështetëse të BRE "b"**;
- $ENJG_{Bj}$ është energjia e matur si liferim nga **Llogaria Injektuese e Njësia Gjeneruese BRE e Rregulluar "B"**
- ζJB_j është **Çmimi i Jobalancit**;
- EKB_{Bnj} është energjia e kontraktuar për **Njësine Gjeneruese BRE e Rregulluar "B"** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**
- EKF_{Bnj} është energjia e kontraktuar për **Furnizuesin "B"** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**
- XN_{Bj} është **Nominimi Fizik** i mesatares së MW për orë për **Njësine Gjeneruese BRE të Rregulluar "B"**;
- H është kohëzgjatja e **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** në orë;
- EMF_{Bj} është **Energjia e Matur e Llogarisë Dalëse të Furnizuesit për Llogarinë Dalëse "B"** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**
- $| |$ është vlera absolute e formulës brenda kllapave.

16.6.2 OER do të paguaj **Njësine Gjeneruese nga Skema Mbështetëse e BRE "b"** nga **Llogaria e Fondit Mbështetës për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë së Ripërtërishme** pagesën mujore për energjinë e liferuar nga **Njësia Gjeneruese BRE "b"** ($PNjG_{bm}$) minus shuma e çdo **Korrigjimi Balancues të Energjisë së Ripërtërishme** ($KBER_{bm}$) secila e kalkuluar në përputhje me paragrafin 16.6.1.

16.6.3 OER do ta paguaj **Njësine Gjeneruese BRE të Rregulluar "B"** nga **Llogaria e Fondit Mbështetës për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë** me pagesë mujore për energjinë e kontraktuar (nominuar) për **Njësia Gjeneruese BRE "B"** (EKB_{bm}) plus shumën e çdo **Korrigjimi Balancues të Energjisë së Ripërtërishme** ($KBER_{bm}$) të kalkuluar në përputhje me paragrafin 16.6.1..

16.6.4 Për çdo **Furnizues "A"**, OER do të kalkuloj **Pagesat e Furnizuesit për BRE** (PFB_{Am}) që i atribuohet këtij **Furnizuesi** dhe do të kreditoj **Llogarinë e Fondit Mbështetës për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë së Ripërtërishme**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	ver. 3.1	Faqe 96 nga 123
Departamenti: Operatori i Tregut		

16.7 Kalkulimi i Humbjeve në Transmetim

16.7.1 OT do të kalkulojë, për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**, **Humbjet në Transmetim (EHT_j)**, **Jobalancet për Llogarinë Tregtuese të OST (EJB_{TSOj})** dhe **Pagesën për Jobalancin e OST ($PEJB_{OSTj}$)** duke përdorur formulën:

$$EHT_j = \sum_b ENjG_{bj} + \sum_b ENjF_{bj} + \sum_o EZ_{oj} + \sum_L ENK_j$$

$$EJB_{TSOj} = EHT_j - \sum_A EK_{Aj}$$

$$PEJB_{TSOj} = EJB_{TSOj} * \zeta_{JB_j}$$

ku:

$ENjG_{bj}$ është energjia e matur e liferuar nga **Njësia Gjeneruese** e kyçur në transmetim "b";

$ENjF_{bj}$ është energjia e matur e liferuar tek **Konsumatori fundor** i kyçur në transmetim "b";

EZ_{oj} është energjia e matur që është liferuar në **Rrjetat e Shpërndarjes në Sistemin Matës "o"**;

EK_{Aj} është energjia e pranuar sipas **Nominimit Kontraktual** për për prokurimin e **Humbjeve në Transmetim** e përmbyllur me **Palën Tregtare "A"** në përputhje me paragrafin **Error! Reference source not found.**, por për shmangien e dyshimit, Humbjet e Transmetimit të blera në një PX do të përfshihen këtu dhe **PX** do të konsiderohet **Pala Tregtare "A"** për qëllimin e këtij paragrafi;

ENK_j është energjia e matur ndër-kufitare në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**

ζ_{JB_j} është **Çmimi i Jobalancit** i llogaritur në përputhje me nenin 15.


16.7.2 **Llogaria e Tregtimit e OST** do të kreditohet ose (sipas rastit) debitohet me **Pagesën** për **Jobalancet ($PEJB_{TSOj}$)** për **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** dhe shuma korresponduese e parave do të debitohet ose (sipas rastit) kreditohet në **Llogarinë Balancuese të OST**.

16.7.3 OT do të publikojë **Humbjet në Transmetim** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**.

16.8 Kalkulimi i Humbjeve në Shpërndarje

16.8.1 Çdo vjet (ose si përcaktohet nga **ZRrE**) **ZRrE** do të njoftojë OT dhe **OSSH "o"** për energjinë në MWh (EHS_{oj}) që duhet të blihet nga ana e **OSSH** për **Humbjet në Shpërndarje** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** një vjet para dhe, për nevoja të **Rregullave të Tregut**, OT do ta regjistrojë këtë energji si **Energji të Matur** në **Llogarinë Dalëse të OSSH**.

16.8.2 Për nevoja të kalkulimit të **Jobalanceve**, **OSSH** do të trajtohet si **Palë Tregtare** e cila duhet ta ketë në balancë **Energjinë e Matur** të regjistruar në **Llogarinë Dalëse të OSSH-së** dhe **Nominimet Kontraktuale** për energjinë e blerë për humbjet në rrjetin e shpërndarjes, dhe do të

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 97 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

jetë përgjegjëse për **Jobalancet** kur paraqiten mospërputhje në mes **Humbjeve në Shpërndarje** të regjistruara dhe shumës së **Nominimeve Kontraktuale**.

16.9 Pagesat Mujore pas Korrigjimit të Matjeve

16.9.1 Në baza mujore **OST**, **OSSH** ose **AAM** do të dorëzojnë **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** për **Njehsorët** e kyçur në transmetim ose në shpërndarje për të cilët janë dorëzuar lexime tjera nga ato që tashmë janë përdorur në **Barazimin Përfundimtar**.

16.9.2 Arsyet për dorëzimin e këtyre informatave mund të përfshijnë:

- (a) Korrigjimi i **Të Dhënave Matëse të Njesisë Gjeneruese**;
- (b) Korrigjimi i të dhënave matëse të **Sistemit të Ruajtjes**;
- (c) Korrigjimi i **Të Dhënave Matëse të Rrjetit të Shpërndarjes**;
- (d) Dorëzimin e **Të Dhënave Matëse të Sistemeve Matëse Interval** ;
- (e) Dorëzimin e **Të Dhënave Matëse për Sistemin Matës Jo-Interval** .


16.9.3 **Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara** mund të përmbajnë:

- (a) Identitetin e **Sistemit Matës** (gjenerim, “kufi” ose furnizim);
- (b) Datën e fillimit dhe **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** për të cilën duhet të bëhet korrigjimi;
- (c) Datën e përfundimit dhe **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** për të cilën duhet të bëhet korrigjimi;
- (d) Energjinë që më parë i ishte përcaktuar **Sistemit Matës** nga sistemi i **Barazimit Përfundimtar** prej datës së fillimit/ **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** deri në datën e përfundimit/ **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**;
- (e) Energjinë e matur (ose e llogaritur) si liferim ose si marrje në **Sistemin Matës** prej datës së fillimit/ **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** deri në datën e përfundimit/ **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**; dhe
- (f) Në qoftë se aplikohet, energjinë e llogaritur që është liferuar në **Sistemin Matës** prej datës së fillimit/ **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** deri në datën e përfundimit/ **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**.

16.9.4 Kur të realizohet **Marrëveshja për Alokimin e Matjeve** atëherë rregullat për alokim do të aplikohen në **Informatat për Korrigjimin e Matjeve** nga ana e **OT**.

16.9.5 **OT** do të publikojë një **Procedurë të Rregullave të Tregut për Korrigjimin e Matjeve** në të cilën do të parashtrijë mënyrën e kalkulimit të **Pagesave pas Korrigjimit të Matjeve** duke aplikuar principet vijuese:

- (a) **Pagesa pas Korrigjimit të Matjeve** do të realizohet si një transfer financiar, për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**, ndërmjet **Palës Tregtare** (ose **OST**) të regjistruar në **Sistemin Matës** relevant dhe të gjitha **Palëve Tregtare** tjera (ose **OST**). Korrigjimet nuk do të bëhen në **Energjinë e Matur** dhe të regjistruar në sistemin e **Barazimit Përfundimtar**;


	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 98 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (b) Të gjitha llogaritjet e bëra pas korrigjimeve, për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**, do të përdorin **Çmimin e Jobalancit** të përdorur paraprakisht në llogaritje;
- (c) Korrigjimi i **Të Dhënave Matëse të Njesisë Gjeneruese dhe të Dhënave Matëse të Sistemit të Ruajtjes** do të ketë si pasojë **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** ndërmjet **Palëve Tregtare** relevante dhe **Llogarisë Tregtuese të OST**;
- (d) Korrigjimi i **Të Dhënave Matëse të Rrjetit të Shpërndarjes** do të ketë si pasojë **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** ndërmjet **Llogarisë Tregtuese të OST** dhe **Llogarisë Dalëse të Furnizuesit** të regjistruar në **Sistemin Matës Jo-interval**;
- (e) Korrigjimi i **Të Dhënave për Sistemet Matëse Jo-interval** të kyçura në transmetim do të ketë si pasojë **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** ndërmjet **Palëve Tregtare** relevante dhe **Llogarisë Tregtuese të OST**;
- (f) Korrigjimi i **Të Dhënave për Sistemet Matëse Interval** të kyçura në shpërndarje do të ketë si pasojë **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** ndërmjet **Palëve Tregtare** relevante dhe **Llogarisë Dalëse të Furnizuesit** që kanë të regjistruar **Sisteme Matëse Intervale**;
- (g) Korrigjimi i **Të Dhënave për Sistemet Matëse Jo-interval** do të ketë si pasojë **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** ndërmjet **Palëve Tregtare** relevante dhe **Llogarisë Dalëse** të gjithë **Furnizuesve** që kanë të regjistruar **Sisteme Matëse Jo-intervale**;
- (h) Për **Sisteme Matëse Jo-interval**:
 - i. Një metodologji që përdorë **Sasinë Vjetore të Energjisë të Sistemit Matës** relevant, do të përcaktojë energjinë totale që i atribuohet **Sistemit Matës** individual nga **Barazimi Përfundimtar** dhe profilin e energjisë që u atribuohet të gjitha **Sistemeve Matëse Jo-Intervale** (plus **Sistemet Matëse të Furnizuesit Publik** të kyçura në shpërndarje) që përdoren për **Barazimin Përfundimtar**, prej datës së fillimit deri në datën e përfundimit të periodës për korrigjimin e matjeve, do të përdoret për përcaktimin e energjisë në çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**;
 - ii. I njëjti profil do të aplikohet proporcionalisht për energjinë aktuale të matur si marrje ndërmjet datës së fillimit dhe datës së përfundimit për përcaktimin e profilit të energjisë së marrë në çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**.

16.9.6 **OT** do t'i përdorë këto informata për të përcaktuar **Pagesën pas Korrigjimit të Matjeve** (që përdorë **Çmimin e Jobalancit** të përdorur paraprakisht) për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve**, ndërmjet **Palëve Tregtare** dhe **OST** në përputhje me **Procedurën e Rregullave të Tregut për Të Dhënat e Matjeve të Korrigjuara**.

16.9.7 **OT** do të gjejë shumën mujore të vlerave të **Pagesave pas Korrigjimit të Matjeve** për çdo **Palë Tregtare**.

16.9.8 Nëse për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** ekziston një **Pagesë pas Korrigjimit të Matjeve** për një **Palë Tregtare** atëherë do të ekzistojnë një ose më shumë **Pagesa pas Korrigjimit të Matjeve** për **Palët Tregtare** të tjera të përfshira apo (në disa rrethana) mund të përfshijë edhe **OST**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 99 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

16.10 Rregullat e Jo-liferimit

16.10.1 Për një **Njësi Balancuese “b”**, të regjistruar në një **Llogari të Palës Tregtare “A”**, në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”**, në të cilën janë bërë një ose më shumë **Aktivizime të Ofertave për Blerje** ose **Aktivizime të Ofertave për Shitje**, **OT** do të llogarisë:

- (a) **Energjinë e Matur të Njësisë Gjeneruese** ($ENjG_{Abj}$) ose (sipas rastit) **Energjinë e Matur të Njësisë Furnizuese** ($ENjF_{Abj}$),
- (b) **Pozitën e Urdhëruar** (XPU_{bj}),
- (c) çmimin e **Ofertave për Blerje** (ζOB_{bj}) ose (sipas rastit) çmimin e **Ofertave për Shitje** (ζOSh_{bj}), dhe
- (d) **Çmimin e Jobalanceve** (ζJB_j).

16.10.2 Pas shqyrtimit të ndryshoreve të dhëna në paragrafin 16.10.1, për **Njësinë Balancuese “b”**, të regjistruar në **Llogarinë e Palës Tregtare “A”**, në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** **OT** do të kalkulojë **Çmimin e Jo-liferimit** (ζJL_{Abj}) dhe **Energjinë e Jo-liferimit** (EJL_{Abj}) nën kushtet si vijojnë:

- (a) Nëse është bërë **Aktivizimi i Ofertës për Shitje** dhe nëse:
 - i. **Çmimi i Jo-liferimit** (ζJL_{Abj}) është më i madh se zero dhe llogaritet si:

$$\zeta JL_{Abj} = \zeta OSh_{bj} - \zeta JB_j$$

- ii. **Energjia e Jo-liferimit** (EJL_{Abj}) është më e madhe se zero dhe llogaritet si:

$$EJL_{Abj} = \text{Maksimumi} ((XPU_{bj} * H) - ENjG_{Abj}, 0)$$

ose (sipas rastit)

$$EJL_{Abj} = \text{Maksimumi} ((XPU_{bj} * H) - ENjF_{Abj}, 0)$$

ku H është kohëzgjatja e **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** në orë; ose

- (b) Nëse është bërë **Aktivizimi i Ofertës për Blerje** dhe nëse:
 - i. **Çmimi i Jo-liferimit** (ζJL_{Abj}) është më i madh se zero dhe që llogaritet sipas:

$$\zeta JL_{Abj} = \zeta JB_{bj} - \zeta OB_j$$


- ii. **Energjia e Jo-liferimit** (EJL_{Abj}) është më e madhe se zero dhe llogaritet si:

$$EJL_{Abj} = \text{Maksimumi} (ENjG_{Abj} - (XPU_{bj} * H), 0)$$

ose (sipas rastit)

$$EJL_{Abj} = \text{Maksimumi} (ENjF_{Abj} - (XPU_{bj} * H), 0)$$

ku H është kohëzgjatja e **Periodës së Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** në orë.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 100 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

16.10.3 Kur, për **Njësinë Balancuese “b”**, të regjistruar në **Llogarinë e Palës Tregtare “A”**, në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”**, **OT** i ka kryer kalkulimet sipas paragrafit 16.10.2, **OT** do të kalkulojë **Pagesën e Jo-liferimit (P_{JL_{Abj}})** sipas:

$$P_{JL_{Abj}} = \zeta_{JL_{Abj}} * E_{JL_{Abj}}$$

ku:

$\zeta_{JL_{Abj}}$ **Çmimi i Jo-liferimi** i kalkuluar sipas paragrafit 16.10.2(a) ose paragrafit 16.10.2(b)i;

$E_{JL_{Abj}}$ **Energjia e Jo-liferimit** e kalkuluar sipas paragrafit 16.10.2(a)ii ose paragrafit 16.10.2(b)ii;

dhe do të kreditojë **Llogarinë Balancuese të OST** me **Pagesën e Jo-liferimit** dhe sasinë e njëjtë do ta debitojë në **Llogarinë e Injektivit** ose **Llogarinë Dalëse** (sipas rastit) të **Palës Tregtare**.

16.11 Jobalancat e Bursës së Energjisë Elektrike (PX)

16.11.1 Pranohet se, si palë kundrejt të gjitha tregtimeve të ekzekutuara në **TOEE**, shuma e MWh e të gjitha blerjeve të bëra nga **PX** do të jetë e barabartë me shumën e MWh të të gjitha shitjeve të bëra nga **PX**. Megjithatë, ekziston mundësia që të ndodhë një gabim për shkak të gabimeve të pakorrigjuara të dorëzimeve të nominimeve kontraktuale. Prandaj, **OT**-ja do të bëjë llogaritjet ekuivalente të jobalancit në Llogarinë Balancuese të **PX** si për një **BRP**, por me rregullime për të siguruar që asnjë kosto jobalanci të mos grumbullohet në Llogarinë e jobalancit të **PX**, funksioni i së cilës është pra të sigurojë bilancin kontabël në procedurat e barazimit përfundimtar të **OT**-së.

16.11.2 Më tej pranohet se palët e tjera **BRP** në **PX** do të jenë në jobalancë përputhëse. Prandaj, **BRP**-të e tilla mund të aplikojnë në **ZRRE** për rikthimin ex-post të nominimeve kontraktuale që mungojnë për korrigjimin e barazimit përfundimtar financiar dhe **OT** do të sigurojë që kthimet e tilla financiare do të bëhen në përputhje me udhëzimet e bëra nga **ZRRE**-ja. Prandaj pranohet se mund të rezultojnë rregullime në Llogarinë Balancuese të **OST** për periudhat e mëpasshme të **barazimit përfundimtar të jobalanceve**.


16.11.3 Për llogarinë e jobalancit të **PX "B"** në Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j", jobalanci i llogarisë së jobalancit të **PX (E_{JB_{Bj}})** rrjedh si më poshtë:

$$E_{JB_{Bj}} = \sum_n E_{K_{Bnj}}$$

Ku:

$E_{K_{Bnj}}$ është vëllimi i energjisë në **Nominimin Kontraktual “n”** i kryer nga **PX “B”** si rezultat i një tregtimi të ekzekutuar në **TOEE**

16.11.4 **OT** do të transferojë **Jobalancën e llogarisë** së Jobalancit **PX (E_{JB_{Bj}})** në **Llogarinë Balancuese të OST**

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 101 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

17 Detyrimet

17.1 Aplikimi i Tarifave

17.1.1 **OST, OT** dhe të gjitha **Palët Tregtare** do t'i dorëzojnë **ZRrE** të gjitha të dhënat e nevojshme për t'i mundësuar kalkulimin dhe aprovimin e tarifave. Kjo do të përfshijë së paku tarifat që do të aplikohen për **Prodhuesit** dhe **Furnizuesit** siç janë: **Detyrimet për Rrjetin e Transmetimit, Detyrimet për Operim të Sistemit të Transmetimit, Detyrimet për Operim të Tregut** dhe për operimin e Skemës për Mbështetjen e Energjisë së Ripërtëritshme. **ZRrE** do t'i njoftojë me shkrim **Palët** për tarifat e reja të aplikueshme dhe vitin për të cilin do të aplikohen këto tarifa.

17.1.2 **OT** duhet të publikojë një raport vjetor për detyrimet totale për të lehtësuar llogaritjen e detyrimeve për periudhën e ardhshme.

17.1.3 Për qëllimet e të gjitha tarifave të përmendura në këtë seksion 17, një **Njësi Balancuese e Sistemit të Ruajtjes**, duke përfshirë një **Njësi Ruajtje të OST-së**, do të trajtohet sikur të ishte një Gjenerues, duke përfshirë çdo rrjedhë energjie negative.

17.2 Piku i Konsumit

17.2.1 Për nevojat e **Detyrimeve për Rrjetin e Transmetimit** është e nevojshme të përcaktohet **Piku i Konsumit** në një vit tarifor, që është viti i referuar në paragrafin 17.1.1.

17.2.2 Për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"**, **OT** do të kalkulojë **Daljet nga Rrjeti Transmetues** nëpërmes formulës:

$$EDRrT_j = \sum_b ENjF_{bj} + \sum_o EZ_{oj}$$

ku:

$ENjF_{bj}$ është energjia e matur e **Konsumatorëve fundor** të kyçur në **Rrjetin e Transmetimit "b"**;

EZ_{oj} është energjia e matur si liferim në **Rrjetin e Shpërndarjes** në **Sistemin Matës "o"**.

17.2.3 Çdo javë (nga 00:00 e të Hënës deri në 24:00 e së Dieles), **OT** e përzgjedh një **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** potenciale të pikut që ka vlerën maksimale për **Daljet nga Rrjeti Transmetues** ($EDRrT_j$) në atë javë.

17.2.4 Përveç në qoftë se këshillohet ndryshe nga **ZRrE**, **Piku i Konsumit** do të jetë vlera më e madhe e kalkuluar nga ana e **OT** në përputhje me paragrafin 17.2.2 për vitin tarifor.

17.2.5 **OT** do të publikojë **Pikun e Konsumit** dhe **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** në të cilën është arritur.

17.3 Detyrimet për Rrjetin e Transmetimit

17.3.1 **ZRrE** do ta njoftojë **OT** për tarifat për detyrimin ndaj **Rrjetit të Transmetimit** (në €/kW) që duhet të aplikohen për atë vit.

17.3.2 **ZRrE** do ta njoftojë **OT** për aprovimin e tarifave të reja, dhe **OT** do të publikojë tarifat e reja për **Rrjetin e Transmetimit**.

17.3.3 Madhësitë e referuara në paragrafin 17.3.1 përfshijnë **Tarifën e Prodhuesit për shfrytëzim të Rrjetit ($TPRr_z$)** dhe **Tarifën e Furnizuesit për shfrytëzim të Rrjetit ($TFRr_z$)** që aplikohen për kyçjet në nivelin e tensionit “Z” në **Rrjetin e Transmetimit**.

17.3.4 Në fillim të vitit tarivor, **OST** do ta njoftojë **OT** për **Kapacitetin e Rrjetit për Prodhuesin ($XRrP_A$)** për **Prodhuesin “A”** që parashikohet të regjistrojë kapacitetin e kyçjes për çdo **Prodhues** në kW gjatë periodës së parashikuar të **Pikut të Konsumit** gjatë vitit të ardhshëm tarivor.

17.3.5 Në fillim të vitit të ri tarivor, **OST** do ta njoftojë **OT** për **Parashikimin e Pikut Ditor të Furnizuesit ($XPPDF_{ZA}$)** për **Furnizuesin “A”** që është konsumi i parashikuar në kW për çdo **Furnizues “A”** të aplikueshëm për nivelin e tensionit “Z” në **Rrjetin e Transmetimit** gjatë periodës së **Pikut të Konsumit** të parashikuar gjatë vitit të ardhshëm tarivor.

17.3.6 **OT** do të kalkulojë **Detyrimin e Prodhuesit për shfrytëzim të Rrjetit** për muaj nëpërmes formulës:

$$DRrP_A = \sum_z (TPRr_z * XRrP_A) / 12$$

ku:

$TPRr_z$ është **Tarifa e Prodhuesit për Rrjetin**, e aplikueshme për nivelin e tensionit “Z” në **Rrjetin e Transmetimit**;

$XRrP_A$ është piku i **Kapacitetit të Rrjetit për Prodhuesin për Prodhuesin “A”**.

17.3.7 Për çdo muaj kalendarik, **OT** do të kalkulojë për **Furnizuesin Detyrimin për Shfrytëzim të Rrjetit të Transmetimit ($DRrF_{ZA}$)** të aplikueshëm për çdo nivel të tensionit “Z” në **Rrjetin e Transmetimit**, që duhet të faturohet për çdo **Furnizues “A”**, nëpërmes formulës:

$$DRrF_{ZA} = \frac{\sum_b EF_{Abj}}{\sum_n \sum_b EF_{nbj}} * XPPDF_z * TFRr_z / 12$$

ku:

n është çdo **Furnizues**;


j është **Perioda e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** e identifikuar që ka marrjen maksimale në atë muaj;

EF_{Abj} është **Energjia e Matur e Njesisë Furnizuese për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** për **Njehsorin e Furnizimit “b”** të regjistruar në **Llogarinë Dalëse “A”**;

$TFRr_z$ është **Tarifa e Furnizuesit për Shfrytëzim të Rrjetit** e aplikueshme për nivelin e tensionit “Z” në **Rrjetin e Transmetimit**;

$XPPDF_A$ është **Parashikimi i Pikut Ditor të Sistemit** i miratuar nga ZRrE i aplikueshëm për nivelin e tensionit “Z” në **Rrjetin e Transmetimit** gjatë periodës të **Pikut të Konsumit**.

17.3.8 90 ditë pas përfundimit të vitit tarivor, **OT** do të përgatisë faturat e korigjimit të cilat mbulojnë dallimin ndërmjet pagesave të bazuara në rrjedhat e parashikuara të energjisë dhe kapaciteteve të rrjetit gjatë periodës së **Pikut të Konsumit** të parashikuar dhe pagesave të

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 103 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

kalkuluara në bazë të rrjedhave të energjisë dhe kapaciteteve të rrjetit gjatë periodës së **Pikut të Konsumit** aktual.

17.4 Detyrimi për Operim të Sistemit

17.4.1 **ZRrE** do ta njoftojë **OT** për tarifën për **Detyrimin për Operim të Sistemit të Transmetimit** në €/MWh që duhet të aplikohen për atë periodë.

17.4.2 **ZRrE** do ta njoftojë **OT** për aprovimin e tarifave të reja, dhe **OT** do të publikojë tarifat e reja për operatorin e sistemit.

17.4.3 Tarifat vjetore, të referuara në paragrafin 17.4.1, janë **Tarifat e Prodhuesit për Operim të Sistemit** ($TPOS_Z$) që aplikohen për tërë energjinë e prodhuar nga **Prodhuesit** që hyn në **Rrjetin e Transmetimit, Tarifën e Prodhuesit në Shpërndarje për Operim të Sistemit** ($TPShOS$) të prodhuar nga **Prodhuesit** të kyçur në **Sistemin e Shpërndarjes** dhe **Tarifën e Furnizuesit për Operim të Sistemit** ($TFOS_Z$) që aplikohen për tërë energjinë që del nga **Rrjeti i Transmetimit** në nivelin e tensionit “Z” për shfrytëzim nga **Konsumatorët fundor** në Kosovë.

17.4.4 Për çdo muaj kalendarik, **OT** do të llogarisë:

- (a) për **Llogarinë e Injektivit të Palës Tregtare “A”**, **Detyrimi i Prodhuesit për Operim të Sistemit** ($DPOS_A$), kalkulohet si:

$$DPOS_A = TPOS_Z * \sum_j EMI_{Aj}$$

ku:

$TPOS_Z$ është **Tarifa e Prodhuesit për Operim të Sistemit** për nivelin e tensionit të kyçjes në **Rrjetin Transmetues**;

EMI_{Aj} është **Energjia e Matur në Llogarinë e Injektivit** (e shprehur në kWh) për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** në muajin e dhënë dhe të bazuar në energjinë e matur si liferim nga të gjitha **Njësitë Gjeneruese** të kyçura në transmetim dhe **Nominimet Interkonektive** të konfirmuara si import në **Njësitë Balancuse në Interkonektor** që janë regjistruar në **Llogarinë “A”**;


- (b) për **Llogarinë e Injektivit të Palës Tregtare “A”**, **Detyrimi i Prodhuesit në Shpërndarje për Operim të Sistemit** ($DPSHOS_A$), kalkulohet si:

$$DPSHOS_A = TPSHOS * \sum_j EMI_{Aj}$$

ku:

$TPShOS$ është **Tarifa e Prodhuesit në Shpërndarje për Operim të Sistemit**;

EMI_{Aj} është **Energjia e Matur në Llogarinë e Injektivit të Palës Tregtare** (e shprehur në MWh) për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** në atë muaj dhe e bazuar në energjinë e matur si liferim në sistemin e shpërndarjes nga ana e të gjitha **Njësitë Gjeneruese** të kyçura në sistemin e shpërndarjes që janë të regjistruara në **Llogarinë “A”**;

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	ver. 3.1	Faqe 104 nga 123
Departamenti: Operatori i Tregut		

- (c) për **Llogarinë e Furnizimit “A”**, **Detyrimi i Furnizuesit për Operim të Sistemit (DFOS_A)**, kalkulohet si:

$$DFOS_A = -TFOS_z * \sum_j EMD_{Aj}$$

ku:

- TFOS_Z** është **Tarifa e Furnizuesit për Operim të Sistemit** e aplikueshme për nivelin e tensionit “Z” në **Rrjetin e Transmetimit**;
- EMD_{Aj}** është **Energjia e Matur në Llogarinë Dalëse** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** në muaj dhe bazuar në energjinë e matur si marrje nga të gjitha **Sistemet Matëse dhe Nominimet Interkonektive** të konfirmuara në **Njësinë Balancuese në Interkonektor** për eksport që janë regjistruar në **Llogarinë “A”**.

17.4.5 Çdo muaj, **OT** do të faturojë çdo **Palë Tregtare “A”** në krahasim me **Detyrimin e Prodhuesit për Operim të Sistemit (DPOS_A)**, **Detyrimin e Prodhuesit në Shpërndarje për Operim të Sistemit (DPSHOS_A)** ose **Detyrimin e Furnizuesit për Operim të Sistemit (DFOS_A)**.

17.5 Detyrimet për Operim të Tregut

17.5.1 **ZRrE** do ta njoftojë **OT** për tarifën për **Detyrimin për Operim të Tregut** në €/MWh që duhet të aplikohet për atë vit.

17.5.2 **ZRrE** do ta njoftojë **OT** për aprovimin e tarifave të reja, dhe **OT** do të publikojë tarifën e reja për Operim të Tregut.

17.5.3 Tarifat e referuara në paragrafin 17.5.1 përfshijnë: **Tarifën e Prodhuesit për Operim të Tregut (TPOT)**, **Tarifën e Prodhuesit në Shpërndarje për Operim të Tregut (TPShOT)** dhe **Tarifën e Furnizuesit për Operim të Tregut (TFOT)**.


17.5.4 Për çdo muaj kalendarik, **OT** do të kalkulojë:

- (a) për **Llogarinë e Injektivit të Palës Tregtare “A”**, **Detyrimin e Prodhuesit për Operim të Tregut (DPOT_A)**, të kalkuluar si:

$$DPOT_A = TPOP * \sum_j EMI_{Aj}$$

ku:

- TPOP** është **Tarifa e Prodhuesit për Operim të Tregut**;
- EMI_{Aj}** është **Energjia e Matur në Llogarinë e Injektivit të Palës Tregtare** (e shprehur në MWh) për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** në muaj dhe bazuar në energjinë e matur si liferim nga të gjitha **Njësitë Gjeneruese** të kyçura në sistemin transmetues dhe **Nominimet Interkonektive** të konfirmuara në **Njësinë Balancuese në Interkoneksion** për importe që janë regjistruar në **Llogarinë “A”**;

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 105 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (b) për **Llogarinë e Injektimit të Palës Tregtare “A”, Detyrimin e Prodhuesit në Shpërndarje për Operim të Tregut ($DPSHOT_A$)**, e kalkuluar si:

$$DPSHOT_A = TPSHOT * \sum_j EMI_{Aj}$$

ku:

$TPSHOT$ është **Tarifa e Prodhuesit në Shpërndarje për Operim të Tregut**;

EMI_{Aj} është **Energjia e Matur në Llogarinë e Injektimit të Palës Tregtare** (e shprehur në MWh), për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** në atë muaj, dhe e bazuar në energjinë e matur si liferim në sistemin e shpërndarjes nga ana e të gjitha **Njësite Gjeneruese** të kyçura në sistemin e shpërndarjes që janë të regjistruara në **Llogarinë “A”**;

- (c) për **Llogarinë e Furnizimit “A”, Detyrimi i Furnizuesit për Operim të Tregut ($DFOT_A$)**, kalkulohet si:

$$DFOT_A = -TFOT * \sum_j EMD_{Aj}$$

ku:

$TFOT$ është **Tarifa e Furnizuesit për Operim të Tregut**;

EMD_{Aj} është **Energjia e Matur në Llogarinë Dalëse** për çdo **Periodë të Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** në muaj dhe e bazuar në energjinë dalëse të matur si liferim nga të gjitha **Sistemet Matëse dhe Nominimet Interkonektive** të konfirmuara për **Njësinë Balancuese në Interkonektor** për eksport që është regjistruar në **Llogarinë “A”**.

17.5.5 Çdo muaj, **OT** do të faturojë çdo **Palë Tregtare “A”** për **Detyrimin e Prodhuesit për Operim të Tregut ($DPOT_A$)**, **Detyrimin e Prodhuesit në Shpërndarje për Operim të Tregut ($DPSHOT_A$)** ose **Detyrimin e Furnizuesit për Operim të Tregut ($DFOT_A$)**.

17.6 Rialokimi i Pagesave për Balancim

17.6.1 Me qëllim që të garantojë neutralitetin e pagesave të **Balancimit** (rivendosja e gjendjes zero në llogari), **OT** do bëjë kthimin e çdo të hyre neto që rrjedh nga **Aktivizimi i Ofertave për Blerje/Shitje**, pagesat e jobalanceve, dhe blerja e **Rezervës së energjisë nga PPB**, ose do të kërkojë pagesa shtesë nga **PPB** ashtu që **Llogaria Balancuese e OST** të rikthehet në zero.

17.6.2 Çdo muaj “m”, **Operatori i Tregut** do të kalkulojë **Energjinë në Llogarinë Balancuese të OST (ELB_m)**, balancin e gjendjes së **Llogarisë Balancuese të OST ($BGjLB_m$)** dhe **Çmimin Balancues të OST ($ÇB'OST'_m$)** sipas formulave:

$$ELB_m = \sum_j \left(\sum_B EMI_{Bj} - EMD_{Bj} \right)$$

$$BGjLB_m = - \sum_j \left(\sum_{ShN} PSH_{ShNj} + \sum_{ShN} POSh_{bj} + \sum_{ShN} POB_{bj} - \sum_{ShN} PJL_{bj} + \sum_{ShN} PEJB_{Aj} \right)$$


$$CB'OST'_m = BGjLB_m / ELB_m$$

ku:

- j* është **Perioda e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** në muajin "*m*";
- B* është **Llogaria e PPB ose Llogaria Tregtuese e OST**;
- ShN* është **Kontrata e Shërbimeve Ndhmëse**;
- b* është **Njësia Balancuese** për të cilën është bërë një **Aktivizim i Ofertës për Shitje** ose **Aktivizim i Ofertës për Blerje**;
- EMI_{Bj}* është **Energjia e Matur në Llogarinë e Injektivit për Llogarinë e PPB "B"** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** e caktuar sipas paragrafit 16.5.3;
- EMD_{Bj}* është **Energjia e Matur në Llogarinë Dalëse për Llogarinë e PPB "B"** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** e caktuar sipas paragrafit 16.5.4;
- PSh_{ShNj}* është **Pagesa për Shfrytëzim të Shërbimit Ndhmës në Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** sipas **Kontratës së Shërbimeve Ndhmëse "ShN"** e caktuar sipas paragrafit 13.4.2(c);
- POSh_{bj}* është **Pagesa e Ofertës për Shitje për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** për **Njësinë Balancuese "b"** e caktuar sipas paragrafit 14.1.3;
- POB_{bj}* është **Pagesa e Ofertës për Blerje për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** për **Njësinë Balancuese "b"** e caktuar sipas paragrafit 14.1.4;
- PJL_{bj}* është **Pagesa e Jo-Liferimit për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** për **Njësinë Balancuese "b"** e caktuar sipas paragrafit 16.10.3;
- PEJB_{Bj}* është **Pagesa për Energjinë e Jobalancit për Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve "j"** për **Llogarinë e PPB "B"** e caktuar sipas nenit 16.5.5 ose **Llogaria Tregtuese e OST "A"** e caktuar sipas paragrafit 16.7.2;

17.6.3 Për shmangien e dyshimit, për nevojat e paragrafit 17.6.2 dhe jo për ndonjë qëllim tjetër Shkëmbimi i Paqëllimshëm do të trajtohet si **Ofertë për Shitje** nëse **Shkëmbimi i Paqëllimshëm** ishte import neto në Kosovë dhe si **Ofertë për Blerje** nëse **Shkëmbimi i Paqëllimshëm** ishte një eksport neto jashtë Kosovës.

17.6.4 **Pagesa nga Llogaria Balancuese e OST (PLB_{Am})** për **Llogarinë e Injektivit "B"** në muajin "*m*" do të kalkulohet me formulën:

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 107 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

$$PLB_{Am} = \zeta B' OST'_m * \sum_j EMI_{Aj}$$

ku:

j është **Perioda e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** në muajin “ m ”;

EMI_{Bj} është **Energjia e Matur në Llogarinë e Injektivit për Llogarinë “B”** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** e caktuar sipas paragrafit 16.5.3.

17.6.5 **Pagesa nga Llogaria Balancuese e OST (PLB_{Am}) për Llogarinë Dalëse “B”** për muajin “ m ” do të kalkulohet me formulën:


$$PLB_{Am} = -\zeta B' OST'_m * \sum_j EMD_{Aj}$$

ku:

j është **Perioda e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** në muajin “ m ”;

EMD_{Bj} **Energjia e Matur në Llogarinë Dalëse për Llogarinë e PPB “A”** në **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve “j”** e caktuar sipas paragrafit 16.5.4;

17.6.6 **Operatori i Tregut** do të debitojë (ose kreditojë) çdo **Palë Tregtare** në krahasim me **Pagesën nga Llogaria Balancuese e OST** në baza mujore.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 108 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

18 Faturimi dhe Pagesat

18.1 Dispozitat e Përgjithshme

18.1.1 Procesi i **Barazimit Përfundimtar** do të përbëhet nga **Ekzekutimi i Barazimit Përfundimtar** i pjesshëm sipas paragrafit 16.5, **Ekzekutimi i Barazimit Përfundimtar** i plotë provizor sipas nenit 16 dhe 17, dhe **Ekzekutimi i Barazimit Përfundimtar** i plotë final.

18.1.2 **Ekzekutimi i Barazimit Përfundimtar** i pjesshëm do të realizohet në D+7, **Ekzekutimi i Barazimit Përfundimtar** i plotë provizor në M+5 dhe **Ekzekutimi i Barazimit Përfundimtar** i plotë final në M+10. **Ekzekutimi i Barazimit Përfundimtar** të pjesshëm, **Ekzekutimi i Barazimit Përfundimtar** provizor dhe **Ekzekutimi i Barazimit Përfundimtar** i plotë duhet të sigurojnë informata për **Palët Tregtare** dhe **PPB** në mënyrë që të mund të verifikojnë informatat e ofruara dhe që të dakordohen për ndryshimet në rast të gabimeve.

18.1.3 Faturat do t'u shpërndahen **Palëve** një herë në muaj nga ana e **OT** dhe nga **Palët** kërkohet që të bëjnë pagesat për muajin paraprak kalendarik në përputhje me **Orarin e Barazimit Përfundimtar**.

18.1.4 Faturat do t'u shpërndahen **Palëve** në emër të këtyre **Palëve**:

- (a) **OT**;
- (b) **OER**; dhe
- (c) **OST**.

18.1.5 Faturat do të përfshijnë të gjitha taksat e aplikueshme.

18.1.6 Për evitimin e dyshimeve, **OT** do të themeloj procedurat për lëshimin e **Faturave** dhe mund të lëshoj lloje të ndryshme të detyrimeve për pagesë në **Fatura** të veçanta.

18.2 Procesi i Para-faturimit

18.2.1 Në afatin prej pesë (5) **Ditë Pune** të muajit aktual **OT** do t'i dorëzojë faturat provizore.


18.2.2 Nga të gjitha **Palët Tregtare** do të kërkohet që të miratojnë të dhënat e **Energjisë së Matur** dhe të dhënat e faturave provizore në përputhje me **Procedurat e Rregullave të Tregut** të përpiluara në përputhje me paragrafin 5.1.2(b). Në qoftë se **Palët Tregtare** dështojnë të konfirmojnë të dhënat e **Energjisë së Matur** ose faturat provizore, vlerat do të konsiderohen se janë korrekte dhe **OT** do të vazhdojë procesin e faturimit.

18.3 Cikli i Faturimit dhe Orari i Barazimit Përfundimtar

18.3.1 **OT** do të dorëzojë një **Faturë** me të gjitha të dhënat mbështetëse në afatin prej dhjetë (10) **Ditë Pune** të muajit aktual.

18.3.2 Në qoftë se **OT** nuk e dorëzon një **Faturë** në datën e caktuar në paragrafin 18.3.1, **OT** do të bëjë përpjekjet më të mëdha që një dokument i tillë të dorëzohet sa më shpejtë që është e mundur.

18.3.3 **PPB** dhe **Palët Tregtare** do të paguajnë të gjithë shumën e parave për faturat që u janë lëshuar (dhe **OT** do të paguajë paratë që i takojnë **PPB** dhe **Palëve Tregtare**) jo më vonë se pesë (5) **Ditë Pune** pas lëshimit të faturës.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 109 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

18.3.4 Për çdo mos-pagesë me kohë do të llogaritet kamata ligjore vjetore me shkallë interesi 8% në vlerën e papaguar ashtu siç përcaktohet në Ligjin mbi Marrëdhëniet Detyrimore, përveç nëse shuma e papaguar trajtohet si çështje në mirëbesim.

18.4 Faturat


18.4.1 Për çdo **Lloj të Pagesës në Faturë** do të aplikohet një **Rresht Fature** për secilin muaj.

18.4.2 **Rreshti i Faturës** do të përfshijë të dhënat vijuese:

- (a) Identitetin e muajit;
- (b) **Llojin e Pagesës në Faturë;**
- (c) Identifikuesin e **Llogarisë** së pagesës së **Palës Tregtare ose** identifikuesin e **Llogarisë** së pagesës së **PPB;**
- (d) Energjinë mujore;
- (e) Lartësinë e detyrimit për MWh ose për MW (që gjithashtu mund të jetë edhe rabat); dhe
- (f) Pagesën e Faturës (që gjithashtu mund të jetë edhe rabat).

18.4.3 **Llojet e Pagesës në Faturë** (që kanë të bëjnë me **Faturën** e një **Pale Tregtare** përveç nëse specifikohet ndryshe) mund të jenë si në vijim:

- (a) **Detyrimi për Shfrytëzim të Rrjetit të Transmetimit për Furnizuesit**
- (b) **Detyrimi për Shfrytëzim të Rrjetit të Transmetimit për Prodhuesit**
- (c) **Detyrimi i Prodhuesit për Operim të Sistemit;**
- (d) **Detyrimi i Furnizuesit për Operim të Sistemit;**
- (e) **Detyrimi i Prodhuesit për Operim të Tregut; dhe**
- (f) **Detyrimi i Furnizuesit për Operim të Tregut;**
- (g) **Pagesat nga Ofertat për Blerje/Shitje;**
- (h) **Pagesat e Jo-Liferimit;**
- (i) **Pagesat e Jobalanceve** (që i paguhen **PPB** ose paguhen nga **PPB**);
- (j) Pagesat mujore për **Kontratat e Shërbimeve Ndihmëse;**
- (k) Pagesat mujore të Kontratës për Humbjet në Transmetim;
- (l) Vlera totale e **Pagesave nga Llogaria Balancuese e OST** (që i paguhen **PPB** ose paguhen nga **PPB**);
- (m) **Pagesat Mujore pas Korrigjimit të Matjeve;**
- (n) **Pagesat e Furnizuesit për Fondin Mbështetës për BRE; dhe**
- (o) **Pagesat e Furnizuesit për Blerje të Energjisë nga BRE;**
- (p) **Pagesat për jobalancet e BRE-ve;**
- (q) Krediti mujor ose tarifa e shkëmbimit të paqëllimshëm për agentin e caktuar të shkëmbimit të paqëllimshëm.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 110 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

18.4.4 Në rast se të dhënat janë të përafuara atëherë kjo bëhet në përputhje me **Procedurën e Rregullave të Tregut** dhe do të identifikohet në mënyrë eksplicite në **Faturë**.


18.4.5 **OT** do të llogarisë vlerën neto për çdo faturë (përfshirë Taksën e Energjisë së Ripërtëritshme) meritorë për pagesë.

18.5 Kontestimi i Faturës

18.5.1 **Kontestimi i Faturës** mund të ngritët nga një **PPB** ose një **Palë Tregtare**, kur vihet në pyetje e tërë apo një pjesë e shumës së faturës.

18.5.2 **Kur** një **PPB** ose një **Palë Tregtare** ngre një **Kontestim Fature** të vërtetë (bona fide), në të gjitha rastet obligimi për pagesën e kësaj fature duhet të bëhet deri në datën e caktuar. Kontest i vërtetë është kontesti që mbështetet në prova të sakta, ku provat e sakta definojnë si të dhëna origjinale që mbështesin vërtetimin e jo korrektësisë së **Barazimit Përfundimtar**. Në rast të borxhit ndaj ose nga një **Llogari e PPB** ose **Palës Tregtare**, pagesa e shumës totale duhet të bëhet siç është faturuar.

18.5.3 Kur rezultati i një **Kontestimi të Faturës** tregon se kontesti ka qenë i vërtetë (bona fide), ose **OT** nuk ka vepruar arsyeshëm në menaxhimin e **Kontestimit të Faturës** ose në kalkulimin e pagesës kontestuese, atëherë në shumën e ri-pagesës do të llogaritet kamata ligjore vjetore në shkallë interesi prej 8% mbi vlerën e papaguar ashtu siç përcaktohet në Ligjin mbi Marrëdhëniet Detyrimore.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 111 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

PJESA IV: ADMINISTRIMI

19 Procedurat e Rregullave të Tregut


19.1 Miratimi i Procedurave të Rregullave të Tregut

19.1.1 **OT** do të përpilojë **Procedurat e Rregullave të Tregut**, që konsideron se janë të nevojshme për lehtësimin e operimit korrekt dhe efikas të Tregut, dhe do t'i dorëzojë këto procedura te **Palët** për komentim dhe **ZRrE** për aprovim.

19.1.2 Në përputhje me praktikat më të mira të menaxhimit, **OT** do të revidojë **Procedurat e Rregullave të Tregut** dhe kohë pas kohe mund të propozojë amendamentimin e tyre. Kur ndryshimet janë të vogla dhe **OT** nuk konsideron se këto ndryshime do të kenë ndikim material komercial ose financiar në **Palët Tregtare**, atëherë **OT** do të njoftojë **ZRrE** dhe **Palët Tregtare** për këto ndryshime, datën e implementimit (që nuk duhet të jetë më pak se gjashtë (6) javë pas datës kur ndryshimi ishte propozuar) si dhe do të implementojë ndryshimet në datën e propozuar, përveç në qoftë se është bërë kundërshtim nga një **Palë Tregtare** ose nga **ZRrE**. Të gjitha ndryshimet tjera (duke përfshirë ndryshimet ndaj të cilave është paraqitur një kundërshtim) do t'i dorëzohen **ZRrE** për miratim.

19.1.3 Në rast se një **Palë** e konteston një **Procedurë të Rregullave të Tregut** ose e konteston nevojën për një **Procedurë të Rregullave të Tregut**, **OT** do të konsultohet me të gjitha **Palët** dhe do t'i dorëzojë **ZRrE** një raport në të cilin rekomandohen ndryshimet. Ndryshimet në **Procedurën e Rregullave të Tregut** nuk do të hyjnë në fuqi pa aprovimin nga ana e **ZRrE**.

19.1.4 Pas aprovimit të **Procedurave të Rregullave të Tregut** ashtu si janë definuar, ato do të publikohen nga **OT** dhe do hyjnë në fuqi.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 112 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

20 Modifikimi i Rregullave të Tregut

20.1 Modifikimi i Rregullave të Tregut

20.1.1 **Modifikimi i Rregullave të Tregut** do të bëhet pas udhëzimit të marrë nga **ZRrE**.

20.2 Paneli Shqyrtues

20.2.1 Me qëllim të menaxhimit të ndryshimeve të **Rregullave të Tregut**, në konsultim me **ZRrE**, **OT** do ta themelojë një **Panel Shqyrtues**, me përfaqësuesit që janë relevant në proces ose përfaqësuesit që ndikohen nga interesat komerciale. Të gjithë anëtarët e **Panelit Shqyrtues** do të marrin pjesë si ekspert të pavarur dhe jo si përfaqësues të interesave të veçantë.

20.2.2 Detyrat e **Panelit Shqyrtues** janë:

- (a) shqyrtimi i propozimeve për ndryshime në **Rregullat e Tregut**;
- (b) përcaktimi i procesit për shqyrtimin dhe zhvillimin e çdo propozimi për ndryshime;
- (c) mbikëqyrja e zhvillimit të procesit për propozime të ndryshimeve;
- (d) përkufizimi i përmbajtjes së një raporti për propozim për ndryshime dhe dorëzimi i tij te **ZRrE**;
- (e) publikimi i rregullave për procedurat e **Panelit Shqyrtues**; dhe
- (f) ofrimi i këshillave për **OT** për të gjitha aspektet e implementimit të **Rregullave të Tregut**.

20.2.3 Rregullat dhe procedurat e referuara në paragrafin 20.2.2(e) do të përfshijnë:


- (a) numrin e takimeve që **Paneli Shqyrtues** duhet t'i mbajë;
- (b) procedurat e organizimit të takimeve duke përfshirë ftesat për **Palët** dhe palët e interesit;
- (c) procedurat për takimet e **Panelit Shqyrtues** dhe për sjelljen e **Panelit Shqyrtues**;
- (d) metodologjinë e votimit për çdo aktivitet dhe rekomandimet që i paraqiten **ZRrE** për modifikimet e propozuara.

20.2.4 **ZRrE** do të ftohet në të gjitha mbledhjet e **Panelit Shqyrtues** si anëtar pa të drejtë vote.

20.3 Procesi i Modifikimit

20.3.1 Çdo **Palë** që ka aderuar në **Rregullat e Tregut**, si dhe çdo person ose trup të cilin **ZRrE** e konsideron që ka interes legjitim dhe material në çështjet e parashtruara në **Rregullat e Tregut** mund të ngritë çështjet që kanë të bëjnë me **Rregullat e Tregut** tek **Paneli Shqyrtues**.

20.3.2 **Paneli Shqyrtues** do të merret me një propozim për **Modifikim** në përputhje me procedurat e publikuara duke përfshirë, në qoftë se beson se çështja është e denjë për shqyrtim të mëtejshëm, procesin e nevojshëm për shqyrtimin e çështjes p.sh. duke mbledhur një grup industrial për diskutime, duke kërkuar nga **OT** përgatitjen e një raporti etj., dhe kur është e nevojshme duke bërë një propozim për ndryshime specifike në **Rregullat e Tregut**, pra një propozim për **Modifikim**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 113 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

20.3.3 Një propozim për **Modifikim** duhet të specifikojë çështjen ose defektin që duhet korrigjuar, ndryshimet e propozuara në **Rregullat e Tregut** dhe një vlerësim se si ky propozim i plotëson më mirë objektivat e **Rregullave të Tregut** të parashtruara në paragrafin 1.1.2.

20.3.4 Kur shqyrtimi rezulton me një propozim për **Modifikim**, **OT** do të konsultohet me palët mbi atë propozim për **Modifikim**.


20.3.5 Pa marrë parasysh atë që u tha më sipër, një **Palë** mund të ngritë direkt një propozim për **Modifikim** dhe **OT** e **Paneli Shqyrtues** do të menaxhojnë procesin e konsultimit me **Palën**.

20.3.6 Pas përfundimit të procesit të konsultimeve sipas paragrafit 20.3.4 ose paragrafit 20.3.5, **OT** do t'i dorëzojë **ZRrE** një raport me detajet e rezultateve të procesit të konsultimeve duke përfshirë rezultatet e kostos së implementimit, afatet e mundshme kohore për implementim dhe rekomandimet për mënyrën e implementimit. **ZRrE** do të vendosë për aprovimin e **Modifikimit** dhe për datën e implementimit.

20.3.7 Pas kësaj **OT** do të bëjë modifikimin e **Rregullave të Tregut** në përputhje me udhëzimet e marra nga **ZRrE**.

20.3.8 **Rregullat e reja të Tregut** do të publikohen nga **OT**.

20.3.9 Kur çështja ose defekti mund të rezultojë me një ndikim të dukshëm të një **Pale Tregtare** në një **Ekzekutim të Barazimit Përfundimtar** ose **Pala** bën shkelje të ligjeve të Kosovës, atëherë **OT** dhe **Paneli Shqyrtues** do të konsultohen me **ZRrE** në mënyrë që të ndërmerret një proces i përshpejtuar i konsultimeve me qëllim të modifikimit të shpejtë të **Rregullave të Tregut**.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 114 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

21 Dispozitat e Përgjithshme

21.1 Qasja në Rregullat e Tregut

21.1.1 **OT** do të sigurojë një kopje të **Rregullave të Tregut** për çdo **Palë** ose person me kërkesën e tyre, e cila do të paguhet nga një **Palë** ose person me shumën e parave (si aprovohet kohë pas kohe nga **OT**) që nuk tejkalon shpenzimet e arsyeshme të **OT** për përgatitjen dhe dërgimin e një kopje të tillë.

21.1.2 **OT** do të publikojë në formë elektronike kopjet e **Rregullave të Tregut** që mund të shkarkohen.

21.2 Njoftimet

21.2.1 Çdo njoftim ose komunikim tjetër që një **Palë** duhet t'i bëjë një **Pale** tjetër për çështjet e përfshira në **Rregullat e Tregut** ose në lidhje me to, duhet të adresohen te marrësi dhe të dërgohen në adresën, postën elektronike ose numrin e faksit të **Palës** tjetër sipas paragrafit 3.2.3.

21.2.2 Një njoftim ose komunikim tjetër duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të dorëzohet me dorë me një letër ose të dërgohet nëpërmes postës së klasit të parë me parapagim (ose me aeroplan për rastet tej-oqeanike), postës elektronike ose faksit, dhe duhet të konfirmohet se është pranuar:

- (a) Në rast të dorëzimit me dorë gjatë dorëzimit; ose
- (b) Në rast të postës së klasit të parë me parapagim, në ditën e dytë pas ditës së dërgimit me postë ose (nëse dërgohet me postë ajrore tej-oqeanike ose pranohet nga shtetet tej-oqeanike) në ditën e pestë pas dërgimit me postë; ose
- (c) Në rast të faksit, me konfirmimin e pajisjes pranuese të faksit të pranuesit, kur një konfirmim i tillë paraqitet para orës 17:00 të ditës së konfirmimit (dhe cilëndo ditë pas ditës së konfirmimit).

21.2.3 Me marrëveshje të ndërsjellë në mes **Palëve**, një njoftim mund të dërgohet me postë elektronike dhe do të trajtohet nga koha që është dërguar njoftimi.

21.3 Data e hyrjes në fuqi


21.3.1 Këto **Rregulla të Tregut** do të hyjnë në fuqi pas aprovimit nga **ZRrE**.

21.4 Forca Madhore

21.4.1 Në qoftë se për shkak të **Forcës Madhore**, një **Palë** ("**Pala Jo-Performuese**") nuk do të jetë në gjendje të realizojë detyrat e veta sipas **Rregullave të Tregut**, ato mbesin në fuqi por:

- (a) obligimet relevante të **Palës Jo-Performuese**; dhe
- (b) obligimet e çdo **Pale** tjetër ndaj **Palës Jo-Performuese** sipas **Rregullave të Tregut**; dhe
- (c) çfarëdo obligimi tjetër ndërmjet **Palëve** sipas **Rregullave të Tregut** të cilat **Pala** relevante nuk është në gjendje t'i kryejë në mënyrë të drejtpërdrejtë si rezultat i suspendimit të obligimeve të **Palës Jo-Performuese**;

21.4.2 do të suspendohen për periodën sa zgjasin rrethanat e **Forcës Madhore** ashtu që:

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 115 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (a) suspendimi i performansës nuk do të ketë përfshirje më të madhe dhe nuk do të zgjasë më shumë se sa kërkohet nga **Forca Madhore**;
- i. asnjë obligim që është shkaktuar nga cilado **Palë** para paraqitjes së **Forcës Madhore** që ka shkaktuar suspendimin e performancës nuk do të falet si rezultat i **Forcës Madhore**;
- ii. **Pala Jo-Performuese** u jep **Palëve** tjera njoftim korrekt ku përshkruan rrethanat e **Forcës Madhore**, duke përshkruar natyrën dhe kohëzgjatjen e pritur, dhe vazhdon të dërgojë raporte të rregullta gjatë tërë kohëzgjatjes së **Forcës Madhore**;
- iii. **Pala Jo-Performuese** do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të eliminuar pamundësinë e performimit; dhe
- iv. sa më shpejtë që të jetë e mundur pas ngjarjeve që paraqesin **Forcën Madhore**, **Palët** duhet të diskutojnë vazhdimin e operimeve për aq sa është e mundur në përputhje me **Rregullat e Tregut** dhe **Kodin e Rrjetit**.

21.5 Kushtet Emergjente

21.5.1 **Operatori i Sistemit** mund të deklarojë një gjendje emergjente si definohet në dispozitat e **Kodit të Rrjetit**. Në qoftë se deklarohet një gjendje e tillë emergjente **OT** do të:

- (a) shpallë, sa më shpejtë që të jetë e mundur, një njoftim në faqen elektronike të tij që **Operatori i Sistemit** është duke aplikuar procedurat emergjente duke përfshirë edhe informatat e disponueshme për kohëzgjatjen e gjendjes emergjente;
- (b) për të gjitha **Periodat e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** që janë ndikuar nga gjendja emergjente, **Çmimi i Jobalancit** do të jetë **Çmimi Mesatar i Jobalancit**;
- (c) shpallë një njoftim në faqen elektronike, sa më shpejtë që të jetë e mundur, për përfundimin e gjendjes emergjente dhe do të specifikojë **Periodën e Barazimit Përfundimtar të Jobalanceve** për të cilën do të vazhdojnë kalkulimet normale të **Çmimit të Jobalancit**.

21.5.2 **Palët Tregtare** të cilat janë ndikuar financiarisht nga gjendja emergjente mund të aplikojnë tek **ZRrE** për kompensim, dhe në qoftë se **ZRrE** vendos në favor të tyre, do të aplikohet një orar special i pagesave, të cilat **OT** do t'i trajtojë si **Pagesat pas Korrigjimit të Matjeve**. Për këtë qëllim, këto pagesa do të detalizohen në **Procedurën e Rregullave të Tregut** për Korrigjimin e Matjeve por këtu duhet të qartësohet se kjo është për informim më të mirë për procesin e pagesës dhe nuk ka të bëjë me korrigjimin e matjeve.


21.6 Transferimi (Cedimi)

21.6.1 Një **Palë** nuk do të cedojë dhe/ose transferojë dhe nuk do të tentojë të transferojë të drejtat dhe obligimet e saj që dalin nga **Rregullat e Tregut**, me kusht që një **Palë** mund të transferojë nëpërmes garancionit të drejtat e pjesërishme apo të gjitha të drejtat mbi shumatat e arkëtueshme sipas **Rregullave të Tregut**.

21.7 Auditimi

21.7.1 Jo më rrallë se çdo dy (2) vjet, **OT** do të angazhojë një auditorë të pavarur për proceset e **Barazimit Përfundimtar**. Fushëveprimi i auditorit do të mbulojë së paku:

- (a) Procedurat e regjistrimit dhe të dhënat e ruajtura nga **AAM**;

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 116 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (b) proceset për menaxhimin e **Barazimit Përfundimtar**;
- (c) **Llogarinë Balancuese të OST**;
- (d) procedurat për llogaritjen e kostos për **Modifikimin e Rregullave të Tregut**.

21.7.2 OT do të publikojë rezultatet e auditimit dhe do të konsultohet me **ZRrE** për implementimin e rekomandimeve të bëra nga auditori.

21.8 Dispozitat e Konfidencialitetit

21.8.1 Çdo Palë që pranon Informata Konfidenciale:

- (a) Nuk guxon ti zbulojë këto **Informata Konfidenciale** ndonjë **Pale** tjetër përveç si lejohet në dispozitat e **Rregullave të Tregut**;
- (b) **Informata Konfidenciale** do ti përdorë ose kopjojë vetëm për qëllime për të cilat është dhënë arsyeja ose ndonjë qëllim tjetër i paraparë në dispozitat e **Rregullave të Tregut**; dhe
- (c) Nuk do ti mundësojë qasje në **Informatat Konfidenciale** ndonjë personi që nuk është i obliguar me **Rregullat e Tregut** përveç nëse ai person është:
 - i. një blerës i mundshëm me mirëbesim (bona fide) i **Palës** e cila shpalos informata me pranimin e zotimit strikt për konfidencialitetin nga blerësi i tillë i mundshëm me mirëbesim (bona fide);
 - ii. konsultant ose këshilltar i jashtëm profesional pas marrjes së një deklaratë për konfidencialitetin nga ai; ose
 - iii. çdo bankë ose institucion financiar nga e cila një **Palë** e tillë është duke kërkuar mjete financiare, pas marrjes së një deklaratë për konfidencialitetin nga kjo bankë ose institucion financiar; ose
 - iv. **ZRrE**, ndonjë departament qeveritar, ndonjë agjencioni qeveritar ose rregullator që ka juridiksion mbi **Palën** zbuluese, të kërkuar me ligjet e juridiksionit relevant, ose me kushtet e ndonjë **Licence** apo me rregulloret e ndonjë burse.

21.8.2 Dispozitat e këtij neni nuk do të aplikohen për çfarëdo informate e cila në kohën kur është zbuluar tashmë ishte e publikuar në domenin publik dhe jo si pasojë e zbulimit nga ana e **Palës** zbuluese dhe shkeljes së obligimit sipas këtij neni.


21.8.3 Dispozitat e këtij neni do të mbesin obligim i një **Pale** edhe në qoftë se një **Pale** të tillë i është ndërprerë obligimi me **Rregullat e Tregut**.

21.9 Përgjegjësia Ligjore

21.9.1 Sipas këtij neni të **Rregullave të Tregut**, **OT** dhe të gjitha **Palët** do të lejohen të refuzojnë obligimet sipas **Rregullave të Tregut**, deri në suazat e lejuara sipas Ligjit të Kosovës.

21.10 Valuta

21.10.1 Të gjitha faturat e lëshuara sipas dispozitave të **Rregullave të Tregut** duhet të bëhen në Euro (€).

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 117 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

21.11 Juridiksioni

21.11.1 **Rregullat e Tregut** administrohen ekskluzivisht nga ligjet dhe gjykatat e Kosovës.


21.12 Zgjidhja e Kontesteve

21.12.1 **Palët** në **Rregullat e Tregut** mund të përdorin mekanizmat për zgjidhjen e kontesteve të parashtruara në Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë në fuqi.

21.12.2 Në rast se procedura sipas paragrafit 21.12.1 nuk e zgjidh **Kontestin** që është ngritur në lidhje me **Rregullat e Tregut**, mund të ngritët respektivisht ndonjë padi, veprim ose proces kolektiv në lidhje me **Rregullat e Tregut** në juridiksionin relevant.

21.12.3 Për eliminimin e dyshimeve asgjë nuk duhet të ndërmerret që përmbahet në dispozitën e mëparshme të nenit 21.11 që do t'i mundësonte një **Pale** që çështjen ta dërgojë në gjykatë për rastet kur **Rregullat e Tregut** mundësojnë veprime në të cilat mund të referohen për ndërmjetësim ose si përcaktohet ndryshe.

21.12.4 Çdo **Palë** që nuk është kompani e inkuorporuar sipas ligjit të **Kosovës** do t'i sigurojë **OT** një adresë të personit kontaktues në Kosovë për shërbimet e procesit në emër të saj.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 118 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

SHTOJCA 1

Marrëveshja për Aderim në Rregullat e Tregut

Sipas Nenit 23.6 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Nenit 9 të Licencës për Operatorin e Tregut të Energjisë (nr ZRRE/Li 16/17) dhe Marrëveshjes Kornizë, Palët në këtë Marrëveshje për Aderim në Rregullat e Tregut dakordohen si vijon:

Kjo MARRËVESHJE PËR ADERIM NË RREGULLAT E TREGUT lidhet më [] ndërmjet:


- (1) **Operatorit të Tregut** në emër të vet dhe në emër të të gjitha **Palëve** tjera [duke përfshirë edhe palët që kanë nënshkruar **Marrëveshjen Kornizë të Rregullave të Tregut**] (më tutje **MKRRT**), "**Pala e Autorizuar**"; dhe
- (2) [Shëno emrin e **Palës** që dëshiron të pranohet në **Rregullat e Tregut**] ("**Pala Aplikuese**") selia kryesore e të cilës është në []

KU:

- (A) me **MKRRT** të datës [] e lidhur ndërmjet **Palëve Originale** të emërtuara aty dhe që tani është në fuqi ndërmjet **Palëve** me cilëndo **Marrëveshje për Aderim në Rregullat e Tregut** (më tutje **MARrT**) që ka hyrë në fuqi nga cilado **Palë e Re** para datës së kësaj **MARrT** ("**Marrëveshja Kornizë**"), **Palët** dakordohen që ta fuqizojnë dhe të obligohen me **Rregullat e Tregut**;
- (B) **Pala Aplikuese** është pajtuar me kërkesat e **Rregullave** për **Aderim** dhe dëshiron të pranohet si **Palë**.

PAJTOHEN si vijon:

1. Në këtë **MARrT**, fjalët dhe shprehjet e definuara për nevoja të Marrëveshjes Kornizë, dhe që nuk janë definuar ndryshe, këtu do të kenë kuptimin e atribuar në Marrëveshjen Kornizë.
2. **Pala e Autorizuar** (që vepron në emër të vet dhe në emër të çdo **Pale** tjetër) me këtë e pranon **Palën Aplikuese** si një **Palë** të bashkangjitur në Marrëveshjen për Aderim nga data në **MARrT** me kushtet dhe afatet e parashtruara në të.
3. Këtu e tutje **Pala Aplikuese** pajtohet me pranimin e saj si **Palë** dhe angazhohet me **Palën e Autorizuar** (duke vepruar në emër të vet dhe në emër të **Palëve** tjera) realizimin dhe obligimin me Marrëveshjen Kornizë si **Palë** nga data e shënuar këtu.
4. Për të gjitha nevojat në lidhje me Marrëveshjen Kornizë **Pala Aplikuese** do të trajtohet si të ishte nënshkruese e Marrëveshjes Kornizë [nga data e nënshkrimit], dhe sikur **MARrT** të ishte pjesë e Marrëveshjes Kornizë, dhe të drejtat dhe obligimet e **Palëve** do të interpretohen në pajtim me këtë.
5. Kjo **MARrT** dhe Marrëveshja Kornizë duhet të lexohen dhe interpretohen si një dokument dhe referencë (sipas Marrëveshjes Kornizë) .
6. Në qoftë se cilado dispozitë e kësaj **MARrT** është ose bëhet jovalide , shfuqizohet ose shpallet jolegale ose deklarohet jovalide, shfuqizohet ose shpallet jolegale nga ndonjë gjyq kompetent ose nga ndonjë Autoritet Kompetent një jovaliditet i tillë, ky shfuqizim ose jolegalitet nuk do të paragjykojë ose ndikojë në dispozitat e mbetura të kësaj **MARrT**, të cilat do të vazhdojnë të mbesin në fuqi pa marrë parasysh këtë.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 119 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		


7. Kjo **MARrT** do të administrohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Kjo **MARrT** është përpiluar në 6 ekzemplarë origjinal, çdo **Palë** i pranon dy ekzemplarë dhe dy ekzemplarë tjerë i dorëzohen **Zyrës së Rregullatorit për Energji. Operatori i Tregut**, në përputhje me kërkesat e **Rregullave të Tregut**, do t'ua dorëzojë të gjitha **Palëve** nga një kopje të certifikuar të **MARrT**.

SI DËSHMI janë nënshkrimet e përfaqësuesve të autorizuar të **Palëve** në ditën e shënuar më lartë.

NËNSHKRUAR për dhe në emër të
OPERATORIT TË TREGUT
nga përfaqësuesi i autorizuar

NËNSHKRUAR për dhe në emër të
[Pala Aplikuese]
nga përfaqësuesi i autorizuar


	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 121 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Afatet dhe Tërheqja

8. Kjo marrëveshje hynë në fuqi me vonë se pesë (5) **Ditë Pune** nga ekzekutimi i saj dhe pesë (5) **Ditë Pune** pas **Aderimit të Palës Tregtare** relevante në **Rregullat e Tregut**.
9. Kjo marrëveshje do të vazhdoj të jetë në fuqi deri sa:
 - (a) **Pala Tregtare** që është **PPB** të pushoj të jetë **Palë** në **Rregullat e Tregut** ose me humbjen e **Licencës**, paaftësia për të paguar borxhet ose ndonjë arsye tjetër; ose
 - (b) **Pala Tregtare** që është **PPB** e ka njoftuar **OT** që, në datën e njoftimit, e cila është së paku pesë (5) **Ditë Pune** pasi që të jetë dorëzuar një njoftim i tillë, **Pala Tregtare** është bërë anëtare e një **Grupi Balancues** tjetër.
10. Tërheqja e kësaj marrëveshje nuk i shlyen obligimet ekzistuese të shkaktuara nga **PPB** para tërheqjes së saj.
11. Për evitimin e dyshimeve, nga ana e **OT** nuk do të bëhet kurrfarë veprimi për tërheqjen e kësaj marrëveshje përveç veprimeve sipas **Rregullave të Tregut** për **Tërheqjen** e të drejtave të **Palës Tregtare** që është **PPB**.

Të drejtat dhe obligimet e OT dhe PPB

12. **OT** është i autorizuar dhe përgjegjës për:
 - (a) Krijimin dhe mirëmbajtjen e një **Llogarie Injektuese** ose një **Llogarie Dalëse** në emër të **PPB**;
 - (b) Pranimin dhe përdorimi i të gjitha informatave për çdo anëtar të **Grupit Balancues** që janë relevante për kalkulimin e jobalanceve të **Grupit Balancues**;
 - (c) Përdorimin e **Çmimeve të Jobalanceve** relevante dhe kalkulimin e pagesave që duhet t'i paguhen ose duhet të paguhen nga **PPB**;
 - (d) Pranimin e instrumenteve të **Garancionit Financiar** të deponuar nga anëtarët e **Grupeve Balancuese** dhe përdorimi i tyre në rastet kur **PPB** dështon të bëjë kryerjen e pagesave;
 - (e) Dorëzimin e **Faturave** tek **PPB** në lidhje me pagesat për jobalancet; dhe
 - (f) Zbatimin e cilëndo dispozitë tjetër të **Rregullave të Tregut** që ka të bëjë me këtë marrëveshje.
13. **PPB** është e autorizuar dhe përgjegjëse për:
 - (a) Dorëzimin e një portfolio të balancuar në emër të **Grupit Balancues** të tij në kohën e **Mbylljes së Tregut**;
 - (b) Pranimin e informatave nga **OT** në lidhje me çdo anëtar të **Grupit Balancues** që është relevante për kalkulimin e jobalanceve të **Grupit Balancues**; dhe

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 122 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

- (c) Pranimin e **Faturave** nga **OT** në lidhje me pagesat për jobalancet dhe kryerjen e pagesave ose pranimin e pagesave për këto jobalance brenda kohë së përcaktuar në **Rregullat e Tregut**;

Nominimet


14. **PPB** do të sigurohen që të gjitha **Nominimet Kontraktuale** janë bërë në përputhje me **Rregullat e Tregut** në emër të të gjitha **Palëve Tregtare** që janë pjesë e **Grupit Balancues** të saj.

Garancionet e Sigurisë

15. **OT** është i autorizuar që të mbështetet në **Garancionin Financiar** të deponuar nga anëtarët e **Grupit Balancues** dhe të bëjë tërheqjen e këtyre instrumenteve në rastet kur kjo **PPB** dështon të paguaj shumën e parave që i ka borxh për pagesat e jobalanceve dhe **PPB** nuk do të ngritë kurrfarë pengese për këtë por do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për t'i garantuar **OT** qasje efektive në këto instrumente të **Garancionit Financiar**.
16. Në qoftë se, instrumentet e **Garancionit Financiar** të disponueshme për nevoja të pagesës së jobalanceve për **OT**, janë vërtetuar si jo-adekuate atëherë **PPB** duhet të ndërmarrë hapa të menjëhershëm që një ose më shumë anëtarë të **Grupit Balancues** të sigurojnë instrumente shtesë të **Garancionit Financiar** dhe që mbetet obligim i **PPB** që të siguroj këto instrumente ti vihen në disponim të **OT**.

Kalkulimi dhe pagesa e jobalanceve

17. Në përputhje me **Rregullat e Tregut**, **OT** do të kalkuloj **Çmimin e Jobalancit** dhe **Jobalancin** në llogari të **PPB**.
18. Në përputhje me **Rregullat e Tregut**, **OT** do t'i dorëzoj **PPB** një **Faturë** me të gjitha informatat detaje në cilat **OT** është bazuar për kalkulimin e lartësisë së shumës së parave që **PPB** i ka borxh për **Jobalancin** të **Grupit Balancues**.
19. Përkundër çfarëdo kontestimi që **PPB** mund të ketë në raport me shumën e parave që i është faturuar asaj nga **OT**, **PPB** do ta paguaj çdo shumë parash që kërkohet brenda afatit kohor të specifikuar në **Rregullat e Tregut**.
20. Kur **PPB** konteston shumën e parave që e ka borxh ose që i është paguar për jobalancet, **PPB** mund të ngritë kontestimin në përputhje me **Rregullat e Tregut** dhe korrigjimi do të paguhet nga **OT** ose do ti paguhet **OT** në qoftë se dëshmohet se kontestimi është i vlershëm.
21. Në rastet kur **PPB** dështon të kryej pagesën, **OT** do të bëjë tërheqjen e instrumenteve të **Garancionit Financiar** të deponuara nga anëtarët e **Grupit Balancues** në çfarëdo mënyre që i konvenon dhe **PPB** pajtohet që ta dëmshpërblej **OT** për çfarëdo **Kontesti** të ngritur nga cilido anëtar i **Grupit Balancues** që i shkactohej **OT** nga këto veprime.
22. Perioda maksimale për finalizimin e **Barazimit Përfundimtar** të jobalanceve me **PPB** për një periode të caktuar është përkufizuar të jetë 12 Muaj.

	Rregullat e Tregut	PO-MO-001
	<i>ver. 3.1</i>	<i>Faqe 123 nga 123</i>
<i>Departamenti: Operatori i Tregut</i>		

Zgjidhja e kontesteve

23. Përveç kontesteve në lidhje me borxhin, **PPB** mund të ngritë çdo **Kontest** tjetër në lidhje me këtë marrëveshje duke aplikuar proceset e parashtruara në **Rregullat e Tregut**.

Kushtet Përfundimtare

24. **Palët** në këtë marrëveshje pajtohen që të ruajnë konfidencialitetin e të gjitha informatave të pranuar si pjesë e kësaj marrëveshje në përputhje me dispozitat për **Informatat Konfidenciale të Rregullave të Tregut**.
25. Kjo marrëveshje mbulohet me Ligjet dhe gjyqet e Kosovës.
26. Në qoftë se **PPB** dëshiron që marrëveshjen ta transferoj në një palë tjetër atëherë duhet ta njoftoj **OT** dhe transferi i tillë i marrëveshjes nuk do të prolongohet pa arsye me kusht që pala mbi të cilën transferohet marrëveshja është **Palë Tregtare** sipas **Rregullave të Tregut**.
27. Në rastet kur kjo marrëveshje pushon të aplikohet në mënyrë legale sipas ligjeve të Kosovës ose pushon të jetë në përputhje me **Rregullat e Tregut**, atëherë **Palët** në marrëveshje do të takohen që arsyeshëm të dakordohen për amendamentimet e duhura por të gjitha pjesët tjera të marrëveshjes do të mbeten në fuqi.

Dispozita kalimtare

Dispozitat ligjore që trajtojnë çështjet në lidhje me Operatorin e Ruajtjes, sistemet e ruajtjes dhe Njësinë e Ruajtjes të OST dhe çështjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre të përcaktuara në këtë akt, nuk do të zbatohen përderisa të miratohen me Ligjin për Energjinë dhe Ligjin për Energjinë Elektrike nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Dispozita përfundimtare

1. Procedurat për modifikimin ose ndryshimin e këtij akti do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij akti ligjor (Rregullat e Tregut), do të shfuqizohen Rregullat e Tregut të miratura me vendim të ZRRE V_1066_2018 të datës 30 tetor 2018.
3. Ky akt publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës. Në rast mospërputhjes ndërmjet versioneve, do të mbizotëroj versioni në gjuhën Shqipe.
4. Ky akt hyn në fuqi pas aprovimit me vendim të Bordit të ZRRE.

(Fundi i dokumentit)